

RAPORT I VLERËSIMIT TË JASHTËM PERIODIK

Për Programin e studimit



Master i Shkencave në “Menaxhim mjedisor urban”

Ofruar nga Universiteti “POLIS”



Ekspteri i vlerësimit të jashtëm:

Prof. Ass. Dr. Florim GRAJÇEVCI

Prof. Ass. Dr. Gafur MUKA

(Janar/2019)



RAPORT I GRUPIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Përkreditimin periodik të Programit të studimit

Master i Shkencave në "Menaxhim mjedisor urban"

Tabela e të dhënave të licencimit për programin e studimit:		
1	IAL Aplikues:	Universiteti "POLIS"
2	Fakulteti që e ofron	Fakulteti Planifikim, Mjedis dhe Menaxhim Urban
3	Urdhri/VKM i licencimit/riorganizimit	VKM Nr 406, dt 26.05.2010
4	Urdhëri/VKA e Akreditimit të pare	UMASH Nr 250, dt 14.06.2013 VKA Nr 470, dt 03.05.2013
5	Titulli i programit të studimit:	Masteri i Shkencave në "Menaxhim mjedisor urban"
6	Cikli i studimit:	Cikli i dytë
7	Kohëzgjatja e programit të studimit:	2 vite / 4 semestra
8	Kreditet në total (ECTS):	120 ECTS
9	Forma e studimit (me kohë të plotë/të pjesshme/në distancë/):	Me kohë të plotë
10	Gjuha (shqip/tjetër):	Shqip
11	Programi ofrohet nga institucioni	Vetëm nga Universiteti POLIS
12	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera	Vetëm nga Universiteti POLIS
13	Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	N/A
14	Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	N/A
15	Niveli në Kornizën kombëtare të kualifikimeve	Niveli 7
16	Aktivizimi i programit të studimit	UMAS Nr 557, dt 09.12.2010
17	Numri i studentëve	49 studentë
	etj	

Shënim: Tabela plotësohet nga Specialisti i ASCAL

HYRJE

Të dhëna për programin e studimit Master i Shkencave në "Menaxhim mjedisor urban"

Programi i studimit Master i Shkencave në Menaxhim Mjedisor Urban ofrohet nga Fakulteti i Planifikimit, Mjedisit dhe Menaxhimit Urban, përkatësisht Departamenti i Mjedisit ne Universitetin "POLIS".

Sipas dokumentacionit që konsultoi GVJ dhe mbi bazën e vizitës në institucion (protokollet e takimeve) rezulton që Programi i Studimit Master Shkencor në Menaxhim Mjedisor Urban (MSc në MMU) është licencuar nga Këshilli i Ministrave me VKM Nr. 406, datë 26.05.2010 "Për hapjen e programeve të reja të studimeve në shkollën e lartë private Universiteti POLIS, Tiranë" dhe është pajisur me leje për ushtrimin e veprimtarisë nga MASH me Urdhër 557, datë 09.12.2010 "Për lejimin për ushtrimin e veprimtarisë akademike në përputhje me licencën e dhënë për hapjen e programeve të reja të studimit shkollës së lartë Private POLIS". Ky program zhvillohet ne Fakultetin Planifikim, Mjedis dhe Menaxhim Urban.

Me vendim të Këshillit të Fakultetit të Planifikimit, Mjedisit dhe Menaxhimit Urban (FPMU), vendim të Senatit Akademik dhe miratim të Ministrisë të Arsimit dhe Sportit, mbështetur dhe në "Rregulloren mësimore të PS Msc MMU" ky Program Studimi është i organizuar në formën e studimeve me kohë të plotë, me kohëzgjatje 2 vite akademike, dhe 120 ECTS, ku viti akademik është i ndarë në dy semestra. Në përfundim të studimeve, lëshohet diploma me emërtimin: "Master Shkencor në Menaxhim Mjedisor Urban", sipas sistemit të Bolonjës.

Programi i studimit Master i Shkencave në Menaxhim Mjedisor Urban ka filluar me gjeneratën e parë në vitin akademik 2011/2012 dhe vazhdon edhe me tutje.

GRUPI I VLERËSIMIT TË JASHTËM (GVJ)

Përbërja e GVJ:

1. Prof. Ass. Dr. Florim Grajcevc
2. Prof. Ass. Dr. Gafur Muka

Ngritja e Grupit të Vlerësimit të Jashtëm (GVJ) është bërë nga ASCAL /Bordi i Akreditimit. Menaxher teknik (MT) i ndjekjes së vlerësimit të kësaj procedure është specialisti i ASCAL, MSc. Suela Kromidha.

Më datë 11.01.2019 nepërmjet sistemit AMS është dërguar në U.Polis Draft RVJ. Më datë 16.01.2019, Institucioni ka sjelle përgjigje dhe komentet/sugjerime në lidhje me këtë Draft. Kjo përgjigje i përcillet GVJ nga menaxheri teknik i ndjekjes së programit. GVJ pasi shqyrtoi me kujdes komentet që kishte paraqitur Institucioni lidhur me draft raportin e dërguar atij, vendosi sa më poshte:

1. Të marrim në konsiderate komentin ndaj rekomandimit tonë lidhur "me forcimin e komponentit të dijeve për ekspertizën dhe auditimin" duke e hequr atë, pasi shpjegimet për marrjen e këtyre njohurive në masën që institucioni i konsideron të mjaftueshme, janë bindëse.
2. Ndaj komentit që lidhet me konstatimet e GVJ për moskonsiderimin e VKM nr.41, datë 24.01.2018 në ndarjen dhe peshën e veprimtarive formuese të planit mësimor dhe strukturën e syllabuseve, jemi dakord me arsyen që paraqet institucioni, por mendojmë të mbetet si konstatim, pasi edhe vetë institucioni konfirmon që është i angazhuar për ndryshime sipas dispozitës ligjore të cituar në RVJ.

Nisur sa më lart, Raporti merr formën e tij përfundimtare dhe firmoset nga GVJ.

ANALIZA PËRMBLEDHËSE PËR VLERËSIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT

Rekomandimet e Bordit te Akreditimit

- a. Të plotësohen mungesat e kualifikimit të titullarëve të lëndëve që mbulojnë programin e studimit.
- b. Të përfshihen në Departamentin e Mjedisit dhe Planifikimit edhe brezi i "mesëm" i pedagogeve në stafin akademik të brendshëm.
- c. Të realizohet sa me shpejt informatizimi i sekretarisë mësimore dhe mbajtja e të dhënave në *softëare*-e të posaçme, lehtësisht të qasshme dhe te disponueshme për çdo student.
- d. Të kompletohen laboratorët me aparaturat e nevojshme për zhvillimin e procesit mësimor dhe punës kërkimore në këtë fushë.
- e. Të rritet pesha e formimit teknik në këtë program studimi pasi është relativisht e ulët.
- f. Të përmirësohet mobilimi dhe mjedisi ekzistues fizik i bibliotekës për të përballuar numrin e studenteve aktual.
- g. Të sigurohet që studentet e këtij programi studimi të japin në përfundim dhe provimin e gjuhës angleze, mbi bazën e teksteve të njohura ndërkombëtare.

I. ANALIZA PËRMBLEDHËSE PËR PLOTËSIMIN E REKOMANDIMEVE NGA AKREDITIMI I PARË

GVJ duke u bazuar në RVB, Dokumentacionin e vënë në dispozicion dhe vizitën pranë Universitetit POLIS, konstaton se rekomandimet e mëparshme janë plotësuar

- a. Këtë rekomandim të Bordit të Akreditimit IAL e ka përfill dhe tani nga dokumentet e verifikuara numëron 17 pedagogë efektiv dhe 3 pedagog me kontratë. Nga 17 pedagogët efektiv janë: 4 me gradën Prof. Dr, 1 Prof Asoc. Dr, 5 pedagog me Dr, 6 pedagog me PhD në proces, dhe një Master. Specifikë e veçantë e këtij rekomandimi në këtë program studimi është numri i konsideruar i pedagogëve me gradat Prof. Dr dhe Prof Asoc Dr deri sa është përmirësuar numri i pedagogëve me gradën Dr. Shumë premtues është edhe fakti i kandidatëve potencial për Dr.
- b. Mosha e re dhe mesatare e pedagogëve efektiv të angazhuar në programin e studimit Master Shkencor në Menaxhimin e Mjedisit Urban (25-55 vjeç) është 65% ndërsa brezi i mesëm (36-55 vjeç) është 35%. Vlerat krahasuese të moshave të angazhuara në programin e studimit 65/35 % japin raportin 2/1-moshë e re me moshë mesatare dhe është tregues matës i cilësisë dhe tani i plotësuar nga rekomandimet e BA.
- c. IAL tani operon me sistemin e integruar (Rrjetin Akademik Shqiptar) RASH dhe kjo gjë është e vërtetuar edhe nga GVJ.
- d. Marr parasysh trendët e zhvillimit të shkencës dhe teknologjisë, zbulimi i materialeve të ndryshme moderne për fusha të ndryshme, ngritja dhe modernizimi i Laboratorëve janë sfida për shumë Institucione arsimore, prandaj edhe U-POLIS gjithmonë duhet të vazhdoj me këto trende përsa i përket modernizimit të tyre. IAL ka përmirësim të shtuar të këtij rekomandimi dhe ka tregues të matshëm (*rritja e zërave buxhetor për laboratorët*) për zhvillimin dhe rritjen e kapaciteteve të laboratorëve. Me këtë rekomandimin IAL është marrë seriozisht dhe ka investuar në ngritjen e një sërë laboratorësh të cilët sigurisht duhen pasuruar dhe përditësuar vazhdimisht me pajisje të reja, çka në fakt kjo çështje është edhe në Objektivat e Universitetit POLIS. Sot IAL ka në veti laboratorët e; Mjedisit, GIS/CAD/SAP/ETABS/TEKLA, MAC, Eficiensa e Energjisë, dhe Prototipizimit.
- e. IAL ka hartuar programin e studimit që integron aspektet teknike me ato menaxheriale. Aspektet shkencore të fushave Planifikim Urban (fushë multidiciplinare e cila përveç tjerash ka të bëjë me analizë, sintetizim, krahasim dhe rezultate të vërtetuara), Ndryshimet Klimatike (probleme statistikore, matje të shumta, shpërndarja numerike e tyre duke u mbështet në ligjet e fizikës dhe matematikës) njohuria e të cilave janë tregues i rreziqeve në vend, Monitorimi Mjedisor (matje, verifikim, krahasim etj.) janë tregues dhe pjesëmarrës në programin e studimit dhe ky rekomandim i BA është i plotësuar.
- f. Edhe ky rekomandim i BA shkon gjithmonë karshi nevojave të mëdha dhe permanente të përditësimit të literaturave që kërkojnë programet e studimit. Universiteti POLIS ka Bibliotekën brenda vetes dhe

posedon fond të konsideruar (bazuar edhe ne RVB) të literaturës e cila lidhet me programin e studimit për Master Shkencor të menaxhim mjedisor urban. Edhe kjo çështje lidhet me objektivat e Universitetit POLIS për rritjen e kapaciteteve (numrit të botimeve në vend dhe Botë) të Bibliotekës. Për periudhën nga fillimi dhe akreditimi i programit deri tani është rritur edhe kapaciteti i Bibliotekës me vende ulëse dhe me tavolina pune.

- g. Lidhur me rekomandimin e dytë, niveli i gjuhës angleze, tanimë është detyrim ligjor për të gjitha institucionet e arsimit të lartë, dhe për rrjedhojë institucioni nuk bën përjashtim dhe i ka të rregulluara kushtet duke pas parasysh që programi zhvillohet në gjuhën Shqipe ndërsa disa prej lendeve te programit te studimit mbahen nga pedagog të angazhuar nga jashtë dhe mësimi mbahet në gjuhën Angleze.

1. Misioni/Objektivat e programit të studimit

Pjesa përshkrimore

Terma reference: Qëllimet dhe objektivat e mësimdhënies dhe kërkimit shkencor, strategjitë afatshkurtra, afatmesme dhe afatgjata, ndjekja dhe përshtatja e objektivave dhe e qëllimeve me kohën, të dhëna të përgjithshme për IAL.

Misioni i Universitetit POLIS është transparent dhe i publikuar, Fakultetet me Departamentet e tyre, zyrat pranë IAL si dhe stafi administrativ i Universitetit POLIS mëtojnë, sigurimin e “Njohurive, Teknologjisë dhe Lidership-it”. Nëpërmjet kërkimit shkencor dhe të aplikuar, U.POLIS zhvillon e promovon “ekselencën shkencore dhe inovacionin”. Ku edukimi akademik, përmirëson kompetencën kreative dhe gjithëpërfshirëse.

Programi i Studimit Master i Shkencave në Menaxhim Mjedisor Urban është aktivizuar duke regjistruar 8 (tetë) studentët e parë në këtë program në vitin akademik 2011-2012.

Në Raportin e vlerësimit të brendshëm citohet:

Qëllimi i Programit të Studimit Master Shkencor në Menaxhim Mjedisor Urban është që të përgatisë studentët profesionalisht si specialistë të aftë për menaxhimin e mjedisit urban dhe si ekspertë për vlerësimin strategjik mjedor, vlerësimin e ndikimit në mjedis dhe auditimin e mjedisit, të aftë për tregun e punës në Shqipëri dhe në vendet e Evropës, me mundësi integrimi në një kontekst shumëdisiplinor, si në sektorin e punësimit privat, ashtu dhe atë publik.

Realitetit të sotëm shqiptar dhe atij më gjerë i nevojiten ekspertë të cilët logjikën mjedisore dhe mendimin njerëzor e përdorin si bazë të arsytimit për të gjitha ndërhyrjet. Do të jetë “detyra” e këtyre specialistëve të ndikojnë pozitivisht kulturën e menaxhimit mjedor në Shqipëri. Ky realitet është vlerësuar gjatë hartimit të planeve dhe programeve mësimore në mënyrë që këta ekspertë të jenë të përgatitur profesionalisht dhe në të njëjtën kohë të aftë për të ofruar leadership në ndryshimin dhe reformimin e këtij sistemi në Shqipëri. Universiteti POLIS ka një ekspertizë në këto fusha dhe synon që përmes këtij programi të studimeve të formojë ekspertë mjedisorë me njohuri të gjera në fushën e mjedisit dhe disiplina që lidhen me të, me fokus mjedisin urban.

Universiteti POLIS, i cili ndër programet e tij të tjera të studimit ka edhe një dimension planifikues dhe menaxherial, dhe e ka propozur fillimisht këtë program studimi për të profilizuar një profesionist i cili në formimin e tij balancon njohuri të fushave mjedisore, planifikuese dhe shkencore me ato menaxheriale. Në këtë mënyrë ky program studimi krijon një profesion të ri në Shqipëri i cili mbush vakuumin e deritanishëm lidhur me trajtimin më të plotë të çështjeve mjedisore. Programi i Studimeve Mjedisore në Universitetin Polis, thellohet më tej në Programin Master Shkencor në Menaxhim Mjedisor Urban. Falë edhe veçorive e karakteristikave të programeve të tjera të studimit të Universitetit POLIS, ky program jo vetëm që plotëson më së miri spektrin e këtyre programeve me fokus mjedisin, por integrohet më së miri me to, duke stimuluar kushtet e një mjedisi pune real dhe shumëdisiplinor dhe duke marrë nga sensi praktik i përdorimit të skenarëve realë për të zgjidhur dhe për të aplikuar teknikat dhe zgjidhjet e duhura për problemet mjedisore, duke bashkëpunuar me studentë nga programet e tjera të lidhura me fushën e mjedisit, por dhe duke qenë pjesë e vazhdimin të studimeve për studentët që përfundojnë studimet në programin Master Shkencor në Menaxhim Mjedisi Urban.

Strategjia e zhvillimit të Universitetit POLIS diskutohet gjerësisht nga autoritetet dhe organet drejtuese të tij. Strategjia miratohet nga Bordi i Themeluesve; pas propozimit në nivel fakulteti dhe miratimit të tij nga Senati Akademik. Strategjia përcakton objektivat e përshtatshme dhe rezultatet e pritshme në shërbim të misionit të tij si një IAL private dhe laike me karakter didaktik, shkencor dhe inovativ.

IAL ka strategjinë e zhvillimit të hartuar dhe të miratuar për periudhën 2014-2020, e cila përmban misionin e institucionit dhe Objektivat strategjike të hartuara e të publikuara në web faqen e Institucionit.

Strategjitë afat mesme dhe afatgjata të IAL dhe të programit të studimit Menaxhim mjedor urban bazohen në kërkesat e dala nga tregu i punës. Konsolidimi i tregut të punës në vend ka indikacion rritjen e kërkesave të shërbimeve profesionale për mjedise më cilësore dhe gjithashtu edhe për ekspert të menaxhimit mjedor dhe Urban dhe imazhit. Duke u mbështetur në rendësinë e profesionit të menaxherit dhe mjedisit urban, sektorët e tregut të punës që targeton ky drejtim janë, në nivele të ndryshme të qeverisjes qendrore dhe vendore, ku pritet të sjellin

një ndikim të ndjeshën në qeverisjen dhe kontrollin e territorit, të bazuar në konceptet e menaxhimit mjedisor urban. Në kompani të ndryshme të sektorit privat, pasi ruajtja e standarteve mjedisore në performancën e këtyre kompanive përbën një kriter të rëndësishëm të vlerësimit të performancës dhe për matjen e suksesit të tyre sipas standarteve europiane. Në studiot private, të cilat ofrojnë konsulencë në fushën e menaxhimit mjedisor urban, apo edhe si pjesë e grupeve të punës shumëdisiplinare që ofrojnë konsulencë në planifikim dhe menaxhim urban. Në organizatat e ndryshme ndërkombëtare, si REC, Banka Botërore, Institucionet Europiane, UNDP etj, të cilat e konsiderojnë mjedisin si një kriter shumë të rëndësishëm vlerësimi dhe zbatojnë projekte të shumta në këtë fushë jo vetëm në Shqipëri, por edhe në vende të tjera. Në institucionet kërkimore shkencore vendase dhe të huaja, të cilat kanë për fokus kryesor mbrojtjen e mjedisit urban.

Nga informacioni i marrë gjatë vizitave në institucion dhe nga RVB, disa nga objektivat kryesorë të programit të studimit Master i Shkencave në Menaxhim Mjedisor dhe Urban janë:

1. Të aftësojë studentët në njohjen e mjedisit, koncepteve, dijeve dhe praktikave shkencore mjedisore dhe të zhvillojnë një aftësi për të vlerësuar dhe për të interpretuar problemet mjedisore në nivel lokal, rajonal dhe global
2. T'u sigurojë studentëve njohuritë themelore dhe të specializuara për analizimin, kuptimin dhe zgjidhjen e problemeve mjedisore.
3. Të përgatisë studentët me aspektet teorike dhe praktike të menaxhimit dhe zhvillimit të qëndrueshëm mjedisor dhe urban.
4. Të përgatisë studentët me një qasje efektive në një mjedis shumëdisiplinor dhe praktik të fushës së mjedisit.
5. Të fitojnë njohuritë të avancuara dhe aftësitë të mjaftueshme për punësim në sektorin publik dhe privat të lidhur me fushën mjedisit.
6. Të sigurojë një sfond shkencor për studime ose kërkime të mëtejshme shkencore.
7. Të aftësojë studentët me njohuri bazë të komunikimit me shkrim dhe verbal, të nevojshme për një karrierë të suksesshme profesionale.
8. Të njohë studentët me çështje e etikës profesionale, sigurisë si dhe impaktin shoqëror të mjedisit.
9. Të hapë horizonte të reja për këtë profesion relativisht të ri në Shqipëri.
10. Të siguroj vazhdueshmëri studentëve të nivelit Bachelor në U-POLIS, dhe nga shkolla tjera me drejtim të përafërt.
11. Të thelloj më tej studimet në kërkim dhe programe PhD, etj.

Grupi i jashtëm i vlerësimit konstaton se Misioni i Institucionit është në përputhje me programin e studimit, ndërsa objektivat e programit të studimit përputhen me kurrikulën si dhe lëndët/modulet e programit të studimit për Menaxhim Mjedisor Urban.

Gjithashtu GVJ gjykon se misioni dhe objektivat janë hartuar në përputhje me llojin dhe nivelin e programit të studimit në fjalë, duke i mundësuar studentëve njohuri të thelluara teorike dhe veçanërisht aftësi praktike për të garantuar një karrierë të suksesshme në organizma si të sektorit privat ashtu edhe atij publik.

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
Standardi I.1 - Institucioni ofron programe studimesh në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij.	
Kriteri 3 Programet e studimeve hartohen në përputhje me misionin dhe qëllimin e institucionit;	Nga vizita në institucion dhe dokumentacioni mbështetës (<i>Rregullorja mësimore e programit të Studimit, Master i Shkencave në Menaxhim Mjedisor Urban</i>) dhe (<i>Statuti i Universitetit POLIS</i>), u konstatua se Programi Master i Shkencave në "Menaxhim mjedisor urban", të Universitetit "POLIS", është hartuar në përputhje me misionin dhe qëllimin e institucionit, të parashikuara këto dy të fundit në nenet 1 (rregullorja) dhe nenet 2 dhe 3 të Statutit të U_POLIS.
Kriteri 4 Programet e studimeve hartohen në përputhje me nevojat e tregut të punës;	
Kriteri 5 Programet e studimeve hartohen në përputhje me zhvillimin ekonomik të vendit;	
Kriteri 6 Programet e studimeve pasqyrojnë vullnetin e institucionit për ruajtjen e vlerave kulturore të kombit.	

	<p>Bazuar në Strategjinë e Zhvillimit të U_POLIS hartimi dhe përditësimi i programit Master i Shkencave në “Menaxhim mjedisor urban” është realizuar sipas nevojave të tregut. Për të realizuar këtë qëllim në RVB por edhe gjatë vizitës u konstatua se U_POLIS mban lidhje të ngushta me sektorët e punësimit (sektori privat, kompanitë kryesore shkencore vendëse dhe te huaja) që kanë fokus kryesor fushën e mjedisit për të siguruar përputhshmërinë e programit të studimeve me nevojat e tregut.</p> <p>Nga IAL cilësohet se ky program studimi fokusohet në, analizat mjedisore, ndryshimet klimatike, planifikimin e qëndrueshëm, vlerësimet e ndikimit të impaktit në mjedis, politikat mjedisore mbi tokën, strehimin, politikat rajonale/kombëtar, dhe ato të peizazhit, çështjet e qeverisjes dhe të legjislacionit mjedisor e të financave të lidhura me to, menaxhimin dhe qeverisjen mjedisore urbane, atë të infrastrukturave, të shërbimeve publike dhe të sipërmarrjeve private, etj.</p>
	<p>Qëllimi i programit të studimit, ashtu siç edhe është paraqitur në RVB, është që të përgatisë studentët profesionalisht si specialistë dhe ekspertë mjedisi, me mundësi integrimi në një kontekst shumëdisiplinor si në sektorin privat, ashtu edhe në atë publik, në Shqipëri dhe më gjerë. Studimi i tregut dhe kuptimi i nevojave aktuale, janë përcaktues të kërkesave për prurje profesionale të fushave të mjedisit, ndërsa IAL ofron kuadër profesional të fushave përkatëse të cilët mund ti shërbejnë kërkesave të tregut të punës. Kjo jo vetëm që bëhej e mundur me studime të mirëfillta duke marrë mendimin e kompanive, institucioneve të cilat kanë një kërkesë për këta lloje studentësh por dhe duke u bazuar në Agjendën e Kërkimit Shkencor, të U_POLIS e cila përcakton fushat prioritare ku institucioni ushtron aktivitetin e tij.</p> <p>Programi Master i Shkencave në “Menaxhim mjedisor urban” ka synim themelor veprimtaritë formuese që kanë të bëjnë me aplikimin e koncepteve të mjedisit dhe për të transformuar pozitivisht shoqërinë duke dhënë një kontribut të rëndësishëm duke influencuar politikat publike ku është përfshirë me ekspertizë dhe punë të stafit e studentëve në një sërë reformash madhore si ajo territoriale e administrative, ajo e decentralizimit dhe qeverisjes vendore, si dhe reforma e arsimit të lartë.</p>
	<p>Kontesti i pasur i vendit dhe kombit me vepra dhe ngjarje artistike përbëjnë pasuri kulturore të cilat janë motivim dhe frymëzim për ruajtjen, ndërtimin dhe zhvillimin e tyre dhe që kjo mund të arrihet në përsosshmërinë më të madhe nga këndvështrimi duke krijuar profesionist të fushave në Menaxhim Mjedisor Urban të cilët janë të krijuara në bazat e njohurive teorike dhe shkencore.</p>

Standardi I.2 - Programet e studimeve janë në përputhje me strategjinë për zhvillim të institucionit.	
Kriteri 1 Programet e studimeve janë përshtatur me strategjinë për zhvillim të institucionit;	Programi Master i Shkencave në “Menaxhim mjedisor urban” është pjesë integrale e zbatimit të misionit që ka institucioni, dhe

(3/10/09) *

J

	<p>ka objektivat për edukimin në fushat e Mjedisit duke u mbështetur në arritjet më të fundit shkencore në fushën e Mjedisit dhe në të njëjtën kohë duke shtuar kompetenca më të veçanta për studentët me njohuritë e përgjithshme që lidhen me multi disiplinat dhe kompleksitetet e fushave të mjedisit, e që për arritjet e tyre nevojitet bashkëpunimi me shumë disiplina.</p> <p>IAL ka strategjinë e hartuar dhe miratuar 2014-2020. Në mënyrë të përmbledhur në strategji është paraqitur agjenda kërkimore prej tri përmbledhjeve të cilat janë.</p> <p>Diskutimi i prioriteteve kërkimore përmes komunikimeve të brendshme dhe të jashtme të institucionit në funksion të misionit dhe strategjisë.</p> <p>Baza e menaxhimit të kërkimeve, prioriteteve kërkimore, zhvillimi i ideve dhe vizioneve kërkimore, duke hedh vështrim në infrastrukturën kërkimore, stafin, publikimet si dhe monitorimi i zbatimit të kësaj agjende.</p> <p>Lidhja në mes të kërkimeve dhe mësimdhënies si proces për sigurimin dhe ngritjen e cilësisë.</p>
	<p>IAL deklaron se përmirësimin e programit të studimit në Master Shkencor në Menaxhim mjedisor urban është si rezultat i monitorimit të efekteve të tregut, informatave kthyes nga kompanitë dhe institucionet gjatë kontakteve me ta.</p>
<p>Standardi I.3 - Programet e studimeve ofrohen në përputhje me aktet ligjore e nënligjore në fuqi.</p>	
<p>Kriteri 1 Përmbatja e programeve të studimeve është në përputhje me kriteret e përcaktuara nga aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi;</p> <p>Kriteri 2 Emërtimi i programit të studimit është në përputhje me nivelin e kualifikimit të arritur dhe të përcaktuar nga Korniza Shqiptare e Kualifikimit.</p>	<p>Programi Master i Shkencave në Menaxhim mjedisor urban i zhvilluar nga Departamenti i Mjedisit në Fakultetin e Planifikimit, Mjedisit dhe Menaxhimit Urban, duke u mbështetur në misionin e Universitetit POLIS përmbush synimin për të ofruar studime të ciklit të dytë në fushën e mjedisit në përputhje të plotë me Misionin e Strategjisë së Zhvillimit të institucionit, si dhe me kriteret e caktuara dhe aktet nënligjore kombëtare në fuqi. Ky program është ndërtuar në respekt dhe zbatim të Ligjit për Arsimin e Lartë si dhe aktet e tjera për të pasur një pajtueshmëri të plotë me to.</p> <p>Programi Master Shkencor në Menaxhim mjedisor urban është një program vazhdimësi e programit BSc në Studime Mjedisore I cili zhvillohet në IAL.</p> <p>Emërtimi i programit të studimit është vendosur në përputhje me nivelin e kualifikimit të arritur dhe të përcaktuar nga Korniza Shqiptare e Kualifikimit.</p>
	<p>Programi i Studimit të Ciklit të Dytë në Menaxhim Mjedisor Urban përkon me Nivelin e 7 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimit.</p>
<p>Standardi I.11 - Institucioni harton një plan zhvillimi të programeve të studimeve, të rezultateve të mësimdhënies dhe të të nxënit.</p>	

(E. R. R. O. O. *)

	<p>Mbështetur në Strategjinë e zhvillimit 2014-2020, Universiteti POLIS është “Hapësirë universitare për Mendim” në fushat e politikave për zhvillimin territorial-hapësitor, Menaxhim Mjedisor Urban, ndërtimtarinë dhe teknologjinë, si dhe për lidhshpirtin qytetar e sipërmarrjen private. Ky plan Strategjik i miratuar nga Senati i U-Polis mbështet dhe zhvillimin e institucionit, ku shpjegohet misioni dhe vizioni si; objektivat afatmesme dhe afatgjata të IAL.</p> <p>Universiteti POLIS i ka kushtuar një vëmendje të veçantë realizimit të objektivave të mësimdhënies dhe të nxënit, si komponenti bazë për konsolidimin e institucionit, me synimin për t’u identifikuar dhe dalluar si një institucion që ka një fokus të mirë përcaktuar dhe që ofron një shërbim cilësor për studentët.</p> <p>Për përmirësimin e procesit të mësimdhënies universiteti ka një metodologji shumë të qartë vlerësimi.</p> <p>1. Vlerësimi i procesit mësimor nëpërmjet formularëve për performancën e pedagogut. Ky proces realizohet nga katër komponentë:</p>
<p>Kriteri 1 Institucioni harton një plan strategjik në nivel institucioni për zhvillimin dhe përmirësimin e programeve të studimeve; Kriteri 2 Institucioni harton një plan strategjik në nivel institucioni për përmirësimin e rezultateve të mësimdhënies dhe të të nxënit.</p>	<p>1.1 Vlerësimi i pedagogut nga studenti; 1.2 Vlerësimi i kolegut nga kolegu; 1.3 Vetëvlerësimi; 1.4 Vlerësimi nga eprori.</p> <p>2. Vlerësimi i stafit akademik bazuar në aktivitetin e tyre kërkimor shkencor.</p> <p>3. Mobiliteti i stafit akademik por edhe atij administrativ nëpërmjet projekteve të ndryshme Erasmus+, kjo mënyrë operimi bën të mundur përfitimin e eksperiencave të rreja, në mësimdhënie por dhe në procesin kërkimor të stafit dhe studentëve.</p> <p>Mënyra e menaxhimit të programit është rregulluar në përputhje me Ligjin e Arsimit, duke filluar nga viti akademik 2011-2012. Programi ofrohet nga Fakulteti i Planifikimit, Mjedisit dhe Menaxhimit Urban, përkatësisht Departamenti i Mjedisit. .</p> <p>U_POLIS ka një plan strategjik në nivel institucioni të miratuar me Vendim nga Senati Akademik Nr.1 datë 7 25.09.2014, mbi të cilin është mbështetur dhe zhvillimi i institucionit, ku shpjegohet misioni dhe vizioni si dhe objektivat afatmesme dhe afatgjata të institucionit.</p> <p>Universiteti POLIS i ka kushtuar një vëmendje të veçantë realizimit të objektivave të mësimdhënies dhe të nxënit, si komponenti bazë për konsolidimin e institucionit, me synimin për t’u identifikuar dhe dalluar si një institucion që ka një fokus të mirë përcaktuar dhe që ofron një shërbim cilësor për studentët.</p> <p>Programet e studimeve të Institucionit vazhdimisht marrin informata kthyes nga Shoqata ALUMNI e ish-studentëve të diplomuar, nga vijnë sugjerimet, si dhe nga partnerët ndërkombëtar, grupeve të vlerësimeve përmes të cilëve</p>

ekuilibrohen treguesit e matshëm të vlerave të programeve, nevojave të freskimit të tyre, plotësime dhe ndryshime eventuale.

Cilësia e mësimdhënies është objektivi kryesor përmes të cilës Institucioni synon vlerat maksimale të nxënies. IAL ka sistem të ngritur të kontrollit permanent të cilësive të mësimdhënies përmes pyetësorëve periodik të vlerësimit të pedagogëve të angazhuar. Ky vlerësim bëhet nga ana e Studentëve, kolegëve dhe vetëvlerësimi. Institucioni ka të ngritur NJBSC (Njësia e Brendshme e Sigurimit të Cilësisë) e cila me punën e sajë dëshmon për sistemin e kontrollit të cilësive të mësimdhënies dhe rezultatet e nxënies të Studentëve.

Vlerat dhe cilësitë e mësimdhënies reflektojnë direkt te studenti dhe performanca e tij si dhe arritja e rezultateve nxënëse duke plotësuar kompetencat nga objektivat e Institucionit.

Mësimdhënësve ju mundësohet që të përgatiten dhe të marrin informacionet më të reja të metodave bashkëkohore të mësimdhënies. Kjo ndihmë ju ofrohet përmes punës ndëraktive të personelit Akademik të institucionit.

Konkluzionet e vlerësimit:

- 1. Institucioni ofron programe studimesh në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij. Gjatë vizitës por dhe shqyrtimit të dokumentacionit u konstatua se Programi Master i Shkencave në Menaxhim Mjedis Urban, përputhet plotësisht me misionin dhe objektivat e Institucionit. Studentët janë fokusi parësor i IAL dhe permanent inkurajohen që të luajnë rol aktiv në përmirësimin e mëtejshëm të programit të studimit duke vlerësuar mësimdhënien, rezultatet e nxënies dhe duke i ushtruar kompetencat e tyre në projekte të ndryshme.**
- 2. IAL ka përmirësuar kapacitetet e veta në drejtim të burimeve njerëzore, infrastrukturës, aspektet financiare dhe menaxheriale.**
- 3. GVJ konfirmon se Universiteti POLIS, ka një strategji të zhvillimit e vlefshme kjo për periudhën 2014-2020, e hartuar me profesionalizëm duke përfshirë çdo fushë e cila ka të bëjë me zhvillimin akademik, mësimor, shkencor të një institucioni. Programi në fjalë është hartuar në përputhje me Ligjin e Arsimit të Lartë dhe akteve nënligjore të tij, si dhe me Strategjinë e Zhvillimit të Universitetit POLIS.**
- 4. Rezulton se institucioni harton një plan zhvillimi të programeve të studimeve përmes agjendës kërkimore, të cilat tentojnë të ngritin rezultatet e mësimdhënies e që ndërliken me rezultatet e të nxënies, si komponent bazë për konsolidimin e institucionit me synimin për t'u identifikuar dhe dalluar si një institucion që ka një fokus mirë përcaktuar dhe që i ofron studentëve një shërbim cilësor.**

2. Struktura akademike e Fakultetit (Departamentit përgjegjës për programin e studimit)

Pjesa përshkrimore

Terma reference: përbërësit e njësive dhe stafet e tyre, kompetencat, Baza e të dhënave të njësive, freskimi i vazhdueshëm i saj dhe përgjegjësitë e mbajtjes dhe dhënies së informacionit

Universiteti POLIS në strukturën e tij organizative përbëhet nga tre fakultete dhe një qendër studimore ndërdisiplinore, konkretisht 1. Fakulteti i Arkitekturës dhe Dizajnit; 2. Fakulteti për Kërkim dhe Zhvillim; 3. Fakulteti Planifikim, Mjedis dhe Menaxhim Urban; 4. Qendra Studimore Ndërsiplinore Kërkimore e Inovacionit. Secili Fakultet është i organizuar në njësi bazë dhe ka në përbërjen e tij dy departamente dhe një qendër

kërkimore. Fakulteti bashkërendon mësimdhënien, kërkimin dhe zhvillimin kulturor në fusha mësimore-kërkimore të përafërta ose të ndërthurura si dhe ofron programe studimi të niveleve të ndryshme në përfundim të të cilave përfitohet diplomë e specifikuar sipas programit të kryer nga studenti. Autoriteti drejtues i tij është Dekani.

FAKULTETI PLANIFIKIM, MJEDIS DHE MENAXHIM URBAN (FPMMU) përbëhet nga:

Departamenti Planifikim dhe Menaxhim Urban

Departamenti i Mjedisit

Qendra Kërkimore e Qëndrueshmërisë

Fakulteti i Planifikim, Mjedis dhe Menaxhim Urban është njësia kryesore brenda së cilit është vendosur dhe menaxhohet Programi Master i Shkencave në Menaxhim Mjedis Urban.

Departamenti përgjegjës për këtë program studimi është **Departamenti i Mjedisit**. Autoriteti drejtues i tij është Përgjegjësi i Departamentit. Veprimtaria, programet dhe projektet me të cilat punojnë departamentet miratohen nga Senati akademik.

Grupi i vlerësimit të jashtëm mbështetur në dokumentacionin e dorëzuar së bashku me RVB si dhe në bisedat me stafin dhe dokumentet e vëna në dispozicion gjatë vizitës së kryer pranë ambienteve të Universitetit POLIS, konstatoi se të tre njësitë bazë të Fakulteteve, Departamentet si dhe Qendra Kërkimore kanë në përbërje të tyre staf akademik me kohë të plotë dhe me kohë të pjesshme. Secila njësi bazë plotëson kushtet e përcaktuar nga ligji ku minimumi tre pjesëtarë të stafit akademik të jenë me gradën shkencore “Doktor”.

Gjithashtu u konstatua se profili i stafit akademik të angazhuar në këtë program studimi përputhet më së miri me programin Master i Shkencave në Menaxhim mjedisor urban. Kjo ndikon në përmbushjen e standardeve të programit.

Gjithashtu vihet re se edhe stafi i cili është angazhuar me kohë të pjesshme është një staf i kualifikuar dhe profesionist në fushën që mbulon. Kjo bën të mundur ofrimin e një aspekti praktik dhe konkret të organizimit të programit.

Stafi i angazhuar në këtë program përbëhet nga Personel Akademik Efektiv dhe Personel Akademik me Kontratë. Personel Akademik me Kontratë përbëhet nga personeli akademik i jashtëm, pedagogët senior dhe lektorët e ftuar.

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

Në Fakultetin Planifikim, Mjedis dhe Menaxhim Urban, përkatësisht në Departamentin e Mjedisit, Personeli Akademik i angazhuar për vitin akademik 2018/2019 përbëhet prej 16 pedagogësh nga të cilët 9 janë Personel Akademik Efektiv (PAE) - (1 Prof Dr; 1 Prof As; 3 Dr dhe 4 Dr në proces); dhe 7 janë Personel Akademik me Kontratë (PAK) – (1 Dr; 1 Dr në proces; 5 Msc). Raportet mes Personelit Akademik Efektiv (PAE) dhe Personel Akademik me Kontratë (PAK) janë 9/7. (Anekse, tabela 1)

Mbështetur në të dhanat e përcjella me Dosjen e vetvlerësimit, konkretisht Aneks/Shtojcë Organigrama e vitit akademik 2016/2017, Departamenti i mjedisit përbëhej nga 7 PAE (1 Prof. Dr; 1 Prof As; 1 Dr dhe 4 Dr në proces).

Ndërsa për vitin akademik 2017/2018, po sipas Aneks/Shtojcë Organigrama e vitit akademik 2017/2018, Departamenti i mjedisit përbëhej nga 7 PAE (1 Prof. Dr; 1 Prof As; 2 Dr; 3 Phd në proces)

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

Struktura akademike e Fakultetit (organigrama)

Mbështetur në RVB por edhe në takimet e ndryshme të realizuara gjatë vizitës, GVJ bie dakord se:

- Universiteti POLIS është institucion i organizuar dhe vetë-financuar, me përgjegjësi të forta sociale. Themeluesit janë një grup i spikatur profesionistësh shqiptarë, aktivistë të shoqërisë civile dhe akademikë që synojnë krijimin e “masës kritike” të ekspertëve dhe liderëve të sipërmarrjes private, të aftë për të shtyrë Shqipërinë dhe rajonin drejt BE dhe trendeve globale.

- POLIS ka tri njësi kryesore; tre Fakultete si dhe "Qendra Studimore Ndërdisciplinore Kërkimore dhe Inovacionit". Çdo Fakultet përbëhet nga tri njësi bazë: dy Departamente dhe një Qendër Kërkimore.
- Në total, ky Institucion, ka në përbërje këto struktura: 3 Fakultete, 6 Departamente, 3 Qendra, dhe 3 Partnerë Strategjikë Kërkimorë, të vendosur në kampusin e U_POLIS: Instituti për Zhvillimin e Habitatit (Co-Plan); Studio e Arkitekturës dhe Projektimit Urban (Metro_POLIS); si dhe partneri në mbrojtjen e të drejtave të profesionit: AUA - Unioni i Arkitektëve, Urbanistëve dhe Planifikuesve Urbanë.
- Universiteti POLIS, ka mirëpërcaktuar "Strukturat e Pavarura" të cilat garantojnë funksionimin dhe qeverisjen e mirë të institucionit.

KËSHILLI I PROFESORËVE

Përbëhet nga kryetari dhe anëtarët. Detyrat dhe përgjegjësitë e Këshillit të Profesorëve janë:

- Miratimi i propozimeve për personat që kanë aplikuar për të mbrojtur doktoraturën.
- Miratimi i dosjeve të personave që kanë aplikuar për tituj akademik dhe përcjellja për procedim të mëtejshëm sipas akteve nënligjore në fuqi.

BORDI I ETIKËS

Trajton probleme të natyrës etiko-morale midis komunitetit student-staf akademik-staf kerkues. Bordi përbëhet nga përfaqësues të stafit akademik, administratori, nga të cilët kryetari emërohet nga Rektori.

NJËSIA E BRENDSHME E SIGURIMIT TË CILËSISË

Është një njësi që ndjek gjithë procedurat për garantimin e cilësisë në procesin mësimor dhe kërkimor në U_POLIS, përfshi vlerësimin 360 gradë të stafit dhe organizatës, bashkë me vlerësimin e vetë studentëve dhe në bashkëpunim me drejtuesit e Institucionit dhe njësiteve, merr masat e duhura për përmirësim kur është e nevojshme. Kjo Njësi ka për detyrë të bëjë vlerësimin e të gjithë elementëve të cilësisë sipas standarteve të ENQA-s, të vlerësojë periodikisht procesin mësimor si dhe efikasitetin e veprimtarive mësimore dhe kërkimore.

SENATI STUDENTOR

Është pjesë e strukturës të Universitetit POLIS që ushtron veprimtarinë e tij në koordinim me organet drejtuese të Universitetit. Qëllimi kryesor i Senatit Studentor është angazhimi dhe aktivizimi i studentëve në aktivitete që lidhen ngushtë me veprimtaritë akademike por dhe me ato jashtë akademike që promovojnë jetën aktive dhe sociale të studentëve.

Shoqata e ish-studentëve_ALUMNI

Kjo strukturë përbëhet nga Asambleja Kushtetuese dhe Bordi Ekzekutiv, ushtron veprimtarinë e saj në koordinim të ngushtë me organet drejtuese të Universitetit POLIS dhe ka në fokus mbarëvajtjen profesionale të individëve që kanë kryer studimet në U_POLIS.

Personeli akademik për çdo njësi bazë: PAE, PAK, PA, titujt/gradat, (në aneks, Tabela 2 dhe Tabela 3)

Personeli Administrativ është i përberë nga 32 veta. Raportet e Personelit Akademik me Personel Administrativ është i matshëm vetëm në nivel të Institucionit pasi që Administrata i shërben të gjithë programeve të studimit të Universitetit POLIS. Numri i studenteve për vitin Akademik 2017/2018 ishte 21 (aneks, Tabela 20) dhe 2018/2019 është 28 (gjithsej viti i parë dhe viti i dytë i programit të studimeve Master Shkencor në Menaxhim Mjedisor Urban është 51).

Personeli Akademik ka ngarkese vjetore 24 deri 338 ore mësimore me një mesatare prej 160 orë vjetore. Ndërsa Programi i studimit Menaxhim Mjedisi Urban ka ngarkese vjetore ne total 1134 orë ne auditor (Leksione, Seminare/Laboratorë, Ushtrime, Praktikë Profesionale, Kurse, studim i pavarur i studentit).

Për sa më lart shih në Aneks Tabelat

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
Standardi II.2 - Institucioni organizohet në përputhje me aktet ligjore e nënligjore në fuqi, për përmbushjen e misionit të tij.	

<p>Kriteri 1 Institucioni organizohet në mënyrë që të përmbushë misionin e tij;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni ka së paku dy Fakultete;</p> <p>Kriteri 3 Fakulteti organizohet në njësi bazë. Çdo fakultet ka, së paku, tri të tilla, nga të cilat dy departamente;</p> <p>Kriteri 4 Fakulteti ose Instituti i Kërkimit dhe Zhvillimit përbëhet nga, së paku, 3 njësi bazë me objektiva dhe mision të mirëpërcaktuar;</p> <p>Kriteri 5 Departamenti duhet të ketë në përbërje të tij të paktën 7 anëtarë efektivë si personel akademik, ndër të cilët të paktën 3 duhet të jenë me gradën shkencore “Doktor”.</p>	<p>GVJ vërejti se Personeli akademik dhe ai ndihmës akademik pranë Universitetit POLIS, dhe konkretisht ai i Fakultetit Planifikim, Mjedis dhe Menaxhim Urban, janë të angazhuar në mënyrë të vazhdueshme për të garantuar realizimin e objektivave të programit të studimit për Master i Shkencave në Menaxhim mjedisor urban.</p> <p>IAL ka në përbërje këto struktura: 3 Fakultete, 6 Departamente, 3 Qendra, dhe 3 Partnerë Strategjikë Kërkimorë, të vendosur në kampusin e U_POLIS: Instituti për Zhvillimin e Habitatit (Co-Plan); Studio e Arkitekturës dhe Projektimit Urban (Metro_POLIS); si dhe partneri në mbrojtjen e të drejtave të profesionit: AUA - Unioni i Arkitektëve, Urbanistëve dhe Planifikuesve Urban.</p> <p>Fakulteti Planifikim, Mjedis dhe Menaxhim Urban përbëhet nga këto Departamente:</p> <p style="padding-left: 40px;">Departamenti Planifikim dhe menaxhim Urban Departamenti i Mjedisit Qendra Kërkimore e Qëndrueshmërisë.</p> <p>Departamenti si njësi bazë, të organizuara pranë Fakultetit Planifikim, Mjedis dhe Menaxhim Urban (bazuar në tabelat nga RVB për vitin akademik 2018/2019) kanë në përbërje 16 anëtarë akademik efektivë nga të cilët 6 janë me grada dhe tituj.</p> <p>IAL ka të themeluara edhe disa nga organe kolegiale të cilat sigurojnë funksion të mirë të Institucionit sikur janë këshilli i etikës, këshilli i profesorëve, NJSBC, Zyra e këshillimit për studentët dhe Zyra e karrierës.</p>
<p>Standardi II.3 - Njësitë e institucionit angazhohen drejtpërdrejt dhe me përkushtim për realizimin e programeve të studimeve.</p>	
<p>Kriteri 1 Njësitë bazë dhe kryesore janë të ndërgjegjshme për përgjegjësitë që kanë për realizimin e programeve të studimeve;</p> <p>Kriteri 2 Njësitë bazë dhe kryesore përfshihen në procesin e rekrutimit të personelit akademik të nevojshëm dhe në vlerësimin e tij.</p>	<p>Në takimet me stafin dhe duke u bazuar në dokumentacionin përkatës (<i>Statutin e Institucionit dhe Rregulloret e Përgjithshme</i>) u konstatua se Fakulteti përgjegjës, përkatësisht Fakulteti Planifikim, Mjedis dhe Menaxhim Urban dhe Departamenti i cili merret me organizimin dhe menaxhimin e programit Master i Shkencave në Menaxhimin mjedisor urban janë plotësisht të ndërgjegjshëm për përgjegjësitë që kanë për realizimin e programit dhe kjo është treguar në mënyrë kohezive nga vitet e kaluara të veprimtarisë në këtë program studimi.</p> <p>Vetë stafi demonstroi mënyrat e procesit të rekrutimit ku përfaqësues të fakultetit dhe departamentit përfshiheshin në mënyrë aktive në procesin e rekrutimit. Ky proces u verifikuar bazuar dhe në dokumentacionin mbështetës që u pa në zyrën e Burimeve Njerëzore. Por jo vetëm pasi i gjithë procesi mbështetej në Rregulloren e Përgjithshme si dhe në Strategjinë e Burimeve Njerëzore dhe Procedurën e Rekrutimit të stafit të U_POLIS.</p>
<p>Konkluzionet e vlerësimit:</p> <p>1. Institucioni organizohet në përputhje me aktet nënligjore në fuqi me qëllim përmbushjen e misionit të tij. Kjo strukturë ka arritur gjithmonë duke u përmirësuar me qëllim zbatimin e nevojave institucionale, kërkesave ligjore dhe standardeve të cilësisë. Në përputhje dhe në përshtatje të Ligjit të Arsimit, theksojmë se Universiteti POLIS, ka bërë një ri-shpërndarje të</p>	

programeve pranë departamenteve, dhe kjo ka bërë të mundur që konkretisht Departamenti i Mjedisit të marrë një rol më të madh dhe më të drejtpërdrejtë në menaxhimin dhe mbarëvajtjen e Programit Master i Shkencave në Menaxhimin mjedisor urban.

2. Standardi për numrin e personelit akademik të rregullt plotësohet dhe është i rregulluar me kontrata të rregullta pune duke respektuar të gjitha ligjet dhe normat ligjore në vend.
3. Gjatë vizitës në institucion është vërejtur përkushtimi maksimal i stafit Akademik të rregullt për përmbushjen e misionit dhe objektivave për këtë program studimi në Menaxhimin Mjedisor Urban, kjo duke dëshmuar edhe sukseset e tyre.

3. Personeli akademik dhe personeli mbështetës për programin e studimit

Pjesa përshkrimore

Terma reference: Të dhëna për kualifikimin e Personelit akademik, ndarja e tij në Personel Akademik Efektiv (PAE) dhe Personel Akademik me Kontratë (PAK), Personel Administrativ (PA), raportet PAE/PAK, raportet: Personel akademik/Personel administrativ/student; nevojat për Personel akademik/ administrativ, shpërndarja e ngarkesës për personelin akademik, marrëdhëniet me strukturat e tjera jashtë kohës së punësimit, kriteret e rekrutimit të personelit akademik, etj.

Mbështetur në RVB dhe të dhënat nga Zyra e Burimeve Njerëzore, Fakulteti Planifikim, Mjedis dhe Menaxhim Urban (me tre departamentet e sajë; Planifikim dhe Menaxhim Urban; Mjedis; Qendra kërkimore e Qëndrueshmërisë) ka staf prej 51 personave, nga të cilët 26 PAE dhe 25 PAK si dhe pjesa e administratës e cila numëron 52 të punësuar në nivel të IAL. Ndërsa nga gjithsej 51 pedagog, 25 nga ta mbajnë tituj ose grada (51%). Nga 26 stafi i brendshëm, 13 mbajnë tituj ose grada (50%) ndërsa nga stafi i ftuar të tillë janë 12 nga 25, d.m.th 48%. Raporti staf efektiv/staf me kontratë në nivel të Fakultetit është 1.04:1. Stafi i jashtëm është i angazhuar kryesisht në programet Master Profesional, por jo vetëm, duke sjellë ekspertizë specifike të fushave të planifikimit dhe administrimit të biznesit. Një pjesë e stafit të jashtëm janë ekspert të shkollave partnere IPAG Paris dhe Institutit IHS, Rotterdam, Holandë.

Në departamentin e Mjedisit (aneks, Tabela 6) Personeli Akademik i angazhuar për vitin akademik 2018-2019 përbëhet prej 20 pedagogesh nga të cilët 17 janë Personel Akademik Efektiv (PAE) dhe 3 janë Personel Akademik me Kontratë (PAK). Raportet mes Personelit Akademik Efektiv (PAE) dhe Personel Akademik me Kontratë (PAK) janë 17/3, ose 85% janë PAE ndërsa 15% janë PAK.

Për vitet akademike paraprake të programit duke ju referuar tabelave nga RVB stafi akademik janë të angazhuar sipas:

viti akademik 2012/2013; PAE/PAK = 15/6	raporti (PAE/PAK) - (71/29) %
viti akademik 2013/2014; PAE/PAK = 15/6	raporti (PAE/PAK) - (71/29) %
viti akademik 2014/2015; PAE/PAK = 12/4	raporti (PAE/PAK) - (75/25) %
viti akademik 2015/2016; PAE/PAK = 12/5	raporti (PAE/PAK) - (70/30) %
viti akademik 2016/2017; PAE/PAK = 15/5	raporti (PAE/PAK) - (75/25) %
viti akademik 2017/2018; PAE/PAK = 13/5	raporti (PAE/PAK) - (73/27) %
viti akademik 2018/2019; PAE/PAK = 17/3	raporti (PAE/PAK) - (85/15) %

Sipas titujve dhe gradave, PAE dhe PAK në vite akademike paraqitet si më poshtë:

viti akademik 2012/2013; **15 PAE** - 6 Prof Dr; 4 Dr; 1 Dr në proces; 2 Msc; 2 MND
6 PAK - 1 Prof Dr; 3 Dr; 2 Msc
viti akademik 2013/2014; **15 PAE** - 5 Prof Dr; 4 Dr; 2 Dr në proces; 2 Msc; 2 MND
6 PAK - 2 Dr; 1 MND; 3 Msc

viti akademik 2014/2015; **12 PAE** – 3 Prof Dr; 4 Dr; 3 Dr në proces; 2 MND

4 PAK – 3 Msc; 1 MND

viti akademik 2015/2016; **12 PAE** – 3 Prof Dr; 1 Prof As; 4 Dr; 3 Dr në proces; 2 MND

5 PAK – 3 Dr; 2 Msc

viti akademik 2016/2017; **15 PAE** – 3 Prof Dr; 1 Prof As; 5 Dr; 5 Dr në proces; 1 MND

5 PAK – 3 Dr; 1 Msc; 1 MND

viti akademik 2017/2018; **13 PAE** – 2 Prof Dr; 1 Prof As; 5 Dr; 4 Dr në proces; 1 MND

5 PAK – 4 Dr; 1 Msc

viti akademik 2018/2019; **17 PAE** – 4 Prof Dr; 1 Prof As; 5 Dr; 7 Dr në proces

3 PAK – 2 Dr; 1 Msc

GVJ ju komunikua gjatë vizites se Stafi Akademik Efektiv përveç detyrimeve mësimore ka angazhime edhe në fushat e tjera sikur janë kërkimet shkencor ose të aplikuar, shërbime për zhvillimin dhe sigurimin e cilësisë në IAL, këshillim për studentët, marrëdhëniet ndërkombëtare të institucionit përkatësisht të Universitetit POLIS, aktivitete lokale-vendore duke u përfshirë në projekte të ndryshme konkrete duke ndihmuar komunitetin dhe me kryesorja një pjesë e madhe Personelit Akademik Efektiv kohë të madhe ju dedikohet kërkimeve shkencore, pjesëmarrje në konferenca Kombëtare dhe Ndërkombëtare. Disa nga Personeli Akademik kanë angazhime edhe rreth menaxhimit të vetë Departamentit, Fakultetit përkatësisht Universitetit duke qenë koordinatore të programeve, udhëheqës të Departamenteve, komisioneve brenda njësisive Akademike etj. Personeli Akademik ka ngarkese vjetore 24 deri 338 ore mësimore me një mesatare prej 160 orë vjetore. Ndërsa Programi i studimit për Menaxhim Mjedisor Urban ka ngarkese vjetore në total 1134 orë në auditor (Leksione, Seminare/Laboratorë, Ushtrime, Praktikë Profesionale, Kurse, studim i pavarur i studentit).

IAL ka një praktikë lidhur me stafin akademik të ri të angazhuar. Personeli i cili ka përvojë më pak se 3 vite në mësimdhënie angazhohet si asistent, dhe pas kësaj periudhe kohore mund të fitoj kontratë për angazhime dhe shërbime më të avancuara. Gjatë takimit me stafin akademik në IAL është vërejtur ngarkesë më e madhe e asistentëve në mësim (30 orë në javë).

Për rekrutimin e Personelit Akademik nga Universiteti POLIS ekzistojnë procedura ligjore, transparente, të cilat realizohet edhe përmes detyrave kontraktuale për secilin person, ndërsa metodikat didaktike në shumë raste freskohen (përmirësohen) forcohen me metoda të avancuara të dhënies së mësimit, vlerësimit, përmes takimeve brenda Fakultetit dhe Personelit Akademik. Rekrutimi i personelit Akademik të drejtimit Menaxhim Mjedisor Urban me kontrata të veçanta kthehet në terma të referencës me detyra të specifikuara qartë. Termat e referencës janë të specifikuara në varësi të lëndës që do të ofroj pedagogu, natyrën e mësimdhënies, kompetencat dhe shkathtësitë personale të tij.

Për rastet e përcaktimit të detyrave të personelit për profilin e propozuar nga Departamenti bazohen në përmbajtjen e lëndës që do të ofrojë Pedagogu, natyrën e mësimdhënies dhe performancën e njohurive dhe aftësive të cilat transferohen te Studentët.

Nga vizita në Institucion konstatoam se i gjithë dokumentacioni lidhur me Personelin Akademik Efektiv dhe të jashtëm ishte i plotë.

Vlerësimi sipas Standardeve

Numri i Personelit Akademik Efektiv (PAE) dhe Personelit Akademik me Kontratë (PAK), titujt/ gradat, (Tabelat 3, 4, 5 dhe 6, të cilat janë plotësuar nga verifikimi i tabelave të pasqyruara në RVB)

Të dhënat e detajuara për stafin akademik që mbështet programin e studimit janë dhënë në Aneks, Tabela 3, 4, 5 dhe 6

Për vitin akademik 2017-2018 (aneks, Tabela 6) raporti rezulton 17 PAE/3 PAK (85% / 15%)

Raporti në mes të Personelit Akademik dhe Studenteve (viti i parë dhe i dytë 21+28=49) është 20/49 ose 2.45 student për një Personel Akademik që është tregues i mirë i performancës të Institucionit, përkatësisht Departamentit.

Të dhënat sipas kualifikimit, kontratës dhe Raportet midis tyre (Tabela 4)

Raporti i Personelit Akademik Efektiv me gradat e tyre si dhe të Personelit Akademik me kontratë është dhënë në tabelën 4, dhe gradat e personelit akademik janë më shumë se Doktor i shkencave.

Të dhënat sipas seksit (Tabela 5) dhe të dhëna sipas moshës së personelit (Tabela 6)

Sipas seksit (për vitin akademik 2018/2019, PAE) në këtë departament aktivizohen 10 pedagogë të gjinisë femërore dhe raporti është 10/7 që i bie të jetë 59% femra dhe 41% meshkuj. Sipas moshës në nivel Fakulteti janë 12 pedagogë moshë (25-35) ose në shkallë përqindjeje 46%, 6 moshë (36/45) ose 23%, dhe 6 me moshë (46-65) ose 23% dhe 2 personel me moshë mbi 66 vite ose 8% (aneks, Tabela), nga mund të konkludohet se pedagogët e angazhuar në këtë program studimi i përkasin moshës së re me afërsisht 50%.

Kontratat e punës, njohja me detyrat dhe të drejtat

I gjithë stafi Akademik si dhe Personeli Administrativ i Angazhuar ne Universitetin POLIS kalojnë nëpër procedurat e rekrutimit të cilat janë pjesë e statutit të Universitetit si dhe rregulloreve tjera te miratuara nga Senati i Universitetit ne pajtim me legjislaturën ne nivel te Shtetit.

~~Procedurat e pranimit te Personelit Akademik janë: bëhet njoftimi nëpër mediat sociale si dhe ne web faqen e universitetit POLIS lidhur me konkursin për nevojat e personelit. Nga te interesuarit janë format teknike dhe kërkesat për plotësimin e dokumentacionit të nevojshëm për konkurrim. Bëhet rangimi i kandidatëve potencial të mundshëm për pranim dhe ju caktohet koha për intervista. Pas intervistave bëhet vlerësimi i secilit kandidat për kriteret e veçanta dhe më pastaj bëhet përzgjedhja e kandidatit.~~

Kandidati i zgjedhur nënshkruan kontratën në të cilën përshkruhen detyrimet, të drejtat e tyre, shpërblimet financiare, ngarkesa mujore si dhe kërkesat më specifike.

Personeli akademik/mbështetës ndërton marrëdhënien e punësimit me institucionin në bazë të kontratës së punësimit. Të drejtat dhe detyrat e personelit akademik, ngarkesa dhe format e saj përcaktohen në kontratën e lidhur mes tij dhe U_POLIS. Kontratat janë në përputhshmëri me kuadrin ligjor në fuqi dhe rregullativa të institucionit. Kontrata e punës përmban detyrimet, detyrat dhe të drejtat e çdo personi që rekrutohet. Ajo është mjaft e detajuar dhe e plotë.

Personeli akademik është i inkurajuar të marrë pjesë në aktivitete që ndihmojnë në zhvillimin e komunitetit, duke ofruar bashkëpunim dhe ekspertizë. Pjesëmarrja e suksesshme e personelit akademik në të tilla aktivitete vlerësohet si tregues performance dhe indikator vlerësimi dhe promovimi për personelin.

Cilësia e stafit ndihmës/ administrativ për çdo njësi bazë

Numri i stafit Administrativ i Universitetit POLIS është 32 dhe ka detyrat e veta të specifikuar në kontrata individuale dhe është përgjegjës për të gjithë Universitetin. Sipas Organogramës administrata ndahet në njësitë: Burimet njerëzore & Çështjet Juridike - Protokoll, Administrimi i Procesit Mësimor & Sekretaria Mësimore, dhe Financa, Shërbime, Administrim.

~~Mbajtja e shënimeve realizohet sipas ligjeve ne nivel Shteti. Efikasiteti i shërbimeve është jashtëzakonisht i shpejtë dhe cilësor ndërsa siguria e të dhënave është në nivel shumë të mirë.~~

Stafi ndihmës është me diplomë BSc dhe MSc.

Dokumentacioni përkatës i marrë në vizitat në institucion

Nga vizita në Institucion u njohëm me të gjithë dokumentacionin që i takon kësaj pike dhe konstatojmë se në to nuk ka ndryshime dhe si të tilla ato përmbushin standardet që lidhen me këta tregues.

Dokumentacionet e kërkuara gjatë vizitës në institucion për qëllim të vetëm: sigurimi i cilësisë së informatës, vijueshmërisë së aktivitetit si dhe dëshmi për deklaratimet janë përzgjedhur si dokumentacione:

- Formularët 1, 2 dhe 3 - forma e vlerësimit të rekrutimit të pedagogeve;
- Strategjia e kualitetit të Cilësisë nga U-Polis 2017-2022,
- CV e pedagogut,
- Sistemi i pikësimit për pedagogët.
- Lista e lëndëve të ndryshuara nga kurrikulat paraprake.
- Lista e stafit akademik nga fillimi i programit deri ne 2017/2018.

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
Standardi II.1 - Personeli akademik, ndihmës mësues-shkencor dhe administrativ angazhohen për përmbushjen e objektivave të programeve të studimeve.	
<p>Kriteri 1 Personeli akademik, ndihmës mësues-shkencor dhe administrativ i institucionit angazhohen në përputhje me objektivat e programeve të studimeve dhe për arritjen e tyre;</p> <p>Kriteri 2 Personeli akademik, ndihmës mësues-shkencor dhe administrativ i institucionit angazhohen në përputhje me strategjinë për zhvillim të institucionit.</p>	<p>Objektivat e programit të studimit për Departamentin e Mjedisit të hartuara nga IAL realizohen nëpërmjet shërbimeve Administrative si dhe personelit Akademik të angazhuar.</p> <p>Rekrutimi i Personelit Akademik kryhet sipas proceduarve ligjore në përputhje me Statutin dhe rregulloret e Institucionit.</p> <p>Angazhimi i Personelit Akademik në arritjen e Objektivave nga Kurrikula bëhet përmes lëndëve dhe moduleve si dhe syllabuseve të tyre. Në secilin syllabus janë të specifikuara objektivat e lëndës që shkojnë paralel me objektivat e përgjithshme.</p>
	<p>Objektivi kryesorë i programit të studimit duke qenë që është të përgatisë Studentin profesionalisht në fushat për mjedis realizohen duke u mbështetur në nivelin e përgatitjes së Studenteve të cilët vijnë nga cikli i parë i studimeve me kompetenca të mjaftuara (studimet bachelor) për të arritur nivel më të lartë të kompetencave në fushat më të gjëra të mjedisit përmes Lëndëve dhe moduleve teorike, ushtrimeve numerike, Laboratorëve, punës praktike, vizitave në terrene si dhe një mori aktiviteteve tjera që çojnë drejt arritjes së këtij qëllimi të përgjithshëm.</p> <p>Stafi Administrativ, dhe Menaxherial i Fakultetit, përkatësisht Universitetit angazhohen në maksimum që Studentëve të ju ofrohen shërbime cilësore, në kuptimin e shpejtësisë, saktësisë dhe sigurisë. Të gjitha këto shërbime janë paketë shërbimi që prodhojnë cilësi duke numëruar infrastrukturën e Fakultetit, shërbimet e informacioneve, kontratat, Bibliotekën etj..</p> <p>Strategjia e programit është paralel me Strategjinë e IAL duke u mbështetur në "Vizioni i Universitetit POLIS është të ofrojë ekselencë në edukimin e profesionistëve dhe kërkuesve shkencorë të aftë për të adresuar nevojat e tregut dhe shoqërisë në fushat e interesit në vend dhe jashtë tij".</p>
	<p>Institucioni ka të gjithë dokumentacionin lidhur me rekrutimin e personelit Akademik dhe Administrativ.</p>
Standardi II.4 - Personeli akademik angazhohet në hartimin dhe zbatimin e politikave të zhvillimit të institucionit.	
<p>Kriteri 1 Personeli akademik luan rol kryesor në hartimin e kurrikulës dhe në vendimet institucionale që i përkasin organizimit të programeve të studimeve;</p> <p>Kriteri 2 Rekrutimi i personelit të ri dhe përcaktimi i ngarkesës mësimore bëhet në</p>	<p>Në kuadër të Fakultetit të Planifikim, Mjedis dhe Menaxhim Urban është ngritur grupi punues për hartimin e raportit të vlerësimit të brendshëm.</p>

përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi.

Si nevojë e funksionimit të drejtë të programit IAL ka udhëheqësin dhe koordinatorin e programit studimor me qëllim funksionimin e drejtë të programit.

Çdo fund viti akademik IAL organizon "Workshop-in e Kërkimit Shkencor". Në këtë aktivitet 3 ditore përcaktohen qartë objektivat e secilit departament, strategjitë e zhvillimit institucional në nivel afatmesëm dhe afatgjatë, dhe se si objektivat e secilit departament shkojnë në linjë me strategjitë institucionale. Çdo fillim viti, në Dekanat dhe në Departamentin e Mjedisit diskutohen syllabuset e çdo lëndë në grupe të ngushta në mënyrë që të përmirësohemi në mënyrë të vazhdueshme dhe gjithashtu të marrim edhe perceptimet e kolegëve për çështje të caktuara.

Koordinatori i programit kujdeset së bashku me stafin Akademik dhe Administrativ që të freskoj kurrikulën dhe të organizoj programin e studimit. Nga viti i parë i fillimit të studimeve 2011/2012 dhe deri sot janë bere ndryshime në kurrikulën e programit dhe këto ndryshime janë më pak se 20%, përkatësisht +5% nga totali i 120 ECTS e programit e vërtetuar nga vizita dhe tabela shtesë e kërkuar (janë ndërruar lëndët nga lënda "Laborator Planifikim i Qëndrueshëm" në lëndën "Menaxhim i Tokës Bujqësore"; nga "Teori Planifikimi i Qëndrueshëm" në "Menaxhimi i Ujërave"; nga "Biodiversiteti" në "Menaxhimi i zonës Bregdetare") dhe të gjitha lëndët e ndryshuara kanë peshën e njëjtë të kredive, secila nga 6ECTS. Këto ndryshime janë bërë me qëllim të arritjes së objektivave në mënyrë sa më të përsosur duke ndërruar ose shtuar lëndë dhe module studimi.

Personeli akademik i angazhuar në programin e studimit MSc në Menaxhim Mjedisor Urban është shtytësi kryesor që çon më tej përmbushjen e Objektivave kryesore dhe të veçanta. Në çdo fillim viti akademik diskutohen syllabuset e çdo lënde në grupe të ngushta në mënyrë që vazhdimisht të përmirësohen dhe përsosën rezultatet e nxënies.

Rekrutimi i personelit Akademik dhe Administrativ realizohet sipas akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi duke dëshmuar me kontrata të rregullta pune për stafin Akademik (Efektiv ose me Kontratë) si dhe për Administratën, duke vlerësuar edhe peshën e tyre kohore dhe detyrimet dhe obligimet kontraktuale. Ato janë shumë të rregullta, të rinovueshme për personelin me kontratë pune dhe azhurnohen kohë pas kohe.

Standardi III.1 - Institucioni ndjek procedura ligjore dhe transparente për rekrutimin dhe vlerësimin e personelit.

Kriteri 1 Institucioni ndjek procedura ligjore dhe transparente për rekrutimin e personelit në përputhje me statutin dhe rregulloren;
Kriteri 2 Personeli akademik i punësuar me kohë të plotë në programet e studimeve të ciklit të dytë dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë përbën së paku 70% të personelit akademik të angazhuar për

Procedurat ligjore për rekrutimin e personelit Akademik janë në përputhje ligjore duke përshkruar se Institucioni bënë shpalljen publike të njoftimit për punësim në rrjetet sociale si dhe web faqen e Universitetit POLIS dhe se ekziston rregullorja për rekrutimin e personelit.

realizimin e programeve respektive të studimeve;
Kriteri 3 Institucioni ndjek procedura ligjore dhe transparente të vlerësimit të personelit;
Kriteri 4 Institucioni mban një bazë të dhënash të raporteve të rekrutimit të personelit, të njoftimeve për vende vakante, etj.

IAL ka të sanksionuar në rregullore kriteret dhe procedurat për rekrutimin e personelit akademik. Në të përcaktohen kriteret të përgjithshme si dhe specifike rast pas rasti, sipas fushës akademike të ekspertizës që kërkohet.

Parimet, kriteret dhe procedurat për punësimin e personelit akademik efektiv dhe me kohë të pjesshme janë të përcaktuara në Statut dhe Rregulloren e Përgjithshme.

Është në interes më të mirë të IAL rekrutimi i një stafi të aftë profesional dhe të kualifikuar prandaj dhe kriteret shpallen publikisht dhe përzgjedhja bëhet me konkurrim të hapur duke ndjekur hapat e mëposhtëm:

- ✓ Departamenti dhe Fakulteti nxjerr nevojat për staf të ri duke bërë publike vendet e lira si dhe kriteret dhe kërkesat specifike për plotësimin e tyre;
- ✓ Njoftimi vendoset në faqen elektronike të institucionit si dhe vihet në dijeni Shërbimi Kombëtar i Punës.
- ✓ Kandidatët paraqesin CV e shoqëruar me dokumentet e nevojshme pranë institucionit;
- ✓ Realizimi i intervistave të punës sipas datave të përcaktuara nga rektorati. Në rastin e stafit me eksperiencë të pakët mësimdhënëse, kandidatit/ kandidatës i kërkohet të zhvillojë një orë mësimi dhe gjithashtu të prezantoj punët e veta kërkimore dhe shkencore. Ky është mjete më i vlefshëm për të parë cilësitë e aplikantëve kandidat për staf akademik;
- ✓ Shpallja e kandidatit fitues dhe kontaktimi me Zyrën e Burimeve Njerëzore për njohjen e dokumentacionit të nevojshëm për punësim si dhe lidhja e kontratës së punës.

Kandidati i zgjedhur nënshkruan kontratën në të cilën përshkruhen detyrimet, të drejtat e tyre, shpërblimet financiare, ngarkesa mujore si dhe kërkesat më specifike.

Në programin e studimeve në fjalë, për vitin akademik 2018/2019 Raporti i Stafit Akademik Efektiv me Stafin Akademik të angazhuar është 85% me 15% (17 Efektivë/3 me kontrate).

Gjatë vizitës në Institucion vërtetimi i procedurave për mënyrën e zgjedhjes ka qenë në vlerësimin e ekzemplarëve të rastësishëm dhe se janë gjetur se vlerësimi i stafit Akademik ka qenë transparent, i paanshëm dhe ka siguruar cilësi në arritjen e Objektivave.

Përqindja e ngarkesës së pedagogëve me kohë të plotë kundrejt atyre me kontratë përbën 90% orëve totale në auditor.

Administrata e Universitetit është e rregullt në mbajtjen e datotekës së përgjithshme të gjithë të punësuarve në IAL. Shënimet janë vërtetuar nga rasti në rast.

Rekrutimi i Personelit Akademik është transparent dhe zhvillon këtë procedurë administrative: bëhet njoftimi nëpër mediat

(E. R. R. O. A.)*

q

	<p>sociale si dhe ne <i>web</i> faqen e universitetit POLIS lidhur me konkursin për nevojat e personelit.</p> <p>Nga të interesuarit janë format teknike dhe kërkesat për plotësimin e dokumentacionit të nevojshëm për konkurrim.</p> <p>Bëhet radhitja e kandidatëve potencial të mundshëm për praninë dhe ju caktohet koha për intervista.</p> <p>Pas intervistave bëhet vlerësimi i secilit kandidat për kriteret e veçanta dhe më pastaj bëhet përzgjedhja e kandidatit</p>
<p>Standardi III.2 - Personeli akademik (me grada shkencore dhe tituj akademikë) mbulon nevojat e institucionit dhe i ka të përcaktuara qartë përgjegjësitë.</p>	
<p>Kriteri 1 Përgjegjësi i programit ka të paktën titullin “Profesor i asociuar” ose, gradën shkencore “Doktor” (“PHD”) të fituar pranë universiteteve perëndimore dhe përvojë akademike në këto universitete;</p> <p>Kriteri 2 Titullari i lëndës/modulit në programet e studimeve “Master i Shkencave” ka të paktën gradën shkencore “Doktor”;</p> <p>Kriteri 3 Titullari dhe pedagogët e lëndës/modulit në programet e studimeve “Master profesional” ka të paktën gradën shkencore “Doktor” ose, diplomën “Master Profesional” ose “Master Shkencash” dhe një përvojë profesionale së paku 5-vjeçare në profesionin në të cilin ofrohet ky program studimi;</p> <p>Kriteri 4 Rektori, zv/rektori, drejtori dhe zv/drejtori i qendrës ndëruniversitare, dekani, zv/dekani, drejtori, përgjegjësi i departamentit, përgjegjësi i shërbimit, përgjegjësi i programit janë të punësuar me kohë të plotë në institucionin që ofron programin e studimeve;</p> <p>Kriteri 5 Institucioni siguron personel të mjaftueshëm për udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e praktikave profesionale.</p>	<p>Përgjegjës i programit të studimeve Master Shkencor në Menaxhim mjedisor urban është edhe përgjegjësi i Departamentit të Mjedisit, Prof Asoc Dr. E. Susaj.</p> <p>Në matricën e lëndëve të cilat zhvillohen të gjithë bartësit e lëndëve janë me gradë shkencore Doktor dhe një PhD në proces. Stafin nga departamentet tjera janë të përfshirë në lëndët e këtij programi të studimi me qëllim që të plotësohen lëndët me mësimdhënës me grada shkencore Dr.</p> <p>I gjithë stafi menaxherial i Institucionit i cili udhëhiqet nga Rektori, zv Rektori, Dekanët, zv. Dekan, shefat e departamenteve, koordinatorët e programeve janë të punësuar me kohë të plotë.</p> <p>Praktikat Profesionale që zhvillojnë Studentët në këtë program studimi MMU, kanë program pune dhe i nënshtrohen kontrolleve.</p> <p>Një rol shumë të rëndësishëm në menaxhimin e programit të studimit kryen edhe zyra për mbështetje dhe këshillim karriere.</p> <p>Krahas rolit të kësaj zyre në mirëpritjen dhe orientimin e studentëve, zyra në fjalë së bashku me departamentin përcaktojnë institucionet ku do të zhvillohet praktika profesionale dhe caktojnë një staf Akademik cili ndjek zhvillimin korrekt të praktikës mësimore në institucionin pritës. Vlerësimi i studentëve për praktikën profesionale bëhet nga një komision vlerësues.</p> <p>Praktika profesionale zhvillohet në vitin e dytë të studimeve përkatësisht në semestrin e parë.</p> <p>Pas përfundimit të praktikës, Studenti fiton 3 ECTS dhe nuk vlerësohet me notë (3 ECTS nuk hynë në notën përfundimtare të studimeve). Totali i orëve të punës në praktikë duhet të përmbajë 75 orë. Sipas Bolonjës të gjitha lëndët/modulet (kreditë e fituara) duhet të jetë të vlerësuar me notë, prandaj</p>
	<p>Institucioni <u>rekomandohet</u> që praktikën profesionale të e vlerësoj me notë.</p> <p>Praktikat profesionale zhvillohen kryesisht pranë kompanive me të cilat institucioni ka ose jo marrëveshje bashkëpunimi. Proces ky që menaxhohet me efektivitet më të madh. Në rast se studentët zgjedhin të zhvillojnë praktikën pranë ndonjë</p>

	<p>institucioni tjetër, atëherë departamenti në bashkëpunim me zyrën për mbështetje dhe këshillim karriere do të marrë informacion paraprak dhe më pas do të vlerësojë nëse praktika mund të zhvillohet apo jo pranë këtij institucioni. E gjitha kjo bëhet për të siguruar një praktikë sa më të sigurt dhe sa më efektive.</p>
<p>Standardi III.5 - Studentët që ndjekin programet e studimeve të ciklit të dytë “Master i Shkencave” apo programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë kanë udhëheqës për tezën.</p>	
<p>Kriteri 1 Studentët që ndjekin këto programe studimesh kanë një udhëheqës për punën kërkimore dhe tezën që përgatisin për marrjen e diplomës në përfundim të studimeve të këtij cikli;</p> <p>Kriteri 2 Udhëheqësi ka të paktën gradën shkencore “Doktor”;</p> <p>Kriteri 3 Udhëheqësi nuk mbikëqyr më shumë se 5 (pesë) studentë njëkohësisht për temat me karakter kërkimor të aplikuar (si ato të ofruara në programet e studimeve në fushat e shkencave të natyrës, shkencave mjekësore, etj.) dhe më shumë se 10 (dhjetë) studentë njëkohësisht për temat e ofruara në programet e studimeve në fushat e shkencave shoqërore e humane.</p>	<p>Temat e diplomave në programin e studimit MSc në Menaxhim Mjedisor Urban zhvillohen gjatë gjithë vitit të fundit të studimit në trajtë studio. Në programin e studimit janë 7 titullarë lëndësh/modulesh që kanë të paktën gradën shkencore “Doktor”, të cilët udhëheqin studentët në punën e tyre kërkimore-shkencore për përgatitjen e tezës së diplomës, dhe konkretisht: Prof. Dr. Sh. L; Prof. Dr. V. M; Prof. Dr. Gj I; Prof. Ass. Dr. E. S; Dr. T. B;, Dr. E. K;, Dr. P. H.</p> <p>Një ditë në javë ju dedikohet vetëm procesit të diplomimit. Në fakt është caktuar që çdo enjte të jetë ditë pune me grupin e diplomantëve dhe me mësimdhënësit duke bërë prezantim dhe duke vlerësuar progresin e punës së diplomës për secilin kandidat në mënyrë hap pas hapi.</p> <p>Ky proces mbështetet edhe nga lënda “Metoda Kërkimore” që kristalizon akoma më shumë të gjithë procesin e kërkimit shkencor të studentëve. Raporti pedagog student për ndjekjen e temave të diplomave në çdo rast është më i ulët se 1 me 5, ndërsa secili Student ka një temë dhe një mentor.</p> <p>Në vitin e parë dhe të dytë në programin e studimit Menaxhim Mjedisi Urban janë gjithsej 49 studentë.</p>
<p>Standardi III.6 - Fusha studimore-kërkimore në të cilën është specializuar udhëheqësi është në përputhje me fushën studimore në të cilën ofrohet programi i studimit dhe është parashikuar të përgatitet teza.</p>	
<p>Kriteri 1 Fusha studimore-kërkimore në të cilën është specializuar udhëheqësi është në përputhje me fushën studimore në të cilën ofrohet programi i studimit.</p> <p>Kriteri 2 Udhëheqësi ka njohuri të avancuara teorike dhe aftësi të veçanta kërkimore në fushën në të cilën ofrohet programi i studimeve dhe në të cilën është parashikuar të hartohet teza.</p>	<p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vendosur në dispozicion, GVJ shprehet se stafi Akademik i angazhuar (Efektiv apo me kontratë) ka përgatitje profesionale të fushave të mjedisit, menaxhimit të mjedisit dhe planifikimit Urban.</p> <p>Kompetencat e stafit Akademik sidomos në fushat e ngushta profesionale ju ofrojnë Studentëve Qasje dhe Rezultate të nxënies bashkëkohore në: mjedis, menaxhim të mjedisit dhe planifikim Urban, etj. dhe kjo shkon paralel me qëllimin e programit i cili synon gjithashtu të fokusoj studentët në komponentët e menaxhimit, politikëbërjes në funksion të mjedisit të qëndrueshëm dhe cilësisë së jetës, përfshi edhe menaxhimin me ndjeshmëri mjedisore të ndërmarrjeve private duke formuar një figurë profesionale që balancon njohuri të fushave inxhinierike, planifikuese dhe shkencore me ato menaxheriale.</p>

(E. V. R. O. P. *)

Gjithashtu dhe Udhëheqësit e Universitetit, Fakultetit, Departamentit dhe Qendrave të kërkimit janë të fushave të Mjedisit të cilat fusha janë të shtrira edhe në Objektivat e profileve si dhe në Misionin e Institucionit.

Në fillim të vitit të dytë të studimeve në Programin e studimit Menaxhim mjedisor urban, Studentëve ju ofrohen orientimet e temave të mundshme për diplomë.

Fushat e diskutuara me ta janë: mjedisit, menaxhim të mjedisit dhe planifikimit urban.

Udhëheqësi i programit si dhe stafi Akademik ka njohuri të thella dhe të avancuara në fushat e sipërpërmendura dhe jo vetëm.

Studentët gjatë gjithë kohës së studimeve përdorin edhe *software*-at profesional për menaxhim mjedisor dhe planifikim Urban të cilat ndihmojnë në rritjen e shpejtësisë së punimit të Diplomës dhe cilësisë së sajë.

Standardi III.7 - Institucioni angazhon personel ndihmës mësimor-shkencor dhe administrativ për përmbushjen e misionit të tij.

Kriteri 1 Institucioni dëshmon një angazhim optimal të personelit ndihmës mësimor-shkencor për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve shkollore;

Kriteri 2 Institucioni dëshmon një përdorim optimal të burimeve njerëzore për përmbushjen e objektivave të programeve të studimeve të ciklit të dytë.

Institucioni ka të zhvilluara aktivitetet shkencore, studimore, hulumtuuese, të mbështetura në shumë faktor nga të cilët meritohet janë padyshim përveç personelit Akademik edhe pjesa tjetër e personelit që përcjell punën me Studentët. Dhe personeli tjetër ndihmës janë Laborantët që menaxhojnë me laboratorët dhe pajisjet e tyre, mirëmbajtësit e ambienteve shkollore (vlen për tu theksuar se pastërtia e ambienteve të mësim, tualeteve, banjave, etj janë në nivel shumë të kënaqshëm). Udhëheqësit e bibliotekës, Co-Plani si studio projektimi. Studentëve ju ofrohet edhe zyra e IT-së e cila asiston në mënyrë të vazhdueshme për të gjithë të interesuarit.

Laboratorët pran IAL kanë avancime në inventarizimin e tyre me pajisje të avancuara dhe me kompetenca të shtuara të cilat ju ndihmojnë Studentëve dhe jo vetëm për kërkime shkencore, punimet e diplomës si dhe në mësimdhënie. Gjatë vizitës në ambientet e IAL, përkatësisht laboratorëve u vërejt puna me studentët në proces të mësim nxënies cilësore. Duke pas parasysh trendët e zhvillimit të shpejt dhe avancimin e cilësive të materialeve, produkteve dhe gjysmë produkteve në treg atëherë IAL i mbetet rekomandim që të rrisë pajisjet, shërbimet dhe kapacitetet e laboratorëve për nevojat e studentëve.

Të gjitha këto shërbime që ju ofrohen Studentëve, kanë për qëllim që të jetë siguruar cilësia e mësimdhënies, dëshira për të studiuar thellësisht dhe arritja e kompetencave profesionale në nivelin çfarë kërkon tregu vendor dhe i jashtëm.

Standardi III.8 - Personeli akademik realizon ngarkesën mësimore të përcaktuar në aktet ligjore e nënligjore në fuqi.

Kriteri 1 Personeli akademik realizon ngarkesën mësimore të përcaktuar në aktet ligjore e nënligjore në fuqi;
Kriteri 2 Ngarkesa mësimore e zhvilluar nga personeli akademik në programet e studimeve të ciklit të dytë dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë dhe organizimi e drejtimi i tyre, vlerësohen me orë mësimore.

Nga takime të ndryshme ne UPolis, GVJ ju komunika se gjatë gjithë kohës (orarit të plot të punës) personeli Akademik si dhe Administrata janë prezentë në Fakultet. Ngarkesa e mësimdhënësit (varësisht nga natyra e Lëndës/ Modulit dhe Personelit Efektiv dhe me kontratë) sillen nga 24 orë mësimi deri në maksimum 338 orë mësimi. Vlera mesatare e ngarkesës së Personelit Akademik sillet rreth 160 orë vjetore e që është në përputhje me aktet nënligjore për aktivitetet dhe standardet mësimore të Personelit Akademik për këtë nivel të arsimit.

Numri gjetur i Studentëve në dy vitet shkollore për Master shkencor në Menaxhim Mjedisi Urban është 49. Raporti student pedagog është (49/20) 2.45 student për Pedagog.

Standardi III.9 - Institucioni disponon një bazë të dhënash për personelin e tij.

Kriteri 1 Institucioni disponon një bazë të dhënash të hollësishme për anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit;
Kriteri 2 Institucioni disponon për secilin semestër listën e plotë të personelit akademik, të personelit ndihmës mësimor-shkencor dhe personelit administrativ;
Kriteri 3 Institucioni përcakton dhe publikon kriteret dhe procedurat për rekrutimin e personelit akademik.

GVJ konstatoi se:

- Për të gjithë Personelin Akademik të angazhuar në procesin e mësimdhënies, Efektiv apo me Kontratë të pjesshme dhe Personelin e Administratës, plotësohet dhe arkivohet i gjithë dokumentacioni i nevojshëm i kërkuar nga Zyra Rajonale e Punës, përfshirë këtu edhe CV individuale të detajuar si dhe materiale të tjera të kërkuara nga Zyra e Burimeve Njerëzore dhe Juridike.

- Për çdo semestër përkatësisht vit akademik të ndarë sipas profileve Departamenti ka listën e plotë të stafit Akademik dhe personelit ndihmës në procesin mësimor. Kjo listë është e qasshme për Studentët në çfarëdo kohe që ata kanë nevojë.

- Kriteret dhe procedurat për rekrutimin e stafit Akademik janë publike dhe kushdo që ka interesim për to mund të marr informatën nga mediat sociale si dhe nga web faja elektronike e Institucionit.

Konkluzionet e vlerësimit:

1. GVJ konstaton se Personeli Akademik dhe personeli mbështetës i programit të studimit, të angazhuar në mësimdhënie dhe në aktivitetet tjera përcjellëse për nevojat e IAL, përkatësisht studentëve janë të përgatitur profesionalisht dhe me gradë e cila kërkohet edhe nga standardet për programin e studimit Master i Shkencave në "Menaxhim mjedisor urban". Ata rekrutohen me procedura të rregullta dhe transparente të cilat sigurojnë një cilësi të mirë për studentët dhe aktivitetet akademike.
2. Administrata e institucionit është profesionale, garanton shërbime të shpejta, cilësore, efikase dhe të sigurta. Nga vizita e bërë vërehen cilësi në shërbime, siguri të informacionit, pacënueshmëri të të dhënave personale të individëve dhe një hierarki të urdhrave dhe funksioneve respektuese.
3. Përveç angazhimeve mësimore Stafi Akademik ka detyrime edhe në fushën e kërkimeve shkencore si, pjesëmarrja në aktivitete hulumtuese dhe shërbimeve tjera profesionale, të cilat plotësojnë misionin dhe objektivat e Institucionit.
4. Organizimi i temave të diplomave, puna intensive përmes takimeve të progreseve të tyre dëshmon punën dhe përkushtimin e Stafit të IAL për të arritur objektivat në kurrikulat mësimore dhe kompetencat te produkti i tyre.

5. Ndërsa nga pikëpamja e menaxhimit (arkivimit-ruajtjes-sistemimit) të dokumentacionit, proceduarave të rekrutimit të Personelit dhe të dhënave për kualifikimin e Personelit Akademik çdo gjë është në rregull.
6. Gjatë gjithë kohës së punës të IAL (nga fillimi i programit 2011/2012 dhe deri në këtë vit akademik 2018/2019) në programin e studimit për Master Shkencor në Menaxhim Mjedisor Urban është respektuar kushti nga Standardi për personelin Akademik PAE dhe PAK 70% / 30%.

Rekomandime/ sugjerime:

- Pedagogët asistent të cilët me ngarkesën maksimale mbajnë mësim, të ju mundësohet që të kenë orë më pak në mësimdhënie dhe të motivohen dhe të orientohen me punë në hulumtime shkencore.
- Sugjerohet që IAL, përkatësisht programi i studimeve Menaxhim mjedisor urban, praktika profesionale të vlerësohet me notë.
- Kapacitetet e laboratorëve pran IAL të rriten permanent duke ju mundësuar Studentëve në programet e studimeve të marrin kompetenca sa më reale me kërkesat aktuale në tregun e punës

4. Infrastruktura në funksion të programit të studimit, logjistika dhe shërbime të tjera ndaj komunitetit

Pjesa përshkrimore

Terma reference: mjediset, infrastruktura, teknologjitë e informacionit, biblioteka, shërbime të tjera për studentët, residenat.

GVJ, mbështetur në RVB por edhe në vizitën dy ditore, mendon se Universiteti POLIS ofron një infrastrukturë të përshtatshme dhe bashkëkohore për realizimin e aktiviteteve të nevojshme për të gjitha disiplinat, duke ofruar mjedise të brendshme por dhe të jashtme të cilat mund të konsiderohen tepër cilësore dhe plotësojnë më së miri kushtet për studimi dhe punë të pavarur të studentëve.

GVJ vizitoi ambientet e universitetit si klasat, auditorët, laboratorët, sallat e studimit, bibliotekën por dhe hapësirat e tjera të përbashkëta të studentëve të cilat përdoren për studentët. Të gjitha ambientet mund të konsiderohen bashkëkohore dhe që plotësojnë më së miri nevojat e studentëve. Gjithashtu u konstatua se kishte hapësira të mjaftueshme për stafin akademik por dhe atë administrativ, të pajisur me infrastrukturë të përshtatshme për kryerjen e kërkimeve akademike, shkencore dhe të aplikuara.

Sipas Raportit të Vlerësimit të brendshëm laboratorët në kuadër të IAL kryejnë këto funksione dhe shërbime;

Laboratori funksionon në përputhje me vizionin, statutin dhe rregulloren e Universitetit, standardet dhe rregulloren e miratuar për funksionimin e tij.

Objektivi bazë i Laboratorit është, që studentët të zhvillojnë praktikat mësimore, të kryhen analiza kimike e fizike të mostrave të tokës dhe ujit, si për të konkretizuar procesin e mësimdhënies dhe realizimin e kërkimit shkencor, bazuar në metoda standarde si dhe në interpretimin e rezultateve në bashkëpunim me pedagogët e fushave përkatëse. Nëpërmjet analizave, studentët të kuptojnë më mirë teorinë e zhvilluar, aspektet praktike, të përfitojnë disa rezultate për përgatitjen e detyrave të kursit, për përgatitjen e tezës së diplomës dhe të marrin njohuri të thelluara në punën kërkimore - shkencore. Laboratori disponon pajisje si Multiparametër, Fotometër, pH metër, Konduktometër, Disregues, Distilator Kjeldal UDK 129, Peshore Analitike dhe Teknike, Distilator Uji, Hidrometër, Sterilizator, Set Kite toke, përzierës, matës të treguesve të ndotjes ajrit, zhurmës, lagështirës, pajisje të marrjes së mostrave, etj.

Analizat kryesore laboratorike janë ato të ujit: pH, konduktiviteti elektrik, sasia e kripave të tretura në ujë, elementëve të ndryshëm kimikë, O₂ i tretur, tregues kimike, etj.

Analizat e tokës: cilësitë kimike e fizike, pH, N, P, K, si dhe tregues të ndotjes së ajrit, nivelin e zhurmave, intensiteti i dritës, etj. Rezultatet e përfituara synohet të ndikojnë dhe të përfshihen sa të jetë e mundur edhe

në programet dhe sistemin e monitorimit të mjedisit në nivel kombëtar, mbrojtjen e mjedisit dhe në përmirësimin e standardeve kombëtare.

Në laborator janë vendosur materiale demonstrimi si profile të tipeve të tokave të Shqipërisë, shkëmbinj, lloje drurësh, harta, imazhe të degradimit mjedisor dhe peizazhit, pajisje, manuale të pajisjeve laboratorike, herbariume me bimë të ndryshme të florës shqiptare, etj, me të cilat konkretizohen aspektet praktike të mësimdhënies.

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

Mjediset për Programin e studimit

Duke ju referuar Aneks, Tabela 10, atëherë sipërfaqet e hapësirave të IAL janë si më poshtë:

• Salla për leksione	1,062 m ²
• Klasa për seminare	587 m ²
• Salla për aktivitete promovuese	216 m ²
• Salla për praktikë lëndore/ profesionale	288 m ²
• Laboratorë për lëndët	180 m ²
• Laboratorë informatike	145 m ²
• Salla interneti	240 m ²
• Salla për bibliotekë	155 m ²
• Mjedis për fotokopjime, librari etj	111 m ²
• Korridore	1,172 m ²
• Mjedise Sportive	1,000 m ²
• Mjedisi shërbimi (Co-Plan)	227 m ²
• Nyje hidrosanitare	303 m ²
• Hapësira të përbashkëta shfrytëzuese relaksi	563 m ²

Sipërfaqja e përgjithshme e ambienteve të IAL për studentet është 6,259 m²

Mjediset për stafin:

• Mjedise për Rektorin/Dekanan/zv Dekanin	126 m ²
• Mjedise për zv Rektorin	16 m ²
• Zyra për sekretarinë mësimore	47 m ²
• Zyra për departamentet/qendrat kërkimore	62 m ²
• Zyra për personelin akademik	100 m ²
• Zyre për financa	25 m ²
• Zyre për njësinë e Bnj? juridike/protokollin	25 m ²
• Salla për mbledhje	30 m ²
• Mjedise për stafin e shërbimit	89 m ²

Sipërfaqja e përgjithshme e ambienteve të IAL për stafin është 520 m²

Bazuar në shënimet e IAL, numri i studenteve në hapësirat për studentët ka vlerën e matshme 6.1 m² sipërfaqe për një student.

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
Standardi II.5 - Institucioni siguron infrastrukturën e nevojshme për realizimin e programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe të programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë që ofron.	

<p>Kriteri 1 Institucioni ka një vendndodhje të përhershme, që nënkupton mjedis qendror administrativ dhe mjedis ku zhvillohet veprimtaria mësimore;</p> <p>Kriteri 2 Këto mjedise janë në dispozicion të institucionit për jo më pak se 6 vjet;</p> <p>Kriteri 3 Nëse programi i studimit ofrohet në më shumë se një godinë, institucioni siguron menaxhim efikas dhe kontroll të vazhdueshëm për arritjen e standardeve dhe zbatimin e politikave arsimore të hartuara për realizimin e programeve të studimeve që ofron;</p> <p>Kriteri 4 Institucioni garanton kapacitete dhe mjedise të mjaftueshme për realizimin e praktikave profesionale të parashikuara për realizimin e programeve të studimeve në fushat e shëndetësisë, veterinarisë, bujqësisë, shkencave teknike, etj.</p>	<p>U_POLIS ka zhvilluar një formulë kreative partneriteti privat-privat për të mundësuar realizimin e një infrastrukture mësimore afatgjatë. Bordi Themelues i U_POLIS dhe Kler. Shpk kanë nënshkruar një marrëveshje ombrellë për zhvillimin e përbashkët të infrastrukurës me konceptin e bashkëpunimit për 99 vjet, e detajuar kjo më tej përmes një kontrate me të drejtë rinovimi çdo 10 vjet.</p> <p>Si rezultat U_POLIS edhe pse në një kontekst global dhe kombëtar të vështirë për shkak të krizës ekonomike, ka zbatuar me sukses një formulë tepër të avancuar që vjen nga përvojat e vendeve perëndimore, duke garantuar në përfundim një kampus universitar kompakt prej 1 hektar toke, me 2 objekte (1 prej të cilave rezervë dhe në dispozicion të nevojave të rritjes institucionit) si dhe me lehtësira të tjera si hapësira publike, terrene sportive, parkim, gjelbërim, etj.</p> <p>Universiteti është e lidhur mirë me qytetin me 4 linja transporti publik njëra prej të cilave ofrohet falas nga U_POLIS dhe tjetra nga QTU.</p>
---	---

Standardi V. 1- Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën e tij.

<p>Kriteri 1 Institucioni siguron tekste mësimore cilësore dhe literaturë ndihmëse të mjaftueshme dhe bashkëkohore;</p> <p>Kriteri 2 Në bibliotekë ka literaturë të mjaftueshme që e ndihmon studentin për për realizimin me sukses të programit të studimit, të projektit kërkimor shkencor dhe për përgatitjen e tezës;</p> <p>Kriteri 3 Në bibliotekë ka botime periodike dhe librari elektronike, të cilat përmbajnë libra apo revista shkencore të nevojshme për realizimin me sukses të programit të studimit, të projektit kërkimor shkencor dhe për përgatitjen e tezës;</p> <p>Kriteri 4 Përgjegjësit e programit kanë hartuar një plan të detajuar për shtimin e zërave të bibliotekës në mbështetje të programit të studimit, të projektit kërkimor shkencor dhe për përgatitjen e tezës nga studentët, përfshirë edhe buxhetin e planifikuar për këtë qëllim;</p> <p>Kriteri 5 Biblioteka ka orare të shërbimit në përshtatje me oraret e programeve të studimeve dhe nevojat e studentëve.</p>	<p>Biblioteka e U_POLIS ka një fond aktual prej 10,000 titujsh në përputhje me programet që ofron.</p> <p>Biblioteka ka një literaturë të mjaftueshme por dhe të shumëllojshme e cila i vjen në ndihmë studentëve që dëshirojnë të përdorin këto burime, për realizimin e projekteve, kërkimeve shkencore por dhe përgatitjen e tezave të U_POLIS.</p> <p>Nga vizita në bibliotekë u konstatua se ndodheshin periodikë të ndryshëm të shkruar por dhe elektronikë të revistave me influencë shkencore por jo vetëm.</p> <p>Drejtuuesi i Fakultetit por dhe Përgjegjësi i Departamentit përgjegjës për këtë program studimi ishin shumë të angazhuar për pasurimin e vazhdueshëm të bibliotekës. Kjo bëhej e mundur nëpërmjet:</p> <ul style="list-style-type: none"> ✓ Buxhetit të Departamentit; ✓ Donacioneve nga partnere te ndryshëm; ✓ Kontribute te projekteve EU (TEMPUS, Erasmus +) etj ✓ Publikime/përkthime nga vete stafi i U_POLIS. <p>Biblioteka ishte në dispozicion të studentëve gjatë gjithë ditës, madje ofronte shërbim edhe ditëve të veçanta në fundjavë. Biblioteka ishte e pajisur me hapësirat e nevojshme për punë të pavarur.</p> <p>Institucioni ka si objektiv pasurimin e mëtejshëm të bibliotekës me tekste dhe botime në shqip në fushën e mjedisit dhe menaxhimit urban. Për këtë program</p>
--	---

	<p>studimi, janë botuar nga Universiteti POLIS disa publikime të ndryshme.</p> <p>Biblioteka funksionon çdo ditë të javës (nga e hëna në të diel), përveç festave zyrtare, dhe është në shërbim të studentëve nga ora 08:00-17:00.</p>
<p>Standardi V. 2- Institucioni vë në dispozicion të studentëve laboratorë të mjaftueshëm dhe mjedise të përshtatshme mësimore.</p>	
<p>Kriteri 1 Institucioni dëshmon se ka në sasi të mjaftueshme: laboratorë, klasa, zyra, studio e mjedise të tjera me pajisje elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, për realizimin e programit të studimeve;</p> <p>Kriteri 2 Pajisjet e mjediseve mësimore janë të përshtatshme për mësimdhënie në përputhje me qëllimet e programit;</p> <p>Kriteri 3 Laboratorët përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme për plotësimin e kërkesave të programeve të studimeve dhe për zhvillimin e praktikave të parashikuara nga programi i studimit, në përputhje me qëllimet e programit, si dhe mirëmbahen dhe janë në përmirësim të vazhdueshëm;</p> <p>Kriteri 4 Institucioni, në varësi të programeve të studimeve që ofron, ka së paku një laborator, për secilin grup leksionesh ku parashikohen praktika laboratorike.</p>	<p>POLIS ka investuar dhe synon të vazhdojë në sigurimin e kushteve optimale infrastrukturore si edhe në teknologjinë bashkëkohore për të mundësuar mësimdhënie të një cilësie të lartë për të inkurajuar eksperimentimin dhe arritje të punëve kërkimore.</p> <p>U_POLIS aktualisht ka laboratorë në brendësi të tij në shërbim të programit të studimit dhe janë si më poshtë:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Laboratori i CAD/SAP/ETABS/TEKLA 2. Laboratori i MAC 3. Laboratori i Qeramikës 4. Laboratori i Pikturës/Ilustrimit 5. Laboratori i Prototipizimit 6. Laboratori i Fotografisë <p>Të gjithë këta laboratorë janë shumë të rëndësishëm për programin e studimit Master i Shkencave në Menaxhim mjedisor urban.</p>
<p>Konkluzionet e vlerësimit:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm gjatë vizitës në institucion konfirmoi shume lehtë dhe qartë se infrastruktura e vënë në dispozicion për realizimin e Programit Master i Shkencave në Menaxhim Mjedisor Urban, është në përputhje me standardet e vendit dhe të BE-së. 2. Universiteti POLIS ka ofruar studentëve një ambient komod dhe të përshtatshëm për ndjekjen e aktivitetit akademik por edhe atij social. Në dispozicion të studentëve ka auditorë, klasa, sallë konferencash, mjedise të përbashkëta ku studentët mund të punojnë por dhe ambiente sociale ku mund të kalojnë kohën e tyre. Këtu nuk mund të mos përmenden laboratorët dhe biblioteka. 	

5. Financimi dhe menaxhimi i burimeve financiare

Pjesa përshkrimore

Terma reference: burimet e financimit, kostoja për student, kapacitetet menaxhuese.

Grupi i vlerësimit të jashtëm kontaktoi stafin përkatës dhe u konsultua me dokumente të shkruara për të verifikuar burimet e financimit dhe menaxhimin të tyre nga U_POLIS. Dhe në përfundim rezultoi se U_POLIS është financuar nga një sërë të ardhurash si: tarifat e studimit, donacione; projekte të përbashkëta me partnere, fonde publike dhe të tjera.

Informacioni financiar i paraqitur më poshtë prezanton burimet e financimit ose të hyrat e universitetit sipas kategorisë: fonde publike, donacione dhe grande, tarifat e shkollimit, të ardhura të tjera projekte të përbashkëta etj në vlerë absolute dhe si % ndaj totalit të burimeve. Gjithashtu jep, përdorimin e burimeve financiare ose shpenzimet e kryera nga institucioni gjatë periudhës sipas kategorisë, paga, shpenzime dhe investime duke treguar edhe burimin e financimit të tyre. Raporti financiar vazhdon me llogaritjen e koston për student dhe me tej me

ndarjen e përdorimeve sipas veprimtarive kryesore të institucioneve akademike që janë shpenzime për veprimtarinë akademike, shpenzime për kërkim shkencor dhe shpenzime për veprimtarinë e administrimit. Ndarja sipas kategorive të veprimtarive është bërë bazuar në angazhimet reale të stafit dhe shpenzimeve në tërësi duke marrë në konsideratë edhe udhëzimin e MAS mbi veprimtaritë e personelit akademik në institucionet e arsimit të lartë.

Burimet e financimit: Gjatë 2 viteve të fundit Universiteti POLIS është financuar nga disa burime si: tarifat e studimit, donacione dhe grande, projekte të përbashkëta dhe të ardhura të tjera, (Aneks, Tabela 11)

Në të ardhurat nga donacione dhe grande janë pasqyruar pjesa vjetore që i takon periudhës e grandeve në kuadër të projekteve Erasmus+ në të cilën Universiteti POLIS është partner, grande për realizimin e *event-it Tirana Architecture Week 2016* etj.

Në tarifat e shkollimit përfshihen pagesat që bëjnë studentët gjatë vitit akademik përkatës për shërbimin arsimor.

Në të ardhura nga projekte të përbashkëta përfshihen përfitime direkte të Universitetit POLIS në kuadër të projekteve të përbashkëta me partnerë lokalë dhe ndërkombëtarë. Këto të ardhura nuk kanë hyrë në kontabilitetin dhe llogaritë e Universitetit dhe nuk janë administruar dhe taksuar në POLIS por nga partnerët me të cilët është zhvilluar projekti. Vetëm se në këtë rast përfitues i këtyre aktiviteteve ka qenë Universiteti POLIS. Vlera e këtij kontributi është një vlerësim duke marrë për bazë kostot e deklaruara të projektit. Këto fonde janë përfshirë në raport për të paraqitur një pamje të plotë të aktivitetit të Universitetit.

Të ardhura të tjera përfshijnë të ardhura nga aktivitete dytësore si angazhime në hartimin e planeve dhe projekteve të zhvillimit të territorit, konsulenca dhe ekspertiza profesionale, nën-qera, zhvillim kurse dhe trajnime, zhvillim *event-esh* nga vetë institucioni dhe për të tretë etj.

Nga një analizë e burimeve të financimit shihet se përgjatë viteve është rritur pesha e burimeve të tjera të financimit duke realizuar synimin për diversifikimin e burimeve të financimit. Kështu sot të ardhurat nga këto burime kanë arritur në nivelin **23%** të totalit. Kjo është reflektim i strategjisë financiare të universitetit për diversifikimin e burimeve të financimit, uljen e ekspozimit ndaj risqeve të financimit afatshkurtër me synim qëndrueshmërinë financiare.

Rezulton se U_POLIS përdor burime financiare të diversifikuara dhe mbështet më tepër në mjete të tjera financiare si grand për projekte të përbashkëta sesa në tarifat e studimit.

POLIS është ndër institucionet shqiptare që ka fituar rolin e partnerit lider në një program TEMPUS, duke mbajtur grandin prej 825,000 Euro, të siguruar nga Bashkimi Europian. Kjo tregon për besueshmërinë ndaj kapaciteteve të institucionit për menaxhimin e shumave të tilla. Ky projekt ka vijuar dhe me fitimin e shumë projekteve të tjera të Universitetit POLIS, ku ka pas jo vetëm përfitime financiare por dhe shume mobilitete të stafit dhe studentëve.

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
Standardi II.9 - Institucioni bën një auditim të përvitshëm (të jashtëm dhe/ose të brendshëm) të situatës financiare.	
Kriteri 1 Raporti i auditit paraqet të gjithë situatën financiare për përdorimin e buxhetit të vënë në dispozicion për realizimin e programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë;	Nga vizita u konstatua se monitorimi i aktiviteteve financiare kryhej rregullisht nga Bordi i Administrimit si dhe Asambleja e Ortakëve.
Kriteri 2 Raporti i auditit përmban një pasqyrë të qartë të granteve të huaja të përfituara dhe kontratave të shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë;	Zyra e financës çdo vit hartonte bilancin vjetor. Për këtë qëllim ishte kontraktuar një kompani konsulencë financiare e cila asistonte Zyrën e Financave për probleme dhe aspekte financiare si dhe nëpërmjet një eksperti kontabël të autorizuar kontrollonte dhe verifikonte bilancin vjetor të hartuar nga Zyra e Financave.
Kriteri 3 Raporti i auditit analizon eficiencën e përdorimit të të ardhurave nga tarifat e studentëve në funksion të rritjes së cilësisë së studimeve në këtë cikël studimesh.	Në përfundim të këtij procesi hartojë një raport ku GVJ u vu në dijeni.

Standardi VI.1 - Institucioni harton një raport financiar të kostove të programeve të studimeve.

Kriteri 1 Institucioni harton një raport që pasqyron të dhëna të hollësishme financiare të kostove për realizimin e programeve të studimeve, si kostot operacionale, kostot fikse të mjediseve dhe të pajisjeve, etj.

Kriteri 2 Institucioni dëshmon se ka një qëndrueshmëri financiare përgjatë kohës së zhvillimit të programeve të studimeve dhe se ka kapacitete financiare të mjaftueshme për përmirësimin e situatës financiare dhe gjenerimin e të ardhurave në të ardhmen.

Institucioni harton raporte vjetore financiare që përmbajnë të dhëna për aktivitetin financiar të tij.

Këto raporte janë dhënë për të gjitha vitet akademike.

Institucioni paraqet qëndrueshmëri financiare nga tarifat e studimit por edhe donacionet dhe bashkëpunimi me partner lokale dhe ndërkombëtarë.

Konkluzionet e vlerësimit:

1. Grupi i vlerësimit konstatoi se Universiteti POLIS ka një auditim të përvitshëm (të jashtëm dhe/ose të brendshëm) të situatës financiare. Për më tepër hartohet një raport financiar në të cilin parashikohen kostot e programeve të studimit, të ardhurat dhe shpenzimet e tillë që të shërbejë në një reflektim të drejtpërdrejtë në përmirësimin dhe rritjen e cilësisë akademike.
2. Diversifikimi i të ardhurave financiare, rritja e zërave buxhetorë si fondet për pagat e stafit në rritje, për kërkimin shkencor në kuptimin e gjerë, përfshirë këtu edhe aktivitetet, botimet, anëtarësimet në rrjete ndërkombëtare apo investime, duke pas parasysh që rritja e kostos së shkollimit në disa raste të mos kompensohet më rritjen e tarifës, dëshmojnë për kujdesin e veçantë ndaj cilësisë dhe dimensionin e përgjegjshmërisë sociale. Një vëmendje e veçantë i është kushtuar ngritjes së kapaciteteve të infrastrukturës lehtësuese siç mund të jenë laboratorët. Kjo, pavarësisht kostove të larta, institucioni ka treguar ndjeshmëri maksimale dhe është duke punuar për ngritjen e një laboratorit Testim Materialeve, gjë që do të ndikojë drejtpërdrejtë në cilësinë e studentëve.

6. Sistemi i Brendshëm i Sigurimit të Cilësisë**Pjesa përshkrimore**

Terma reference: institucionalizimi i sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë, ngritja e Njësisë së SBC, funksionimi i saj, vetëvlerësimi dhe përmirësimi i vazhdueshëm i cilësisë, rezultatet e vlerësimeve të jashtme.

Në Raportin e vlerësimit të brendshëm grupi i vlerësimit shprehet:

Në përputhje me ligjin e arsimit të lartë, Statutin dhe Rregulloren e Përgjithshme të Universitetit POLIS, institucioni ka ngritur një njësi të qëndrueshme, strukturimi, përgjegjësitë dhe funksionimi i së cilës përcaktohet qartë në "Rregulloren e Njësisë së Brendshme të Sigurimit të Cilësisë" miratuar me vendim të Senatit Akademik. Rregullorja shpreh qartë rëndësinë e sigurimit të brendshëm të cilësisë nëpërmjet së cilës garantohet cilësia gjatë ushtrimit të veprimtarive akademike, kërkimore, kulturore, shoqërore të personelit akademik dhe të studentëve, si edhe veprimtarive administrative dhe organizative të Universitetit POLIS.

NJBSC është një njësi e përhershme e pavarur, e cila nëpërmjet punës së saj në vlerësimin e cilësisë, synon krijimin dhe konsolidimin e kulturës së cilësisë në Universitetin POLIS. Njësia përbëhet nga 8 anëtarë (Tabela 9, Aneks), një ndër të cilët është përfaqësues i Studentëve dhe një përfaqësues i Alumni. Është organ me karakter të përhershëm, këshillimor dhe vlerësues dhe ka autonomi operative dhe qasje në të gjitha të dhënat e institucionit.

Parimet mbi të cilat është ndërtuar NJBSC:

1. Krijimi i një tabloje të qartë dhe reale rreth gjendjes aktuale të universitetit;
2. Ngritja e një sistemi efikas për sigurimin dhe krijimin e kulturës të cilësisë në institucion;
3. Garantimi i transparencës me qëllim informimin e të gjithë partnerëve dhe publikut të gjerë për performancën e POLIS, njësive, programeve, kurrikulave, shërbimeve etj.

Gjatë takimit me anëtarët e NJBSC u konstatua se kishte një ndarje të qartë të detyrave të anëtarëve të njësisë. Kjo ndikonte drejtpërdrejt me kontrollimin dhe përmirësimin e cilësisë.

Këtu mund të përmendim se një nga anëtarët ishte i angazhuar vetëm për menaxhimin e procesit të vlerësimit të mësimdhënies, dikush tjetër monitorimin e procese administrative, kishte përfaqësues dhe përgjegjës për kontrollimin e procesit kërkimor shkencor etj. Të gjitha këto të krijojnë një tablo sa më të qartë dhe më konkrete në fushën e cilësisë dhe përmirësimit të saj.

Objektivat e NJBSC janë:

- ✓ monitorimi i vazhdueshëm i institucionit;
- ✓ ndjekja e vazhdueshme e programeve të lëndëve, zbatimit, rishikimit, përditësimit të tyre;
- ✓ ndjekja e vazhdueshme e nivelit të cilësisë së stafit akademik dhe ndihmës, si edhe kualifikimit të tij; monitorimi i vazhdueshëm i procesit të mësimdhënies dhe i vlerësimit të studentëve dhe ruajtja e cilësisë së tij;
- ✓ ndjekja e vazhdueshme e ecuresë së kërkimit shkencor në institucion; ndjekja e ecuresë së bashkëpunimit të U_POLIS me institucione të tjera akademike, shkencore dhe jo akademike në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar;
- ✓ dhe monitorimi i nivelit të përfshirjes së studentëve në veprimtaritë e përditshme të institucionit.

Duhet theksuar se në fund të çdo viti akademik të dhënat e procesit të vlerësimit grumbullohen dhe hartohen në formë Raporti Vjetor¹ i cili i paraqitet në formë zyrtare Rektoratit për t'ju vënë në dispozicion Senatit Akademik. Bazuar në të dhënat e raportit nxirren rekomandimet përkatëse për përmirësimin e procesit të cilësisë dhe mësimdhënies dhe sigurohet që ato të zbatohen në çdo njësi të institucionit.

Dy vitet e fundit universiteti është duke u angazhuar në një projekt Erasmus+, Key Action 2, QainAL "Mbështetja strategjike për forcimin e strukturave të Sigurimit të Cilësisë në Institucionet Private të Arsimit të Lartë në Shqipëri", për më shumë (<http://www.qainal.eu/page.aspx?id=1,2>).

Ky projekt ka për qëllim të krijojë dhe të mbështesë proceset për sigurimin e cilësisë dhe mekanizmat për të siguruar menaxhim efektiv dhe për të përmirësuar mësimdhënien dhe të nxënit në institucionet private të arsimit të lartë në Shqipëri. Projekti synon të mbështesë institucionet private të arsimit të lartë në Shqipëri për të arritur prioritetet e dy dokumenteve kryesore: "Rritja e ndikimit të Zhvillimit të BE-së: një Agjendën për Ndryshim" dhe "Arsimin e Lartë European në Botë". Projekti i drejtohet, prioritetit kombëtar për Projektin e Përbashkët, proceset e sigurimit të cilësisë dhe mekanizmave, nën kategorinë C - përmirësimin e menaxhimit dhe funksionimit të institucioneve të arsimit të lartë.

Gjithashtu u konstatua se të gjitha programet e ofruar pranë POLIS janë të akredituara, dhe vete POLIS si institucion është akredituar dhe ri-akredituar dy here.

Krahas këtyre vlerësimeve kombëtare POLIS, i është nënshkruar edhe procedurave të vlerësimit të cilësisë dhe të akreditimit sipas standardeve ndërkombëtare si vijon:

1. Akreditim i përvitshëm nga autoritetet përgjegjëse Italiane në kuadër të programit të përbashkët doktoraturë midis Universitetit POLIS dhe Universitetit Ferrara, duke filluar që nga viti akademik 2013-2014 dhe në vazhdim.
2. Përmirësimi i standardeve të cilësisë së Bashkimit Evropian dhe kërkesave të akreditimit në vendet e origjinës, IPAG Business School, Paris, Francë dhe IHS/ERASMUS University, Rotterdam, Netherlands në bashkëpunim më të cilat Universiteti POLIS ofron tre programe të studimi Master Profesional me nga tre profile secili.
3. Akreditim nga AESOP për programin e studimeve të integruara (5-vjeçare) Planifikim dhe Menaxhim Urban, data e lëshimit dhjetor 2015.

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
Standardi I.10 - Institucioni përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë e programeve të studimeve.	

¹ Raportet Vjetore NJBSC, ndodhen të arkivuara në ambjentet e NJBSC.

- Kriteri 1** Institucioni përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë e programeve të studimeve;
- Kriteri 2** Institucioni e përfshin këtë informacion në vetëvlerësimin që bën për arritjen e sigurimit të brendshëm të cilësisë;
- Kriteri 3** Institucioni publikon rezultatet e vlerësimit dhe rezultatet që synon të arrijë;
- Kriteri 4** Institucioni, për kryerjen e vlerësimit, përdor metoda të tërthorta ose të drejtpërdrejta.

Të tërthorta:

- Sondazhe: të studentëve që ndjekin programet e studimeve, të të diplomuarve në këto programe në vitet e mëparshme akademike apo në ciklet e ndryshme të studimeve;
- Sondazhe të vlerësimit të mësimdhënies, kurrikulës, të të mësuarit;
- Pyetje konceptuale;
- Intervista;
- Etj.

Të drejtpërdrejta:

- Rezultatet e arritura nga studentët në teste të standardizuara kombëtare/ndërkombëtare (p.sh. provimi i shtetit për profesionet e rregulluara, etj.);
- Dëgjime në auditor;
- Rezultatet e arritura nga studentët në provimet e vlerësuara me nota/pikë;
- Rezultatet e arritura nga studentët në testimet paraprake dhe përfundimtare, provimet për module, praktikat profesionale;
- Rezultatet e arritura nga studentët në vlerësimin e detyrave të kryera gjatë zhvillimit të programit të studimit (punë individuale apo në grup, detyra kursi për të analizuar të kuptuarit konceptual, referatat, projektet, provimet, etj.);
- Vëzhgime gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës;
- Rezultatet e arritura dhe cilësia e rezultatit të kërkimit - tezës;
- Etj.

POLIS ka pjesë strategjisë së tij përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së mësimdhënies dhe mësim-nxënies, dhe për këtë arsye mbi baza vjetore bëhet vlerësimi i ecurisë së programeve, nëpërmjet shqyrtimit të anketimeve prej studentëve, mbarëvajtjes së procesit mësimdhënies, cilësisë së literaturës së përdorur, teknikave pedagogjike të përdorura nga pedagogët, sugjerimeve prej pedagogëve të përfshirë në këtë program studimi etj.

Aktiviteti i monitorimit organizohet nga NJBSC, për secilin nga proceset akademike/administrative që kontrollohen gjatë vitit dhe rezultatet e tyre i raporton pranë rektoratit dhe dekanëve të fakulteteve.

Nga këto kontrole hartohen raporte, janë prodhuar vlerësime, janë nxjerr rekomandime dhe janë lënë detyrë për rregullsinë e procesit mësimor, si dhe janë propozuar masa për ndryshime apo korrigjime për raste ose çështje konkrete.

Për kryerjen e vlerësimit janë përdorur metoda të shumëllojshme të drejtpërdrejta ose të tërthorta. Këtu përfshihen sondazhet, pjesëmarrja në mbrojtjen e tezave, ndjekja e ecurisë së studenteve, punësimi, opinionin i tyre, rezultatet e mara nga studimi i tregut etj.

Rezultatet e përfutur nga pyetësorët i bëhen të ditur stafit, studentëve administratës dhe më gjerë.

Të dhënat bëhen pjesë e Raportit Vjetor që institucion dërgon në MASR dhe ASCAL.

Nga GVJ iu kërkua Sekretarisë Mësimore dokumentacioni lidhur me vlerësimin e studentëve, metodat që përdoren për kontrollin e mësimnxënies.

U njohëm me procesverbalet e studentëve, mënyrën e vlerësimit të pedagogëve për studentët, u konstatua se pjesëmarrja e studentëve ishte e detyrueshme.

Me kënaqësi u konstatua se rezultatet e studentëve ishin të kënaqshme.

Standardi I.13 - Institucioni publikon rregullisht informacion të paanshëm dhe objektiv, sasior e cilësor, për vlerësimin e brendshëm.

Kriteri 1 Institucioni publikon rregullisht broshura, buletine etj., të hartuara dhe botuara nga institucioni, për vlerësimin e brendshëm;

Kriteri 2 Institucioni publikon rregullisht prezantime në faqe interneti, video e audio etj. për vlerësimin e brendshëm.

U_POLIS, përgatit dhe shpërndan në formën e një raporti vlerësimit periodike mbi cilësinë. Të dhënat e rezultatet bëhen pjesë e raporteve të pjesshme dhe atyre vjetore të NJBSC nga njëra anë dhe Raportit Vjetor të Përgjithshëm që përgatitet në fund të çdo viti akademik.

Ky raport dërgohet në MAS dhe ASCAL dhe janë lehtësisht të qasshme në bibliotekën e U_POLIS si nga studentët ashtu dhe stafi akademik.

POLIS organizon pyetësor të brendshëm mbi cilësinë e programeve, të personelit akademik, dhe cilësinë e mësimdhënies dhe po planifikon ta publikojë në të dhënat kryesore në faqen e internetit të U_POLIS

Standardi II.7 - Institucioni kryen një analizë vjetore për vlerësimin e programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë.

Kriteri 1 Institucioni harton një analizë vjetore për vlerësimin e ecurisë së programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë;
Kriteri 2 Institucioni harton politika që synojnë përmirësimin e programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë.

Programet Master i Shkencave vlerësohen pas çdo semestri dhe në fund të çdo viti akademik bëhet një analizë vjetore. Ky proces është nën përgjegjësinë e NJBSC në bashkëpunim me koordinatorin e procesit mësimor. Procesit vlerësimit deri më sot mbështetet në vlerësimin nga studentët, nga kolegët, nga eprorët dhe vetëvlerësimi. Gjetjet kryesore të raportit vjetor bëhen publike dhe diskutohen në një mbledhje të hapur të Senatit Akademik me pjesëmarrje të lirë të stafit.

Si përgjigje, *feedback* ndaj mangësive, problemeve apo sugjerimeve, drejtuesit kanë marrë masa konkrete që lidhen me procesin mësimor, strukturën didaktike apo cilësinë e korrektësinë e mësimdhënësve të veçantë.

Këto rezultatet bëhen të njohura stafit dhe studentëve.

Standardi VIII.1 - Institucioni garanton sigurimin e cilësisë në realizimin e programeve të studimeve.

Kriteri 1 Institucioni ka plotësuar standardet institucionale dhe është akredituar në nivel institucional përpara aplikimit për akreditimin e programeve të studimeve;

Kriteri 2 Institucioni përdor instrumentet e duhura për sigurimin e cilësisë;

Kriteri 3 Institucioni harton një politikë dhe ndjek procedura të caktuara për sigurimin e cilësisë dhe standardeve të programeve të tyre;

Kriteri 4 Institucioni përdor mekanizma formale për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen e herëpashershme të programeve të studimit;

Kriteri 5 Institucioni synon ndërgjegjësimin e personelit të vet dhe të studentëve që ndjekin programet e studimeve që ofrohen, për rëndësinë e cilësisë dhe sigurimin e cilësisë në to;

Kriteri 6 Institucioni harton dhe zbaton një strategji për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë. Strategjia, politika dhe procedurat janë publikuar.

POLIS i është nënshtruar procesit të vlerësimit të jashtëm dhe ka fituar akreditimin periodik institucional për të tretën herë në vitin 2017 realizuar nga ASCAL dhe QAA.

Ky proces është realizuar pavarësisht një akreditimi në fuqi atij të fituar përmes Urdhrit Nr. 267, datë 20.05.2016 "Për Akreditimin Institucional të Universitetit "POLIS"

Kjo dëshmon qartë dëshirën e madhe të institucionit për përmirësimin e cilësisë së ofruar.

Të gjitha politikat që vihen në shërbim për të siguruar cilësinë e proceseve akademike hartohen përmes shqyrtimit dhe miratimit të tyre në organet kolegjiale si Senati Akademik, Rektorat etj.

Në përdorimin e mekanizmave formale për shqyrtimin dhe miratimin si dhe mbikëqyrjen e herëpashershme të programeve të ofruara luajnë rol mekanizma si grupet e punës për probleme të veçanta, organet e përhershme kolegjiale brenda fakulteteve si dhe këshillimi me specialist të fushës brenda ose jashtë institucionit.

Ndërgjegjësimi i personelit të U_POLIS mbi sigurimin e cilësisë për programet e ofruara në universitet lidhet drejtpërdrejt me vizionin që ka institucioni për të ofruar programe të një cilësie sa më të mirë. Ky proces starton me procedurat e punësimit të një anëtari të ri në stafin akademik, njohjen e tij me vlerat, misionin dhe vizionin e institucionit si dhe duke i kërkuar atij të bëhet pjesë e filozofisë së U_POLIS për të rritur cilësinë dhe për ta siguruar atë si vlerë sociale e kulturore.

Konkluzionet e vlerësimit:

Bazuar në dokumentacionin e dorëzuar takimin me anëtarët e NJBSC, stafin akademik si dhe në takimin me studentët u arrit në përfundimin se:

1. NJBSC (Njësia e Brendshme për Sigurimin e Cilësisë) në POLIS ka një status institucional të mirëpërcaktuar si njësi permanente e mbështetur në anëtarë të brendshëm por dhe me përfaqësues nga studentët dhe nga ALUMNI, krijon një diversifikim dhe efikasitet në mënyrën se si operon në përmirësimin e cilësisë.
2. Kjo njësi ka një rregullore mbi të cilën bazon aktivitetin e saj si një njësi me autonomi dhe përgjegjësi maksimale për të kryer aktivitetin e kontrollit, evidentuar problematikat dhe sugjeruar përmirësimet e nevojshme të cilat lidhen drejtpërdrejt me cilësinë.
3. Ajo ka për detyrë kryesore të monitorojë dhe raportojë në mënyrë të vazhdueshme rreth cilësisë së brendshme të institucionit.
4. Institucioni garanton sigurimin e cilësisë për programet që ofron. Për të realizuar këtë proces ka një metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese.
5. Institucioni publikon rregullisht informacion te paanshëm dhe objektiv, sasior dhe cilësor për vlerësimin e brendshëm. E gjithë veprimtaria e institucionit në lidhje me cilësinë përputhet me vizionin dhe udhëhiqet nga objektivat e strategjisë.

POLITIKAT E FORMIMIT TË STUDENTËVE

7. Programi i studimit, organizimi i tij

Pjesa përshkrimore

Terma reference: misioni dhe objektivi i programit të studimit, përmbajtja e programit, organizimi i vitit mësimor, semestrat, plani mësimor me të gjithë elementët e tij (lëndët/modulet, kreditet përkatëse, ndarja e orëve për çdo kredit në varësi të formave të studimit, orët mësimore përkatësisht në auditor/jashtë auditorit të ndara sipas formave të mësimdhënies), literatura dhe materiale të tjera mbështetëse e ndihmëse, etj

Sipas RVB: *Qëllimi i Programit të Studimit Master Shkencor në Menaxhim Mjedisor Urban është që të përgatisë specialistë profesionalisht të aftë për menaxhimin e mjedisit urban dhe si ekspertë për vlerësimin strategjik mjedisor, vlerësimin e ndikimit në mjedis dhe auditimin e mjedisit, të aftë për tregun e punës në Shqipëri dhe Europë, me mundësi integrimi në një kontekst shumë disiplinor, si në sektorin e punësimit privat, ashtu dhe atë publik. Ky program studimi i ciklit të dytë synon specializimin e thelluar të studentëve, të cilët kanë kryer studime të ciklit të parë në fusha të njëjta dhe/ose të përafërta, të cilët japin formime me bazë të gjerë në fushën e mjedisit (shkencat natyrore – biologji, kimi, inxhinieri mjedisi, gjeologji, gjeodezi, etj).*

Dokumentacioni që konsultoi GVJ (Dosja e VV dhe materialet plotësuese) konfirmojnë angazhimin tërësor të hallkave përgjegjëse në këtë institucion për realizimin e qëllimit të këtij Programi studimi. Në veçanti, gjatë bisedave me studentët dhe personelin akademik, u informuam për objektivat dhe realizimet konkrete të arritura në PS Msc MMU.

Në objektivin e Programit të Studimit që të garantojë formim të avancuar dhe kompetenca të specializuara përmes dhënies së njohurive teorike dhe praktike më të thelluara në fushën e menaxhimit mjedisor urban, si dhe të aftësojë studentët për kryerjen e kërkimit të pavarur shkencor përmes dhënies së njohurive, metodave dhe teknikave të kërkimit shkencor, GVJ shqyrtoi me kujdes planin mësimor të Programit Msc në MMU (Matrica, syllabuset e lëndëve, pajimin dhe përdorimin e laboratorëve, punimet diploma të studentëve si dhe vlerësimin nga Alumni) dhe gjykon që realizimit të këtij objektivi i është kushtuar vëmendja e duhur dhe realizmi i tij është në nivel të mirë.

Për objektivin që programi i studimit MSc në Menaxhim mjedisor urban synon të përgatisë ekspertë për Shqipërinë, si pjesë e tregut European, pasi konkurrenca e tyre nuk do të jetë vetëm në tregun e punës brenda vendit, por në një kontekst shumë më të gjerë, GVJ vlerëson përpjekjet e deritanishme dhe sugjeron

ndërkombëtarizimin e mëtejshëm të aktivitetit duke i evidentuar shembujt e suksesit, por edhe duke i sendërtuar praktikat më të mira kryesisht në procesin mësimor.

GVJ vlerëson analizën që i bëhet në RVB mjedisit ku jetojmë si “një mjedis kompleks, ku ndërthuren shumë fusha dhe interesa, ku projektohen dhe zbatohen dhjetëra e mijëra projekte me ndikime të rëndësishme në mjedis”, çfarë kërkon një vlerësim dhe organizim shumë të kujdesshëm.

Garantimi i ekuilibrave të nevojshëm për mirëqenien ambientale në ditët e sotme nuk është më një luks, por një kusht i domosdoshëm”. Mendojmë që kjo analizë ka ndikuar dhe do të ndikojë më tej në ruajtjen e koherencës së PS në Msc MMU me zgjidhjet që kërkohen nga problematika e zhvillimeve të shoqërisë. Këtë konkluzion e përforcon më tej dhe gatishmëria e institucionit për të përcaktuar që si “detyrë” e të diplomuarve në këtë PS të mbetet ndikimi pozitiv në përmirësimin e kulturës së menaxhimit mjedisor në Shqipëri. Prandaj thuhet në RVB, Universiteti POLIS synon që përmes këtij programi studimesh të krijojë ekspertë në çështjet mjedisore, me fokus mjedisin urban.

GVJ, gjatë vizitës në institucion, i konsultoi objektivat e PS Msc në MMU, të paraqitura në RVB dhe konkludon që i gjithë aktiviteti mësimor, kërkimorë-shkencor dhe administrativ zhvillohet në përputhje me realizimin e këtyre objektivave.

GVJ vlerëson në mënyrë të veçantë koherencën e planit mësimor me arritjet më të fundit në fushën e menaxhimit të mjedisit, kompletimin e bazës laboratorike jo vetëm për konkretizimin e njohurive teorike por edhe për krijim bazë të dhënash në mbështetje të aktivitetit kërkimorë-shkencor si dhe konsiderimin e përvojave të institucionit në planifikimin e marrdhenjeve me tregun e punës për të krijuar mundësi reale punësimi për këtë profesion relativisht të ri në vendin tonë.

Organizimi i programit të studimit (vite, semestra, javë etj.)

- 1 vit akademik ka 30 javë javë mësimore në Auditor
- 1 Semestër ka 15 javë mësimore në Auditor
- 1 ECTS 25 orë mësimore punë të studentit
- 1 orë mësimore 60' minuta

Plani mësimor sipas viteve akademike, ndarja e ECTS sipas formave të mësimdhënies për çdo lëndë

Nga analiza e ndarjes së ECTS sipas formave të mësimdhënies, GVJ pasi konsultoi dhe matricën e planit mësimor (Aneks, shtojca 17) konstaton se ka raporte të drejta ndërmjet formave të mësimdhënies. Programi i studimit përmban 14 lëndë të organizuara në 19 module, që zhvillohen në katër semestra, (këtu futen edhe internshipi profesional dhe tema e projekt diplomës).

Referuar VKM Nr.41 datë 24.01.2018, një krediti ECTS të formimit i korrespondojnë 25 orë mësimore punë të studentit, përbërë nga orë mësimore për transmetim dijesh në auditor (leksione, seminare, ushtrime, laboratorë, etj.) dhe orë mësimore për përgatitje ose punë individuale të tij.

Sipas RVB-së temat kryesore që trajton ky program studimi kanë të bëjnë me:

- analizat mjedisore, vlerësimet e ndikimit në mjedis dhe vlerësimet strategjike mjedisore,
- politikat mjedisore mbi tokën, strehimin, planifikimin e qëndrueshëm, rajonal, kombëtar dhe të peizazhit,
- çështjet e qeverisjes dhe të legjislacionit urban e mjedisor e të financave të lidhura me to,
- menaxhimin dhe qeverisjen mjedisore urbane, infrastrukturave publike, decentralizimit të shërbimeve publike, të sipërmarrjeve private dhe partneritetet publik privat,
- kontekstin urban dhe social të zhvillimit,
- parimet e dizajnit mjedisor urban dhe të mjedisit të qëndrueshëm,
- kërkimin dhe shkrimin akademik të avancuar.
- Problemet e ndotjes dhe degradimit të mjedisit

Veprimtaritë formuese, raportet dhe përfundimet në formim e kredive

Programi i studimit përmban veprimtaritë formuese të grupuara në disiplina si vijon:

- Veprimtari në disiplina të formimit të përgjithshëm (bazë) 9 kredi, 8%

- Veprimtari në disiplina të formimit karakterizues të programit 48 kredi, 40%
- Veprimtari në disiplina të formimit të ngjashme ose/dhe integruese me disiplinat karakterizuese 9 kredi, 8%
- Veprimtari në disiplina të formimit me zgjedhjen e studentit ndërmjet atyre që ofrohen nga institucioni 15 kredi, 13%
- Veprimtari në disiplina të formimit/plotësuese (për njohjen e gjuhës së huaj, aftësi informatike, praktika apo stazhe) 15 kredi, 13%
- Përgatitja e tezës së **diplomës 30 kredi** (ECTS), ndërsa internshipi në kuadrin e tezës së diplomës përmban **3 ECTS**, që janë përfshirë në veprimtaritë formuese plotësuese).

Për plotësimin e kërkesave lidhur me peshën e veprimtarive në strukturën e përgjithshme të planit mësimor GVJ iu referua tabelës 14 (aneksi), konsultoi VKM Nr.41 datë 24.01.2018, shtojca nr 1 dhe konstaton që:

- Kategoria A- plotësohet
- Kategoria B- është poshtë kufirit të VKM-së (40% kundrejt 50-60%)
- Kategoria C- është poshtë kufirit të VKM-së (8% kundrejt 12-20%)
- Kategoria D- është sipër kufirit të VKM-së (13% kundrejt 10%)
- ~~Kategoria E- plotësohet~~
- Kategoria F- është suprimuar si kategori në VKM e cituar.

Për shpërndarjen e lëndëve/moduleve në planin mësimor GVJ konsultoi të dhënat e tabelës nr. 15 (aneksi) dhe **rekomandon** që shpërndarja e tyre të konsiderohet nga institucioni duke plotësuar standartet e VKM Nr.41 datë 24.01.2018, shtojca nr 1. Kjo VKM të zbatohet edhe për zgjatjen e orës mësimore e cila duhet të jetë 50 minuta

Mënyra e përcaktimit të kredive (ECTS) për format e studimit:

▪ Leksionet	8 - 13 orë në Auditor dhe	17 - 12 orë punë e pavarur e studentit
▪ Seminaret	8 -10 orë në Auditor dhe	17-15 orë punë e pavarur e studentit
▪ Laboratorët	16 orë në Auditor dhe	9 orë punë e pavarur e studentit
▪ Studio	10-12 orë në Auditor dhe	15-13 orë punë e pavarur e studentit
▪ Praktikën Profesionale	20 orë në Auditor dhe	5 orë punë e pavarur e studentit
▪ Provimi përfundimtar	20 orë në Auditor dhe	30 orë punë e pavarur e studentit

Ndryshimet në Planet mësimore, krahasuar me programet mësimore të licensuara

Për t'u informuar lidhur me ndryshimet në planin mësimor të PS Msc në MMU, GVJ shqyrtoi tabelën në shtojcën 40 dhe konstaton që janë bërë 3 ndryshime në emërtimet e lëndëve dhe në përmbajtjen e syllabuseve, ndërkohë që është ruajtur numri i kredive dhe shpërndarja e ngarkesës mësimore. GVJ mësoi gjithashtu se shkak i ndryshimeve në planin mësimor lidhet me përditësimin e programit karshi studimeve të tregut dhe gjithashtu edhe me sugjerimet e studentëve, ALUMNI-t, partnerëve lokalë dhe ndërkombëtarë komuniteti i biznesit, studimet e tregut, ekspertët e jashtëm gjatë vlerësimit të cilësisë etj. Gjatë vizitës në institucion GVJ u informua që ndryshimet në planin mësimor janë miratuar nga senati akademik dhe nuk e kanë kaluar masën e lejuar prej 20%.

Planet mësimore të lidhura me personelin akademik përkatës

Personeli akademik i angazhuar në zhvillimin e programit Msc në Menaxhim Mjedisor Urban përbëhet nga 20 pedagogë nga të cilët 17 Personel Akademik Efektiv (me kohë të plotë) dhe 3 Personel Akademik me Kontratë (85%/15%). Referuar gradave dhe titujve shkencore prgrami studimor mbulohet nga 4 pedagogë me titull Prof. Dr., 1 me titull Prof. Ass. Dr., 7 me gradën shkencore Doktor, 7 në proces doktrature dhe 1 (asistent) me MSc. Të dhënat janë listuar në tabelën 16 të aneksit.

Vlerësimi për Syllabus-et dhe elementët e tyre, për çdo lëndë.

GVJ konsultoi të gjitha syllabuset e lëndëve/moduleve dhe gjeti që ato përmbajnë këto elementë bazë:

- Stafi akademik, bartësi i lëndës
- Viti/semestri kur zhvillohet lënda
- Ngarkesa e lëndës/modulit
- Përshkrimi i përgjithshëm
- Objektivat
- Përmbajtja e lëndës (temat)
- Përmbajtja e lëndës (shkurt-brief)
- Detyra, projekte dhe detyrime të tjera
- Metodologjia dhe ana didaktike
- Literatura e detyrueshme
- Literatura e rekomanduar
- Komponentet e vlerësimit dhe pesha e tyre në pikë
- Konvertimi i pikëve në nota.

Referuar standardit të kërkuar për syllabuset (VKM Nr.41 datë 24.01.2018, shtojca nr 1), GVJ konstaton që ka ndryshime në formë ndaj sugjeron shkrimin e tyre sipas VKM së.

Sa i përket përmbajtjes së syllabuseve, GVJ konstaton që ajo është e plotë, e indeksuar në zhvillimin e dijeve aktuale sipas fushave, e referuar tek arritjet e partnerëve brenda e jashtë vendit, me konsiderim të tregut të punës si dhe e pasuruar me rezultatet e aktivitetit kërkimor-shkencor.

Duke gjykuar se syllabuset janë në proces përmirësimi të përhershëm, GVJ rekomandon që ato të përshtaten në mënyrë të vazhdueshme me zhvillimin e dijeve, kërkesat e tregut si dhe me eksperiencat më të mira të universiteteve vendase dhe atyre të huaja.

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
Standardi I.1 - Institucioni ofron programe studimesh në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij.	
<p>Kriteri 1 Institucioni ofron programe të akredituara të studimeve, të organizuara në module dhe të vlerësuara në kredite, sipas Sistemit European të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS);</p> <p>Kriteri 2 Sasia mesatare e krediteve të grumbulluara gjatë një viti nga një student që ndjek një program studimi me kohë të plotë është 60 kredite;</p>	<p>Programi i studimit Msc në MMU është akredituar me Vendim të Këshillit të Akreditimit të Arsimit të Lartë, nr. 470, datë 03.05.2013, konfirmuar me Urdhërin Ministrit të MASH Nr. 250 datë 14.06.2013. GVJ konstatoi që institucioni i ka marrë në konsideratë rekomandimet e dhëna nga Bordi i Akreditimit gjatë akreditimit të parë, duke dëshmuar gadishmëri dhe vullnet të mirë për të përmisuar nivelin e mësimdhënjes në këtë PS. Ky program përfundon me diplomën Master i Shkencave dhe ofrohet i organizuar në module dhe i vlerësuar në kredite sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe grumbullimit të Krediteve (ECTS).</p> <p>Sasia e krediteve të grumbulluara gjatë një viti akademik nga një student që ndjek këtë program studimi me kohë të plotë është 60 kredite. Për të dy vitet e studimit, studenti duhet të grumbullojë së paku 120 kredite.</p>
Standardi I.2 - Programet e studimeve janë në përputhje me strategjinë për zhvillim të institucionit.	
<p>Kriteri 2 Programet e studimeve të ciklit të dytë “Master i Shkencave”, “Master i arteve të bukura” apo “Master Profesional” i pajisin studentët që zotërojnë diplomën universitare “Bachelor” me njohuri të thelluara, teorike dhe praktike, si dhe trajnim për kërkim shkencor apo trajnim të mirëfilltë profesional;</p> <p>Kriteri 3 Programet e studimeve “Master i Shkencave” ose “Master i arteve të bukura” dhe</p>	<p>Programi i studimit Master i Shkencave në “Menaxhim Mjedisi Urban”, synon pajisjen e të diplomuarve me njohuri të thelluara teorike e praktike, duke realizuar një nxënje në nivelin e dijeve koherente, të aftë në përbushjen e kërkesave të profesionit, me përvojë dhe pasion për veprimtari kërkimore shkencore dhe me përshtatje sa më të pëlqyeshme ndaj nevojave specifike të tregut si atij vendas ashtu edhe atij ndërkombëtar.</p>

(EVAROOP) d

“Master Profesional” synojnë të zgjerojnë njohuritë e fituara në ciklin e parë të studimeve;
Kriteri 4 Programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë (në mjekësi, stomatologji, farmaci, veterinari, arkitekturë) i pajisin studentët me njohuri të thelluara dhe kompetenca shkencore, teorike dhe praktike, si dhe trajnim për kërkim shkencor sipas fushës. Pas përfundimit të tyre si dhe përfundimit me sukses të provimit të shtetit për programin specifik, studentët fitojnë të drejtën e ushtrimit të një profesioni të rregulluar sipas ligjit në fuqi;

Kriteri 5 Programet e studimeve të këtij cikli i pajisin studentët me kompetenca të përgjithshme dhe profesionale që synohen të arrihen apo të zgjerohen gjatë zhvillimit të tij;

Kriteri 6 Programet e studimeve “Master i Shkencave” ose “Master i arteve të bukura” dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë krijojnë baza të qëndrueshme njohurish për studimet e ciklit të tretë doktoratës, duke përfshirë aftësimin për kërkimin shkencor dhe plotësimin e parakushteve (njohuri, aftësi dhe kompetenca) për pranimin në ciklin e tretë të studimeve;

Kriteri 7 Programet e studimeve “Master Profesional” kanë objektiva të qartë profesionale, të justifikueshëm, të arritshëm, me synime të qarta për arritjen e kualifikimit të nevojshëm dhe në përputhje me kërkesat e tregut të punës.

Nga shqyrtimi i planit mësimor, bisedat me studentët dhe me personelin akademik, GVJ konstaton që ky programi i studimit është në linjën e një formimi profesional që nis me programin bachelor dhe vazhdon me zgjerimin dhe thellimin e njohurive duke u mundësuar atyre që zotërojnë diplomë bachelor, jo vetëm të këtij institucioni por edhe institucioneve të tjerë, përfitim të dijeve në nivelin e diplomës Msc dhe shanse punësimi.

Nuk ofrohen programe të integruara.

Referuar kompozimit të planit mësimor dhe përmbajtjes së syllabuseve, po edhe punimeve të studentëve (detyra, punime diplome etj) GVJ gjykon se të diplomuarit e këtij PS zotërojnë kompetenca të përgjithshme dhe profesionale të cilat, referuar edhe përvojave të ALUMNI-it, zgjerohen dhe thellohen edhe gjatë viteve të studimit edhe në postet e punësimi.

Programi i studimit “Master i Shkencave” në MMU krijon baza të qëndrueshme njohurish për studimet e ciklit të tretë doktoraturë, duke përfshirë aftësimin për kërkimin shkencor. Për një përmirësim të mëtejshëm të strukturës së lëndëve/ moduleve në PS GVJ rekomandon që lënda “Menaxhimi i tokës bujqësore” të përfshihet si lëndë me emërtimin “Menaxhimi dhe përdorimi i tokës” si dhe të shtohet një lëndë me emërtimin “Bazat e projekteve mjedisore”.

Standardi I.4 - Programet e studimeve ofrohen në përshtatje me nivelin e studimeve.

Kriteri 1 Përmbajtja dhe renditja e objektivave të programeve të studimeve synojnë arritjen e qëllimeve të tyre në përputhje me nivelin e studimeve në të cilin ofrohen ato;

Kriteri 2 Metodatat e vlerësimit të studentëve nëpërmjet kontrollit të vazhdueshëm të njohurive me anë të testeve me përgjigje alternative apo provimeve përfundimtare dëshmojnë ecurinë dhe arritjet e studentëve për ciklin përkatës të studimeve.

Programi i studimit Master i Shkencave në “Menaxhim Mjedisor Urban” nëpërmjet moduleve të lëndëve, synon zgjerimin dhe thellimin e njohurive teorike, praktike dhe profesionale të studentëve si dhe njohjen e tyre me procesin e kërkimit shkencor. GVJ konsultoi gjithë dokumentacionin e DVV që lidhen me realizimin e objektivave të këtij programi studimesh dhe konstaton që Modulet/lëndët e këtij programi ndërtohen mbi njohuri të fituara në ciklin e parë të studimeve dhe gjatë këtij cikli studimi, studentët krijojnë baza të forta për vazhduar studimet në ciklin e tretë.

Metodat e vlerësimit të studentëve janë të përcaktuara në syllabuset e lëndëve përkatëse. Nga biseda me studentët GVJ mësoi se ata vlerësohen edhe nëpërmjet kontrollit të vazhdueshëm të njohurive gjatë vitit akademik. Në përgjigje të pyetjes: si e gjykojnë ata vlerësimin nga pedagogët?, përgjigja ishte “në vlerësimin përfundimtar jemi bindur se ai ka qenë objektiv. Në rastet kur nuk kemi qenë të bindur në objektivitetin e vlerësimit kemi diskutuar me pedagogun dhe kemi pranuar argumentet reciproke”.

Standardi I.5 - Programet e studimeve synojnë të arrijnë dimensione ndërkombëtare.

<p>Kriteri 1 Programet e studimeve mbështeten në përvojën disavjeçare dhe praktikat e mira të vendeve europiane;</p> <p>Kriteri 2 Programet e studimeve janë ndërkombëtarisht konkurruese për nga elementet që përmbajnë (të dhëna të përgjithshme, objektivat kryesorë, plani mësimor, kreditet, kushtet e pranimit në tometodat e vlerësimit, kriteret dhe procedurat e transferimit të krediteve e njohurive të fituara, diplomat që jepen në përfundim etj.) duke afirmuar vlerat e arsimit universitar në Shqipëri;</p> <p>Kriteri 3 Programet e studimeve janë hartuar në përputhje me objektivat e përcaktuar në legjislacionin dhe direktivat e BE-së për arsimin e lartë dhe profesionet e rregulluara.</p>	<p>Për të gjykuar mbi sjelljen e përvojës disavjeçare dhe praktikave më të mira të vendeve Europiane në PS Msc në MMU, GVJ u mbështet në shqyrtimin e të dhënave të paraqitura në RVB si dhe marrëdhënieve që ka institucioni me partnerët Europianë. Në dokumentin “Strategjia e ndërkombëtarizimit” jepet gjeografia e institucioneve partnere me U_Polis, mënyrat e bashkëpunimit me to si dhe shfrytëzimi i mundësive për të përfituar nga pjesëmarrja në programe e projekte që ndikojnë jo vetëm përmirësimin e cilësisë në mësimdhënie e kërkimin shkencor por edhe krijimin dhe shfrytëzimin e mundësive për të qenë në kontakt “Online” me praktikat më të mira të vendeve Europiane. Duke qenë në një front me partnerë Europianë, GVJ konkludon që ky PS është ndërkombëtarisht konkurrues. Realizimi i mobilitetit të lartë të studentëve është një tregues i rëndësishëm i të qenit në nivelin e kërkesave adekuate dhe konsiderimit ekuivalentë në vlerën e diplomës.</p> <p>Ky program studimi është hartuar në përputhje me objektivat e përcaktuar në legjislacionin dhe direktivat e BE-së për arsimin e lartë, çfarë kontribuon në mundësinë e transferimit të krediteve e niveleve të studimit për në dhe nga universitete të tjera në Europë e më gjerë. Konfirmim i këtij pohimi është edhe mobiliteti i realizuar i studentëve.</p>
---	--

Standardi I.6 - Programet e studimeve përfshijnë aftësimin profesional dhe kërkimin shkencor.

<p>Kriteri 1 Programet e studimeve të ciklit të dytë dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë përfshijnë aftësimin profesional dhe kërkimin shkencor;</p> <p>Kriteri 2 Programet e studimeve hartohen në përputhje me profilin e Institucionit të Arsimit të Lartë dhe strategjinë e tij për zhvillim;</p> <p>Kriteri 3 Personeli akademik angazhohet në punën kërkimore shkencore për realizimin e programeve të studimeve;</p> <p>Kriteri 4 Puna kërkimore e personelit akademik të angazhuar për realizimin e programit të studimeve përkon me synimet për arritjen e qëllimeve të tij.</p>	<p>Për të konkluduar mbi aftësimin profesional dhe kërkimin shkencor të studentëve në PS Msc në MMU, GVJ shqyrtoi të dhënat e RVB-së, duke u përqendruar tek plani mësimor, raportet leksione/ seminare/laboratorë/praktika në kreditë dhe sendërtimi i tyre në syllabuse, përmbajtjen dhe kërkesat e të gjitha formave të mësimdhënies , pjesëmarrjen e studentëve në aktivitetet shkencore etj. Gjatë vizitës në institucion GVJ mësoi nga vetë studentët, në veçanti edhe nga përfaqësuesi i ALUMNI-t, vlerësimin e tyre lidhur me aftësimin profesional dhe kërkimin shkencor.</p> <p>Nga gjithë materialet e shqyrtuara gjykohet që ky PS realizon objektivat edhe për aftësimin profesional edhe për kërkimin shkencor.</p> <p>Programi i studimit Msc në MMU është hartuar në përputhje me strategjinë e U-Polis.</p> <p>Sa i përket angazhimit të personelit akademik në punën kërkimore shkencore GVJ, përveç të dhënave të RVB mori informacione konkrete nga takimi me personelin akademik dhe gjeti që aktivizimi i tyre është i gjithanshëm dhe rezultativ. Gjatë takimit me personelin, ata vetë u deklaruan që kanë mbështetje të plotë institucionale për pjesëmarrje në aktivitetet brenda e jashtë vendit e, për më tepër, ata nëpërmjet <i>workshop</i>-eve të organizuara nga vetë institucioni ofrojnë bashkëpunim në programe e projekte që ndikojnë cilësinë e mësimdhënies dhe kualifikimin shkencor të tyre.</p>
---	---

Standardi I.8 - Programet e studimeve marrin parasysh nevojat e tregut të punës.

Kriteri 1 Programet e studimeve marrin parasysh nevojat e tregut të punës, dhe hartohen në përputhje me synimet strategjike të zhvillimit ekonomik kombëtar;

Kriteri 2 Institucioni, për vlerësimin e nevojave të tregut të punës, kryen një studim tregu, i cili përfshin:

- mundësitë e punësimit të studentëve në tregun vendas ose atë rajonal, kombëtar a ndërkombëtar;
- kërkesat e punëdhënësve;
- një parashikim të përafërt për numrin e pritshëm të studentëve që mund të regjistrohen në këtë program;
- numrin e të regjistruarve në programe të ngjashme në institucionet simotra.

Programi i studimit Msc në MMU synon të kontribuojë në krijimin e një brezi të ri specialistësh, të formuar sipas nevojave dhe në nivelin e kërkesave të kohës, në përputhje me nevojat e tregut të punës si brenda vendit ashtu dhe jashtë tij. GVJ gjykon që zhvillimet e ardhshme në këtë PS do jenë në linjën e synimeve strategjike të zhvillimit ekonomik kombëtar duke ndjekur zhvillimet teknologjike dhe realizuar vazhdimisht përshtatjen me aktet ligjore e nënligjore.

Sa i përket plotësimin të kriterit 2 lidhur me kryerjen e një studimi tregu nga ana e institucionit që analizon:

- mundësitë e punësimit të studentëve në tregun vendas ose atë rajonal, kombëtar a ndërkombëtar;
- kërkesat e punëdhënësve;
- një parashikim të përafërt për numrin e pritshëm të studentëve që mund të regjistrohen në këtë program;
- numrin e të regjistruarve në programe të ngjashme në institucionet simotra.

GVJ përveç informacionit të RVB shqyrtoi edhe “studime tregu” ku thuhet që “qëllimi i këtij studimi është të identifikojë, pasqyrojë problematikat që ka tregu privat, administrata publike ajo qendrore dhe lokale, si dhe arsimiti universitar në veçanti në lidhje me fushën e mjedisit”. Si në RVB ashtu edhe në materialet plotësuese dhe vizitën në institucion konfirmohet angazhimi i institucionit edhe për studentët e PS Msc në MMU për të pas një informacion sa më të plotë dhe një pasqyrë sa më të qartë lidhur me nevojat e tregut të punës dhe hapësirat që ekzistojnë në të për punësimin e të diplomuarve të këtij programi studimi.

Standardi I.9 - Programet e studimeve synojnë ruajtjen e vlerave kulturore kombëtare dhe interesave kombëtare.

Kriteri 1 Institucioni ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interes kombëtare;
Kriteri 2 Programet e studimeve synojnë të ndihmojnë ruajtjen e vlerave kulturore kombëtare.

POLIS ofron programe studimi që janë në mbështetje të interesave kombëtare për një arsimim cilësor, me objektiv formimin e një brezi të ri intelektualësh.

Programi Master është ndërtuar që t'i shërbejë ruajtjes së vlerave kulturore dhe interesave kombëtare, të tilla si demokracia, diversiteti, shpirti i sipërmarrjes, toleranca, bashkëpunimi, drejtësia, respektimi i të drejtave të njeriut, zhvillimi i qëndrueshëm, integrimi evropian. Programi i trajton, mbështet dhe i kultivon këto vlera nëpërmjet përmbytjes mësimore, kërkimit shkencor dhe veprimtarive edukative.

Standardi I.12 - Kohëzgjatja dhe numri i krediteve për programet e studimeve të këtij cikli janë në përputhje me me ligjin nr. 9741, datë 21.5.2007, “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

Kriteri 1 Programet e studimeve “Master i Shkencave” realizohet me 120 kredite europiane ECTS, ku përfshihen 30-40 kredite europiane ECTS për projektin kërkimor dhe tezën që duhet përgatitur në përfundim të këtyre programeve të studimeve. Kohëzgjatja normale e tyre është 2 vite akademike;

Kohëzgjatja normale e studimeve në programin “Master Shkencor në Menaxhim Mjedisor Urban” është 2 vjet, e organizuar në 4 semestra. Forma e studimit është “studime me kohë të plotë” dhe studentët, për t'u diplomuar duhet të realizojnë 120 ECTS kredi. Në planin mësimor të këtij programi studimi parashikohet që studenti, në përfundim të studimeve, duhet të realizojë një tezë dhe projekt diplome që, bashkë me internshipin profesional, vlerësohet me 33 kredi.

Standardi II.6 - Institucioni siguron menaxhimin efikas të informacionit në lidhje me programet e studimeve.

Kriteri 1 Informacioni i ofruar për programet e studimeve, modulet dhe syllabuset është lehtësisht i konsultueshem për studentët;
Kriteri 2 Informacioni për programet e studimit, modulet dhe syllabuset ofrohet në forma të ndryshme të shkruara dhe elektronike.

GVJ konstatoi që Fakulteti i Planifikimit, Mjedisit dhe Menaxhimit Urban jep të gjitha informacionet e nevojshme për përmbajtjen e programeve të studimeve, përfshirë informacionet e nevojshme për lëndët, për ngarkesën mësimore, frekuentimin e programit, syllabuset e detajuara për secilën lëndë, materialet mësimore, oraret, datat e provimeve, objektivat e kurseve, sistemin e vlerësimit etj. Këto materiale u vihen në dispozicion studentëve nga vetë pedagogët, por janë dhe të qasshme "Online" në faqen zyrtare të U_POLIS, pranë Sekretarisë Mësimore, Bibliotekës dhe Zyrës së Shërbimeve sipas tipit të materialit të kërkuar.

Syllabuset e detajuara për çdo lëndë janë gjithashtu të qasshme nga studentët në arkivin elektronik të shkollës.

Standardi II.8 - Programet e studimeve të ciklit të dytë dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë parashikojnë një plan diplomimi.

Kriteri 1 Plani i diplomimit shpjegon mënyrën e diplomimit në përfundim të studimeve brenda afatit të parashikuar;

Kriteri 2 Për realizimin e programeve të studimeve "Master i Shkencave" janë parashikuar 30-40 kredite për projektin kërkimor dhe tezën.

Sipas RVB-së "Programi i Masterit Shkencor në Menaxhim Mjedisor Urban" ka parashikuar një plan të qartë diplomimi i cili jepet në rregulloren mësimore të këtij programi.

Si element përbërës të këtij programi studimi jepen: kohëzgjatja e programit (2 vjet me kohë të plotë), ngarkesa kredive (120 ECTS), ngarkesa vjetore në javë mësimore (30) dhe 3000 orë mësimore gjithsej, nga të cila 1,204 në auditor) dhe 1,796 jashtë auditorit (përfshirë dhe Tezën e diplomës 30 ECTS). Këto elemente janë në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore dhe kriteret e procesit të Bolonjës për këto programe studimi. Ngarkesa fizike në auditor e studentit është rreth 300 orë për semestër/30 ECTS (rreth 15 orë në auditor përkundrejt 10 për studim për 1 ECTS). Kjo shpërndarje e bën planin e diplomimit realist dhe plotësisht të realizueshëm.

Gjatë vizitës në institucion, në bisedën e organizuar me studentët, GVJ konfirmoi që studenti i cili ka plotësuar të gjitha kërkesat e planit mësimor dhe ka mbrojtur diplomën me temë diplome, pajiset me diplomën përkatëse, të shoqëruar me suplementin e diplomës. Diploma nënshkruhet nga Rektori i Universitetit "POLIS".

GVJ konstatoi gjithashtu që për projektin kërkimor dhe tezën janë parashikuar 30 kredi (ECTS), çfarë është në përputhje me parashikimet ligjore dhe nënligjore për këtë lloj dhe cikël program studimi (MSc).

Konkluzionet e vlerësimit:

1. Sa i përket organizimit të PS Msc në MMU, GVJ konstaton që ky program është hartuar në përputhje me misionin dhe strategjinë e U_POLIS;
2. Struktura e lëndëve/moduleve siguron një përgatitje profesionale me identitet dhe konkurruese në tregun e punës.
3. GVJ konstaton që për këtë PS është konsideruar dhe realizuar sugjerimi i BA lidhur me rritjen e peshës së formimit teknik në planin mësimor. GVJ vlerëson që lëndët e shtuara ndikojnë pozitivisht në rritjen e aftësive menaxheriale të të diplomuarve.

4. Për plotësimin e kërkesave lidhur me peshën e veprimtarive në strukturën e përgjithshme të planit mësimor, GVJ konsultoi VKM Nr.41 datë 24.01.2018, shtojca nr 1 dhe konstaton që:

Kategoria A- plotësohet

Kategoria B- është poshtë kufirit të VKM-së (40% kundrejt 50-60%)

Kategoria C- është poshtë kufirit të VKM-së (8% kundrejt 12-20%)

Kategoria D- është sipër kufirit të VKM-së (13% kundrejt 10%)

Kategoria E- plotësohet

Kategoria F- është suprimuar si kategori në VKM e cituar.

GVJ sugjeron që institucioni të konsiderojë raportet që jepen në këtë VKM edhe për këtë program studimi Master Shkencor në Menaxhim Mjedisit Urban.

5. Lidhur me formën e syllabuseve, GVJ sugjeron konsiderimin e standardit të paraqitur në shtojcën 2 të VKM Nr.41 datë 24.01.2018.
6. Sa i përket stafit të angazhuar me mësimdhënien, GVJ e gjen të realizuar rekomandimin e BA për raportin PAE/PAK, raportin e titujve dhe gradave dhe raportin e strukturës së moshës. Po ashtu GVJ konkludon që stafi është i motivuar dhe me nivel të lartë shkencor;
7. Studentët janë të informuar për programin e studimit dhe janë aktivë në përmirësimin e tij. Po kështu kontribut të rëndësishëm në përmirësimin e PS jep edhe ALUMNI. Institucioni ua krijon mundësitë që ata të jenë bashkëpunues në realizimin e përmirësimeve të rekomanduara.
8. E gjithë infrastruktura e institucionit (Fakulteti, departamenti, sekretaria mësimore, zyra për këshillimin e karrierës etj) vihet në dispozicion të studentëve për çdo pyetje që këta të fundit ngrenë për programin e studimit apo çështje të tjera. Gjatë takimeve me studentët ata pohuan që shërbimet funksionojnë rregullisht dhe me korrektësi duke përmbushur nevojat e tyre.
9. Studentët pohojnë se ata janë të informuar plotësisht lidhur me vlerësimin dhe se vlerësimi i dijeve nga ana e pedagogëve është objektiv.

Rekomandime:

- Duke qenë se menaxhimi i mjedisit urban përfshin tokën në përgjithësi sugjerojmë që lënda "Menaxhimi i tokës bujqësore të riemërtohet si lënda "Menaxhimi dhe përdorimi i tokës" si dhe të shtohet një lëndë që të trajtojë bazat e projekteve mjedisore.

8. Mësimdhënia

Pjesa përshkrimore

Terma reference: organizimi i mësimdhënies, format e mësimdhënies, ngarkesa dhe cilësia e realizimit, kontrolli i njohurive të studentëve, metodat e mësimdhënies, teknologjitë e mësimdhënies, vlerësimi i brendshëm i mësimdhënies, aktivizimi i studentëve në komponentët e aktivitetit të njësisë etj.

Për të gjykuar për organizimin e mësimdhënies, format e saj, ngarkesën dhe cilësinë e realizimit, kontrollin e njohurive të studentëve, metodat e mësimdhënies, teknologjitë e mësimdhënies, vlerësimin e brendshëm të mësimdhënies, aktivizimin e studentëve në komponentët e aktivitetit të njësisë etj. GVJ shqyrtoi RVB-në, dokumentet plotësues të DVV-së si dhe protokollin e bisedave me studentët dhe pedagogët. Gjatë këtij aktiviteti, GVJ konstatoi që organizimi dhe zhvillimi i mësimdhënies ndiqet, monitorohet e kontrollohet me shumë kujdes si për mbarrëvajtjen, ashtu dhe në aspektin cilësor. Shpërndarja e ngarkesave në auditor sipës formave të mësimdhënies jepen në tabelën 17 (aneks)

Po krahas formave të mësimdhënies njëdrejtimëshe (nga pedagogu tek studenti), në këtë PS tentohet drejt formave të mësimimit me pjesëmarrjen aktive të studentëve, për të realizuar një produkt të përbashkët pedagog-student. Sipas këtyre metodave, pedagogu është në klasë, jo vetëm në rolin e lektorit, por edhe të një moderatori dhe lehtësuesi të kalimit të dijeve dhe nxitjes së ideve të reja nga ana e studentëve.

Përveç strukturimit të mësimdhënies në *leksione/seminare(ushtime)/laboratorë/praktika* në U_Polis dhe për PS Msc në MMU, GVJ u njoh dhe me disa forma specifike (të pasqyruara edhe në RVB) si:

Puna në grup. Aplikohet kryesisht gjatë orëve të seminareve, punëve praktike apo studiove, pasi grupi mësimor është më i reduktuar.

Prezantimet/ekspozimet publike. Kjo formë aplikohet që studentët të aftësohen në teknika prezantimi dhe komunikimi me grupin dhe me të tjerët. Meqenëse thuajse çdo lëndë ka si komponent përbërës të mësimiit dhe vlerësimit, detyrat e kursit/projektet, të cilët zënë një vend të rëndësishëm në vlerësimin përfundimtar metoda është e përhapur gjerësisht dhe vlerësohet nga studentët si efektive.

Forma e vizitave në terren. Studentët i ndihmon të njihen me problematikën mjedisore të trajtuar ose me zona natyrore të rëndësishme së veçantë për mjedisin, biodiversitetin, peizazhin ose burimet natyrore. GVJ mësoi se në programin MSc në Menaxhim Mjedisor janë organizuar disa aktivitete, si *walking the city, biking*, vizita në institucione të ndryshme, si Qendra e Transferimit të Teknologjive në Fushë –Krujë, për të parë Laboratorët Analitikë të Tokës dhe Cilësisë së Ujit e Ndotjes së Mjedisit, vizitë studimore në Levan, Fier, vizitë në laboratorin *Altea – Geostudio 2000*, vizitë në kompani riciklimi, në Landfillin e Sharrës dhe atë të Bushatit, në Impiantin e Trajtimit të Ujërave të Ndotura në Kavajë, në HEC-in e Ashtës dhe të Vaut të Dejës, vizitë në Parkun Kombëtar të Divjakës, Lagunën e Karavastasë, vizitë në bashkëpunim me AOS (*Albania Ornithological Society*) në të gjitha zonat e largëta të Shqipërisë për vëzhgimin e biodiversitetit të shpendëve dhe identifikimin e popullatave të specieve në zhdukje, vizite në Institutin e shëndetit publik për monitorimin e cilësisë ajrit, në Agjencinë kombëtare të Mjedisit etj.

Si faktor i rëndësishëm në përmirësimin e formave të mësimdhënies edhe për këtë PS shihet të qenit pjesë e projektit ConSus: 543742-TEMPUS-1-AT-TEMPUS-JPHES. Sipas RVB-së “synimi i këtij projekti ishte të nxiste institucionet partnere të aplikonin 4-6 metoda inovative për mësimdhënien. Këto metoda i adresohen bashkëpunimit shkencë-shoqëri dhe paraqesin bazën për zhvillimin e burimeve të mësimdhënies”. Një pjesë e metodave të mësimdhënies të aplikuara jo vetëm në këtë program studimi, por në të gjithë universitetin janë: të mësuarit e bazuar tek problemi (PBL), *World Café*, Modeli *Canvas* – strukturimi i ideve të qëndrueshme të biznesit, lojërat edukative, etj.

GVJ konstatoi që për këtë PS në funksion të formës së zgjedhur të mësimdhënies është përcaktuar dhe organizimi i saj, pra të zhvilluarit në auditor apo jashtë tij. GVJ u informua që për këtë nivel studimi literatura jepet paraprakisht dhe diskutohet në klasë duke e ilustruar me problematika konkrete. Personeli akademik është i lirë të zgjedhë metodikën më të përshtatshme për të zhvilluar dhe organizuar lëndën përkatëse. Specifikë e programit të studimit Master Shkencor në Menaxhim Mjedisor Urban është përdorimi i metodave dhe formave të mësimdhënies që përfshijnë praktika konkrete në terren, laboratorë, vizita, sondazhe, vëzhgime, etj. Përveç anës teorike të çdo lënde/moduli, të gjitha lëndët/modulet e këtij PS kanë në përmbajtjen e tyre edhe praktikën si një element kyç në dhënien dhe përvetësimin e dijeve.

GVJ konstaton që në planin mësimor të këtij PS vendoset në balancë të mësuarit teorik dhe veprimtaria praktike, ku pesha e leksioneve është rreth 40.3% dhe e studio/projekt/laboratorëve rreth 30%. Formimi praktik plotësohet përmes praktikës profesionale, ndërkohë që thellohet në aspektin kërkimor përmes temës së diplomës në semestrin e fundit. Kjo shpërndarje është në përputhje me kriteret shtetërore dhe me kërkesat e natyrën specifike të programit.

Numri total i veprimtarive formuese është 20 (RVB). Lëndët klasifikohen në dy grupe kryesore: lëndë të detyruara dhe lëndë me zgjedhje njësoj të rëndësishme. Lëndët mund të jenë semestrale ose vjetore.

Format mësimdhënies në programin MSc në Menaxhim mjedisor Urban janë dhënë në aneks tabela 17, ku shihet ngarkesa totale e orëve për programin e studimit për dy vite.

Format e kontrollit të njohurive që aplikohen në U_POLIS janë frekuentimi (ndjekja e lëndës) dhe pjesëmarrja aktive, plotësimi i detyrave të kursit sipas kriterëve të vendosura në çdo lëndë, testimet gjatë vitit dhe provimi përfundimtar me shkrim dhe/ose me gojë, sipas peshës specifike të paraqitur në aneks, tabelën 18.

Në shërbim të rritjes së cilësisë së mësimdhënies për PS Msc në MMU studentët aktivizohen në një sërë aktivitete akademike dhe kërkimore shkencore. Këto aktivitete organizohen kryesisht nga departamenti dhe

fakulteti. Pjesëmarrja e studentëve ishte në formën e bashkëpunimit në punimet shkencore të pedagogëve, në projekte shkencore në rang departamenti, në projekte shkencore në rang fakulteti dhe në projekte shkencore në bashkëpunim me të tjerë. Gjatë bisedës me studentët, GVJ u fokusua të mësonte për vlerat e këtyre aktiviteteve dhe mësoi se studentët kishin interes të veçantë për pjesëmarrjen në to pasi, siç u shprehën ata, jo vetëm fitojmë njohuri të reja por edhe fitojmë përvojën e parë për të realizuar punime shkencore.

Në tabelën në vijim jepet numri i studentëve të aktivizuar në këto aktivitete.

Si gjatë shqyrtimit e konsultimit të RVB e dokumentacionit shtesë ashtu edhe gjatë vizitës në institucion, GVJ konstaton që për këtë program studimesh ka politika të qarta dhe identitet përsa i përket mësimdhënies, të mbështetura në standardet e cilësisë. Nuk u evidentuan ndryshime ndërmjet të dhënave të deklaruara dhe atyre të konstatuara. Aktivizimi i studentëve në komponentët e aktivitetit të njësisë (2017-2018) është pasqyruar në aneks Tabela 19.

9. Studentët

Pjesa përshkrimore

Terma reference: procedurat e pranimit të studentëve, cilësia në hyrje e studentëve, numri i studentëve në hyrje dhe në dalje në vite, koha mesatare e zgjatjes së studimeve, kalueshmëria e studentëve dhe problemet që lidhen me të, statistika, punësimi i të diplomuarve, komunikimi me ish-studentët e diplomuar, informimi i studentëve.

Për të vlerësuar studentët e PS Msc në MMU lidhur me procedurat e pranimit, cilësinë në hyrje, numrin në hyrje dhe në dalje në vite, kohën mesatare të zgjatjes së studimeve, kalueshmërinë dhe problemet që lidhen me të, punësimin e të diplomuarve, komunikimin me ish-studentët e diplomuar, informimin e tyre etj, GVJ është bazuar në RVB, dokumentet shtesë të dosjes së vetëvlerësimit si dhe vizitën e kryer në institucion.

Kriteret e pranimit të studentëve në programin Master i Shkencave në Menaxhim Mjedisor Urban (RVB)

Sipas pikës 6.1 të Rregullores së Programit të Studimit në programin e studimeve Master Shkencor në Menaxhim Mjedisor Urban pranohen ata kandidatë që:

- zotërojnë një diplomë studimi të ciklit të parë Bachelor në profilet: Studime Mjedisore, Inxhinieri Mjedisi, Inxhinieri Pyjesh, Planifikim Urban dhe Rajonal, Inxhinieri Ndërtimi, Arkitekturë, Gjeografi, Landscaping, Biologji si edhe në programe të përafërta studimi me plotësim të kredive.
- zotërojnë një diplomë ekuivalente studimi të fituar në vende të tjera, të njohura nga autoritetet zyrtare dhe ligjet në fuqi.
- kanë mesatare të ponderuar të notave të studimit mbi mesataren e përcaktuara nga U_POLIS
- janë fitues në konkurrimin midis kandidatëve aplikantët që kalojnë me sukses procesin
- përzgjedhës nga Komisioni i Vlerësimit të Programeve të studimit, që konsiston në një test
- pranimi me shkrim si dhe në një intervistë me gojë me komisionin përkatës.

Gjatë shqyrtimit të dokumentacionit përkatës, GVJ konstatoi respektimin e këtyre kriterëve.

Aktualisht këtë program studimi e ndjekin 49 studentë.

Sa i përket transferimit të studimeve, GVJ mësoi që U POLIS aplikon një politikë konservatore në lidhje me pranimin e transferimeve të studentëve në vite të ndërmjetme nga universitete të tjera, brenda ose jashtë vendit, dhe lejon largimin e studentëve të tij për në universitete të tjera. Procedurat për transferimin e studimeve janë të parashikuara në Nenin 11 të Rregullores së Programit të Studimit. Në këtë rregullore, GVJ gjeti të definuar edhe të drejtat dhe detyrat e studentëve që ndjekin këtë program studimi.

GVJ konstatoi që cilësia e studentëve në hyrje dhe në dalje në programin e studimit Msc në Menaxhim Mjedisor Urban në U_POLIS (tab.19, aneks) e kalon atë mesatare. Referuar treguesve sasiorë, vërehet një rritje e mirë e mesatares në dalje në raport me mesataren në hyrje. Kjo dëshmon se U_POLIS bën përpjekje serioze për formimin e studentit, duke shmangur fiktivitetin kryesisht në vlerësimin dhe duke inicuar nxitjen e studentëve për nxënie e formim maksimal, brenda mundësive dhe përpjekjeve individuale.

Numri i studentëve të regjistruar duke filluar nga 2011 deri 2018 janë 133 (aneks, Tabela 20), ndërsa 61 kanë përfunduar studimet (janë diplomuar) në programin e studimit në Master Shkencor në Programin Menaxhim Mjedisi Urban. Nga kjo mund të analizohet se kalueshmëria (diplomimi) është me shpërndarje për pesë vitet e para (2011 deri 2016) me 12.2 ndërsa studentë të pranuar për këtë periudhë janë 90. Përqindja mesatare e të diplomuarëve në raport me numrin e studentëve të pranuar është 67.78 %. Kjo përqindje është edhe trgues i matshëm i performancës të IAL.

Për studentët e këtij PS mobiliteti është rritur ndjeshëm gjatë 3 viteve të fundit për shkak të pjesëmarrjes së U_POLIS në projektet Erasmus+, KA1. Këto projekte, të financuara nga BE-ja, janë të dedikuara për mobilitetin e studentëve, por edhe të stafit, prandaj një numër i stafit akademik dhe administrativ kanë përfituar nga këto projekte (p.sh. me U_Minho, IHS / Erasmus University në Roterdam, IPAG Business School, Riga Building College, etj).

GVJ mësoi që numri i mobilitetit të studentëve për programin e studimit Master i Shkencave në Menaxhim Mjedisor Urban, gjatë vitit akademik 2016-2017, ka qenë 2 pranë IPAG Business School, ndërsa gjatë vitit 2018-2019 janë parashikuar dhe 2 studentë për një mobilitet semestral pranë Universitetit të Minho-s Portugali, në kuadër të projekteve Erasmus+, për shkëmbim stafi dhe studentësh.

Lidhur me integrimin e studentëve në tregun e punës, GVJ mësoi se U_POLIS i ka kushtuar një vëmendje të veçantë këtij procesi. Përveç angazhimit të tyre që vitin e parë në tema dhe projekte konkrete në terren, në vitin e dytë (MSc në MMU) janë organizuar internshipe në sipërmarrje private partnere të interesuara, institucione mjedisore, për të vendosur studentët në marrëdhënie bashkëpunimi dhe në projekte që mundësojnë punësim në të ardhmen.

Studentët e MSc në MMU së bashku me pedagogët e tyre janë angazhuar në shërbime të tilla si vlerësime të ndikimit në mjedis, vlerësime strategjike mjedisore, strategji për menaxhimin e mbetjeve të ngurta, etj. Këto shërbime janë kryer për njësitë e qeverisjes vendore në vend, si dhe për agjenci private dhe jo qeveritare. Çdo vit, studentët e këtij programi kanë bërë praktika në projekte të aplikuara pranë IKZH si dhe institucioneve partnere, Co-PLAN dhe Studio Metropolis. Pjesëmarrja në hartimin e planeve rregulluese vendore, sidomos hartimi i VSM në 3 bashki (Shkodër, Mat dhe Dropull) ka qenë një përvojë e rëndësishme në terren për studentët, të cilët, veç të tjerash, kanë plotësuar edhe pyetësorë lidhur me problematikat mjedisore që shqetësojnë qytetarët.

Kujdesi i institucionit për informimin e studentëve me kërkesat e tregut dhe ndihma e ndërmjetësimi për punësimin ka dhënë frytet e tij. Tek Zyra e Mbështetjes së Studentëve dhe Këshillimit të Karrierës, GVJ u informua që kjo zyrë ka bërë një studim më të hollësishëm mbi nivelin e punësimit, natyrën dhe përputhshmërinë e punësimit me formimin e përgjithshëm dhe specifik të çdo studenti, duke i ndjekur e mbajtur kontakte me ta edhe pas diplomimit.

Më tej GVJ mësoi që përmes këtij procesi synohet tërheqja e mendimeve, sugjerimeve dhe komenteve nga të punësuarit dhe punëdhënësit me qëllim reflektimin e tyre në kurrikulën akademike, për një përputhshmëri më të mirë me tregun, që është gjithmonë në evoluim. Rreth 82% e studentëve MSc në Menaxhim Mjedisor Urban janë të punësuar në sektorin shtetëror ose privat (të punësuar ose të vetëpunësuar), në përputhje me diplomën dhe profilizimin e tyre dhe vetëm 18% janë punësuar jo në përputhje me diplomën. Numri i studentëve të diplomuar dhe të punësuar janë dhënë në aneks, Tabela 21.

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
Standardi IV.1 - Studentët kanë të drejtë të ndjekin programet e studimeve të ciklit të dytë dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë.	
<p>Kriteri 1 Studentët që ndjekin programet e studimeve "Master i Shkencave" apo "Master Profesional" zotërojnë së paku diplomën universitare "Bachelor" dhe kanë grumbulluar 180 kredite ECTS;</p> <p>Kriteri 2 Pranimi në programet e integruara të studimeve bëhet në përputhje me ligjin nr. 9741, datë 21.5.2007, "Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar dhe akteve nënligjore në fuqi;</p>	<p>Në programin e studimit Msc në MMU janë regjistruar studentë të cilët kanë përfunduar me sukses studimet e ciklit të parë Bachelor ose ekuivalente me të, referuar të gjitha kriterëve të sanksionuara në rregulloren e programit të studimit.</p> <p>Gjatë vizitës në sekretarinë mësimore GVJ konstaton që studentët e regjistruar plotësojnë kriteret e përcaktuara nga</p>

<p>Kriteri 3 Studentët plotësojnë kriteret e pranimit të përcaktuara nga institucioni;</p> <p>Kriteri 4 Studentët e këtyre programeve të studimit japin deri në diplomim edhe provimin e gjuhës angleze mbi bazën e testeve të njohura ndërkombëtare. Për programet e studimeve “Master Profesional” niveli i gjuhës angleze është B2, ndërsa për programet e studimeve “Master i Shkencave” dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë niveli i gjuhës angleze është C1, sipas Kuadrit Europian të Gjuhëve;</p> <p>Kriteri 5 Institucioni vlerëson herë pas here politikën e pranimit dhe ndikimin e tyre në përparimin e mëtejshëm të studentëve në programin e studimit, si dhe harton plane të mundshme për ndryshimin e kriterëve të pranimit.</p>	<p>U_POLIS për regjistrimin e tyre si dhe e kanë të plotë dokumentacionin e paraqitur për regjistrim.</p> <p>Studentët përpara regjistrimit në këtë program duhet të paraqesin dëshminë e testimit në gjuhën angleze, ose ndonjë gjuhë tjetër të huaj, (Dëshmi e marrjes së njëres prej 5 gjuhëve të huaja sipas pikës 3 të nenit 78 të ligjit 80/2015 të certifikuar në nivelin internacional, sipas përcaktimeve të udhëzimit përkatës të MASR dhe akteve nënligjore në fuqi). Gjatë vizitës në Sekretarinë Mësimore, GVJ zgjodhi në mënyrë rastësore disa dosje studentësh dhe konstatoi që ato ishin të plota.</p> <p>Në U_POLIS vlerësohen herë pas here politikën e pranimit dhe ndikimi i tyre në përparimin e mëtejshëm të studentëve në programin e studimit.</p>
<p>Standardi IV. 2- Institucioni informon studentët në lidhje me: statusin e institucionit, të programeve të studimeve që ofron dhe me politikën e punësimit.</p>	
<p>Kriteri 1 Studentëve u jepet informacion për mundësitë për punësim pas diplomimit në përfundim të këtyre programeve të studimeve;</p> <p>Kriteri 2 Studentëve u jepet informacion për akreditimin e institucionit dhe të programeve të studimeve që ofrohen si edhe për njohjen dhe vlefshmërinë, brenda dhe jashtë vendit, të diplomës së lëshuar nga ky institucion;</p> <p>Kriteri 3 Studentëve u ofrohet shërbimi i këshillimit të karrierës.</p>	<p>Informacioni për mundësitë për punësim pas diplomimit, në përfundim të këtyre programeve të studimeve, u jepet studentëve në formë të ndryshme. POLIS u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës nëpërmjet Zyrës së Mbështetjes së Studentëve dhe Këshillimit të Karrierës (ZMSKK). Kjo zyrë në Universitetin POLIS shërben për një përjasje më të mirë të studentëve me tregun e punës, duke i mbështetur dhe inkurajuar në zhvillimin e plotë të potencialit të tyre, për një rol domethënës në shoqëri.</p> <p>Qëllimi i zyrës ZMSKK është:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Orientimi në tregun e punës • Krijimi i lidhjeve mes studentëve dhe punëmarrësve potencialë • Të shërbejë si burim rekrutimi për shumë organizata dhe institucione • Të ofrojë shërbime trajnimi në bashkëpunim me kompani të ndryshme • Të rrisë numrin e të diplomuarve në profesionin e tyre • Të paraqesë nevojat për kërkime shkencore. <p>Informacioni i përgjithshëm mbi strukturën institucionale, ofertën akademike, rezultatet e të nxënit, akreditimet e programeve etj jepet me anë të Guidës së Studentit të cilat përditësohen vit pas viti.</p> <p>Në guidën studentore përfshihen edhe detaje të kurrikulës akademike, kritere dhe kushte që studentët duhet të plotësojnë psh për kalimin nga një vit në tjetrin, etj.</p>
<p>Standardi IV. 3- Institucioni, kur aplikon për vlerësimin dhe akreditimin për herë të dytë, disponon statistika në lidhje me numrin e studentëve që ndjekin programet e studimeve të ciklit të dytë dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë.</p>	
<p>Kriteri 1 Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e të diplomuarve në programet e studimeve që kanë përfunduar;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programet e studimeve të ciklit të dytë dhe në</p>	<p>POLIS disponon statistika për numrin e të diplomuarve dhe studentëve që pritet të diplomohen. Të dhënat e procesit mësimor si dhe të dhëna statistikore mbahen nga Sekretaria Mësimore në bazë të formateve të përcaktuara nga MAS, si dhe</p>

(EVARCO) *

<p>programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik;</p> <p>Kriteri 3 Institucion disponon të dhëna për ecurinë akademike të studentëve që nga pranimi deri në diplomim.</p>	<p>Rregullorja dhe Manuali i Procedurave të U_POLIS. Gjatë vizitës në Sekretarinë Mësimore, GVJ konsultoi mënyrën e mbajtjes së të dhënave dhe konstatoi që këto të dhëna mbaheshin si në format elektronik ashtu edhe në format të fortë në regjistra si: Regjistri i Procesit Mësimor, Regjistri i Notave (Amza), Regjistri Themeltar dhe Regjistri i Diplomave, të cilave u bëhet një përditësim javor dhe në fund të çdo semestri.</p> <p>IAL ka statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar, tërhequr dhe larguar para përfundimit të programit dhe mospërfundimin me sukses të vitit akademik. IAL nëpërmjet Sekretarisë Mësimore disponon të gjitha të dhënat e nevojshme për pranimin dhe diplomimin e studentëve në programin e studimit Master i Shkencave në MMU.</p> <p>Të dhënat ishin të regjistruara në Regjistrin Themeltar, në Regjistrin e Indeksit, në Regjistrin e notave, në Regjistrimin e Diplomave, të verifikuar në Sekretarinë Mësimore.</p>
<p>Standardi IV. 4- Institucioni disponon një bazë të dhënash në lidhje me statistikat e punësimit të studentëve që janë diplomuar pas përfundimit të programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë.</p>	
<p>Kriteri 1 Institucioni mban një bazë të dhënash të studentëve të punësuar pas përfundimit të programeve të studimeve të ciklit të dytë apo të programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë si dhe për vendet e punësimit të tyre;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni mban një bazë të dhënash për studentët që vazhdojnë studimet e mëtejshme në ciklet e tjera të studimeve etj.</p>	<p>Gjatë vizitës në institucion, GVJ konstatoi që IAL, nëpërmjet të Zyrës për Mbështetjes të Studentëve dhe Këshillimit të Karrierës (ZMSKK), mban një bazë të dhënash të studentëve të punësuar pas përfundimit të programeve të studimeve si dhe për vendet e punësimit të tyre, duke dhënë njëkohësisht ndihmë dhe ndërmjetësim për punësimin e studentëve, në përputhje me formimin dhe me kërkesat e tregut.</p> <p>ZMSKK kishte të dhëna mbi nivelin e punësimit, natyrën dhe përputhshmërinë e punësimit me formimin e përgjithshëm dhe specifik të çdo studenti dhe informacion mbi kontaktet e mbajtur me ta edhe pas diplomimit.</p> <p>GVJ u informua që përmes këtij procesi synohet tërheqja e mendimeve, sugjerimeve dhe komenteve nga të punësuarit dhe punëdhënësit me qëllim reflektimin e tyre në kurrikulën akademike, për një përputhshmëri më të mirë me tregun. Sipas këtyre të dhënave rreth 80.6% e studentëve MSc në Menaxhim Mjedisor Urban janë të punësuar në sektorin shtetëror ose privat (të punësuar ose të vetëpunësuar), në përputhje me diplomën dhe profilizimin e tyre dhe vetëm 19.4% janë punësuar jo në përputhje me diplomën.</p>
	<p>ZMSKK mban gjithashtu një bazë të dhënash për studentët që vazhdojnë studimet e mëtejshme në ciklet e tjera të studimeve, etj.</p>
	<p>Në broshurën e ALUMNI-t janë mbledhur të dhënat e punësimit të secilit prej tyre duke i kontaktuar ata nëpërmjet <i>email</i>-it apo edhe nëpërmjet bisedave apo takimeve, duke krijuar kështu edhe bankë shënimesh, e cila rinovohet me të dhëna çdo vit. Një pjesë e studentëve janë të punësuar paralelisht në momentin që ndjekin Masterin pranë U_POLIS</p>

Standardi IV. 5- Institucioni informon studentët në mënyrë të vazhdueshme dhe të detajuar, në lidhje me programet e studimeve.

Kriteri 1 Studentët informohen në mënyrë të detajuar për programet e studimeve, afatin e përfundimit dhe organizimin e programit, statusin e akreditimit të programit;

Kriteri 2 Studentët informohen për rezultatet e vlerësimit gjatë dhe në përfundim të programit;

Kriteri 3 Përgjegjësi i modulit diskuton hapur me studentët rezultatet e këtyre vlerësimeve.

GVJ konstaton që studentët informohen në mënyrë të vazhdueshme dhe periodike mbi programet e studimeve dhe modulet përkatëse nëpërmjet mjeteve të ndryshme të informacionit si materialeve të botuara (broshura, fletëpalosje etj), materialeve elektronike të aksesueshme në faqen zyrtare të U_POLIS, sikur janë:

- (<http://www.universitetipolis.edu.al/?q=sq/node/49>).
- (<https://www.facebook.com/polisuniversity/>),
- LinkedIn,
- YouTube
- (<https://www.youtube.com/user/mireda10?feature=mhee>),
- (https://twitter.com/U_POLIS)

Studentët janë të përfaqësuar në organet më të larta drejtuese të Universitetit POLIS si Senati Akademik, ashtu dhe në Njësinë e Brendshme të Sigurimit të Cilësisë, në këtë mënyrë ata janë pjesë e vendimmarrjes dhe në dijeni të plotë të zhvillimeve që i përkasin cilësisë së Universitetit. GVJ u interesua konkretisht për kontributin e përfaqësuesve të studentëve dhe ALUMNI-t në grupin e RVB dhe në NjSBC dhe mësoi se nëpërmjet tyre mbartej dhe pasqyrohej *feed back*-u i studentëve dhe ALUMNI-t si në struktura ashtu edhe në dokumentacion.

Gjatë takimit me studentët GVJ mësoi që ata informoheshin për rezultatet e fituara në lëndët e programit përgjatë dhe në përfundim të programit mësimor. Gjatë semestrit studentët vlerësoheshin në detyrat e parashikuara për të cilat merrnin edhe transparencën e kërkuar.

Pas çdo provimi publikoheshin rezultatet paraprake për çdo student. Studentëve u lihej një afat për ankimimet e mundshme lidhur me rezultatet e provimit. Pedagogu i çdo lënde diskutonte me studentët për rezultatet e vlerësimeve. Nota përfundimtare vendosej mbas këtij procesi.

Standardi IV. 6- Institucioni angazhon personelin e tij për përkujdesjen ndaj studentëve.

Kriteri 1 Institucioni u ofron këshillim studentëve, ndjek ecurinë e tyre dhe i ndihmon për trajtimin dhe zgjidhjen e çështjeve dhe problematikave që lidhen me procesin mësimor;

Kriteri 2 Institucioni (nëpërmjet zyrës për këshillimin e karrierës) ndihmon studentët në

përzgjedhjen e institucionit në të cilin ata do të zhvillojnë praktikën profesionale, në rastet kur parashikohet një e tillë.

GVJ konstaton se IAL u ofron këshillim studentëve, ndjek ecurinë e tyre dhe i ndihmon për trajtimin dhe zgjidhjen e çështjeve dhe problematikave që lidhen me procesin mësimor.

Këshillimi dhe ndjekja e studentëve realizohet:

- së pari, përmes personave përgjegjës për ecurinë e procesit akademik
- së dyti, përmes shërbimit të tutorit që zakonisht e ofrojnë menaxherët e kurrikulës dhe,
- së treti, përmes ZMSKK.

GVJ mësoi gjithashtu që mundësinë për kryerjen e praktikës profesionale se IAL e ofron nëpërmjet dy partnerëve të vet strategjikë, Co-PLAN e Metro_POLIS, por dhe nëpërmjet rrjetit të partnerëve.

Konkluzionet e vlerësimit:

1. Studentët që ndjekin Programin e Studimit Msc në MMU plotësojnë kriteret e pranimit në këtë program studimesh.
2. Dokumentacioni i paraqitur për regjistrim është i plotë dhe është sistemuar në dosjet e dokumentacionit përkatës depozituar në Sekretarinë Mësimore.
3. Studentët janë të informuar për strukturën e institucionit, ofertën akademike, mundësitë për punësim pas diplomimit, cilësinë e akreditimit institucional dhe të programeve të studimit etj. Ky informacion është i qasshëm nga studentët si tek faqja zyrtare e institucionit në *web*, në *face book*, në *YouTube* apo në *twitter* ashtu edhe pranë njësive strukturore të tilla si ZMSKK, NJSBC.
4. GVJ gjykon se cilësia e mësimdhënies, shumësia dhe cilësia e aktivitetit kërkimor shkencor, plotësia dhe cilësia e infrastrukturës didaktike (posaçërisht asaj laboratorike) dhe standardi i akomodimit në ambientet e institucionit kontribuojnë në rritjen e notës mesatare në dalje kundrejt asaj në hyrje për këtë program studimi.
5. Informacione dhe këshillime konkrete lidhur me tregun e punës dhe kontaktimin me punëdhënësit potencialë, studentët i marrin nëpërmjet Zyrës së Mbështetjes së Studentëve e Këshillimit të Karrierës e cila funksionon në institucion si njësi strukturore dhe e pavarur nga pikëpamja operative.
6. Studentët informohen edhe me të dhënat e grumbulluara nga të diplomuarit lidhur me statistikën e punësimit, historitë e suksesit etj nëpërmjet broshurës ALUMNI (aneks, shtojca 31).
7. GVJ e vlerëson si ngritje në një nivel të ri të cilësisë së informimit të studentëve faktin që Institucioni planifikon ndërtimin e një platforme, e cila do të shërbejë si *database* e të diplomuarve, në kuadër të projektit GRADUA financiar nga Erasmus+ KA2, ku Universiteti POLIS është partnerë konsorcium.
8. GVJ sugjeron që vëmendja e institucionit të mos shkëputet nga detyrimi për t'u siguruar studentëve kushte edhe më të mira, në mënyrë që ata të bëhen modele gjithnjë e më të denja për përmirësimin e imazhit të tij.

KËRKIMI SHKENCOR NË FUNKSION TË PROGRAMIT TË STUDIMIT

10. Kërkimi shkencor

Pjesa përshkrimore

Terma reference: politikat e kërkimit shkencor në këtë program studimi, botimet në vite, projektet e fituara dhe të realizuara, pjesëmarrja në aktivitetet brenda dhe jashtë vendit, aktivitetet e organizuara nga njësia, lidhja e kërkimit me mësimdhënien.

Në këtë rubrikë GVJ do përqendrohet tek politikat e kërkimit shkencor në programin e studimit Msc në MMU, botimet në vite, projektet e fituara dhe të realizuara, pjesëmarrjen në aktivitetet brenda dhe jashtë vendit, aktivitetet e organizuara nga njësia dhe lidhja e kërkimit me mësimdhënien.

Sipas statutit të Institucionit neni 1, pika 1, parime të përgjithshme IAL "Universiteti POLIS është institucion jopublik i arsimit të lartë. Ai është person juridik privat fitimprurës. Universiteti POLIS ka karakter akademik, kërkimor-shkencor dhe aplikativ me programe në katër nivele të mësimdhënies, nivelet 5-8 të kualifikimit sipas Kornizës Shqiptare të Kualifikimit". Ndërsa në nenin 2, pika 1, germa c të po këtij dokumenti, në sanksionim të synimeve për të realizuar vizionin e institucionit thuhet, ndër të tjera, që U_POLIS synon "të kryejë aktivitetet studimore, kërkimore, shkencore dhe praktike të lidhura ngushtë me veprimtarinë akademike dhe programet e studimeve që zhvillon". Për të gjykuar realizimin e këtyre detyrimeve në programin e studimit në Master Shkencor në MMU, GVJ shqyrtoi gjithë dokumentacionin që lidhet me aktivitetin kërkimor e shkencor të programit studimor dhe institucionit në përgjithësi, konsultoi grupet e interesuara dhe të angazhuara në këtë aktivitet

(studentët dhe personelin akademik), gjurmoi angazhimet në kuadër të projekteve bashkëpunuese, krahasoj dhe vlerësoj rezultatet e arritura.

Sa i përket politikave të kërkimit shkencor në RVB thuhet: “Nëpërmjet hartimit dhe implementimit të një platforme kërkimi gjithëpërfshirëse dhe ndërdisiplinore, U_POLIS synon të pozicionohet si një epiqendër rajonale, që gjeneron debat mbi çështjet themelore mjedisore dhe zhvillimin urban me të cilat përballen shoqëritë bashkëkohore urbane dhe në veçanti ato rajonale dhe lokale. Kërkimi në U_POLIS ka si qëllim aftësimin individual të kandidatëve për hulumtim më të thellë e të fokusuar, duke integruar kërkimin teorik me paradigma inovatore të kërkimit eksperimental”. Dhe, në hartim të kësaj platforme, është përcaktuar që “Tematika kryesore e cila do të shërbejë si referencë për projektet e veçanta kërkimore dhe veçanërisht ato të doktoratës është QËNDRUESHMËRIA (*Sustainability*) në këndvështrimin jo vetëm Arkitektonik e Urban por Ekonomik, Social dhe Ambiental”.

Fushat, në të cilat është përqendruar aktiviteti i institucionit pra edhe i PS Msc në MMU, janë:

- *Qëndrueshmëria Mjedisore /Ekologjike*
- *Eficienca e Energjisë*
- *Qëndrueshmëria Strukturore/ Teknologjike /Materiale*
- *Teknologjia e Informacionit*

Referuar këtyre fushave, përkatësisht kësaj platforme, janë përcaktuar edhe tematikat kryesore të aktivitetit shkencor, të cilat lidhen me:

- **Monitorimin dhe vlerësimin e cilësisë së ujërave të lumenjve**
- **Ndryshimet klimatike**
- **Turizmin e qëndrueshëm**
- **Peizazhin dhe Menaxhimin Urban**
- **Studimet Urbane**
- **Strehimin**

Konkretizimi i aktivitetit ndërvaret me ekzistencën e kapaciteteve për kërkimin. GVJ konstaton që këto kapacitete gjenden tek kualifikimi i personelit akademik, tek aftësitë bashkëpunuese me partnerët kombëtarë e ndërkombëtarë, tek niveli dhe gatishmëria e studentëve si dhe tek ekzistenca, gjetja dhe përdorimi i burimeve të financimit.

Për të sanksionuar strategjinë institucionale të kërkimit shkencor është hartuar “Agjenda e Kërkimit Shkencor”.

Realizimet konkrete të aktivitetit pasqyrohen në RVB, duke listuar të gjitha konferencat, simpoziumet dhe kongreset kombëtare e ndërkombëtare ku janë prezantuar temat konkrete të realizuara nga të gjithë aktorët pjesëmarrës.

Në aneks, tabelën 22 jepen aktivitetet e planifikuara individuale dhe në rang institucioni për periudhën 2013-2018. Nga kjo tabelë merren përgjigjet për sasinë e botimeve, projekteve, numrit të aktiviteve, numrit të pjesëmarrësve në aktivitete, numrin e studentëve bashkëpunues si dhe numri i çmimeve të fituara. GVJ u interesua për dokumentacionin lidhur me këto aktivitete dhe konstaton si ekzistencën ashtu edhe përdorimin e tij.

GVJ u interesua posaçërisht për aktivitetin shkencor të studentëve dhe konstatoi vërtetësinë e pohimit në RVB që: “Institucioni bën kujdes të veçantë që të përfshijë në këto aktivitete krahas personelit akademik dhe studentët. Konkretisht, stafi i Departamentit të Mjedisit, së bashku me studentë të këtij programi, kanë organizuar së fundmi (2 vitet e fundit) dy konferenca shkencore studentore mbi planifikimin e qëndrueshëm mjedisor, ku janë trajtuar problematikat mjedisore dhe rreziqet natyrore, konservimi mjedisor, zhvillimi rural, efektet e ndryshimeve klimatike, etj, si dhe *workshop*-e të ndryshme në bashkëpunim me organizma të tjerë me fokus mjedisin, si SELEA, PPNEA, etj, AKZM, etj”.

Gjatë vizitës në institucion, GVJ gjeti që të dhënat mbi të gjithë veprimtarinë kërkimore janë regjistruar, mbahen dhe arkivohen sipas specifikave, në Departament, Fakultetin e Planifikimit, Mjedisit dhe Menaxhimin Urban. Njësinë e Brendshme të Sigurimit të Cilësisë si dhe FKZh.

Të dhënat për angazhimin e personelit të Departamentit të Mjedisit në aktivitetin shkencor për vitin akademik 2017-2018, pasqyrohen në aneks, tabela 23.

Me interes është të vëmë në dukje se një pjesë e Doktoraturave të programit në fushën e Planifikimit Urban është fokusuar në aspekte mjedisore. Konkretisht, GVJ u njoh me punimin e Dr. R. Toto me temë: “Ecosystem-Based Governance of Forest Commons – The Case of Shkumbini River Basin, Albania”

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
Standardi III.3 - Personeli akademik angazhohet në veprimtari shkencore të organizuara në kuadër të programit të studimeve.	
<p>Kriteri 1 Personeli akademik publikon rregullisht artikuj, materiale shkencore në disiplinën përkatëse;</p> <p>Kriteri 2 Personeli akademik, nëpërmjet angazhimeve në këto veprimtari jep ndihmesën e tij në zhvillimin e shkencës ose në zhvillimin e sektorëve të prodhimit apo të shërbimit.</p>	<p>Personeli akademik i programit të studimit Msc në MMU pranë U_POLIS ka kryer kërkime të cilat i ka prezantuar në konferencat e organizuara nga vetë institucioni, në bashkëpunim me institucione të tjera partnere ose në konferenca të organizuara nga institucione të tjera brenda dhe jashtë vendit.</p> <p>Personeli akademik i këtij programi studimor përmes angazhimit të tij në kërkimin shkencor dhe publikimeve jep kontribut në zhvillimin e shkencës dhe sektorëve të prodhimit dhe shërbimit në fushat që lidhen me to. Institucioni vë në dispozicion të botimeve revistën “Forum A+P”, e cila është njohur nga MASH dhe ISSN <i>International Centre</i> (ISSN 22277994) si revistë shkencore dhe është pajisur me ISSN ndërkombëtare.</p>
Standardi III.4 - Institucioni ofron programe mësimdhënieje edhe në gjuhë të huaj, me një personel akademik të kualifikuar.	
<p>Kriteri 1 Personeli akademik që angazhohet në mësimdhënie në gjuhë të huaj ka kryer studimet universitare në atë gjuhë ose zotëron një certifikate për njohje të avancuar të saj;</p> <p>Kriteri 2 Personeli akademik që angazhohet në mësimdhënie në gjuhë të huaj ka një përvojë në mësimdhënie në atë gjuhë, prej së paku një semestri.</p>	<p>Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënie në programin e studimit Master i Shkencave në Menaxhim Mjedisit Urban procesin mësimor e zhvillon në gjuhën shqipe. Pedagogët e ftuar nga institucionet partnere leksionet i japin në Anglishtë mirëpo IAL ofron edhe auditorin nëpërmjet përkthimit në raste nevojë. Edhe pse studentët janë të përgatitur në gjuhën Angleze.</p> <p>Departamenti nuk ofron programe studimi në gjuhë të huaj.</p>
Standardi III.10 - Institucioni angazhohet për kualifikimin e vazhdueshëm dhe të mëtejshëm të personelit të tij.	
<p>Kriteri 1 Institucioni organizon programe specifike për kualifikimin e mëtejshëm profesional të personelit akademik e të personelit mësimorshkencor;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni u ofron personelit akademik dhe atij mësimor-shkencor mundësinë e kualifikimeve të mëtejshme brenda dhe jashtë vendit.</p>	<p>IAL në politikën e vet të rekrutimeve ka një plan të qartë për kualifikimin e mëtejshëm të personelit akademik dhe shkencor. Në këtë kuadër zhvillohen trajnime “In House”, pra brenda institucionit, ku marrin pjesë partnerë të ndryshëm ndërkombëtare. Këtu futen cikli i trajnimeve MATRA në bashkëpunim me IHS/ Erasmus dhe mbështetur nga Qeveria Holandeze.</p> <p>GVJ konstatoi se krahas trajnimeve dhe programeve për ngritjen e kapaciteteve të ofruara brenda institucionit, inkurajohet personeli akademik për të filluar ciklin e tretë të studimeve. GVJ mësoi që për kualifikimin në këtë institucion janë realizuar 2 programe MND ku, në shumicë,</p>

	<p>pjesëmarrësit kanë qenë stafi brendshëm i IAL-së, dhe aktualisht një pjesë e konsiderueshme e stafit janë në proces së kryerjes së studimeve të Doktoraturës që lidhen me kualifikimin.</p>
<p>Standardi III.11 - Institucioni disponon një bazë të dhënash në lidhje me veprimtarinë kërkimore-shkencore të personelit akademik të tij.</p>	
<p>Kriteri 1 Institucioni disponon një bazë të dhënash të studimeve shkencore të personelit akademik të angazhuar në këtë program studimi; Kriteri 2 Institucioni disponon një bazë të dhënash për botimet (tekste, monografi, libra, artikuj apo kumtesa në konferenca) brenda e jashtë vendit të personelit akademik të angazhuar në këtë program studimi; Kriteri 3 Institucioni disponon një bazë të dhënash për projektet kërkimore shkencore kombëtare e ndërkombëtare në të cilat ka marrë ose merr pjesë personeli akademik i angazhuar në këtë program studimi.</p>	<p>GVJ konstaton që IAL ka në strukturën e tij si njësi kryesore Fakultetin për kërkim dhe zhvillim, i cili krahas hartimit të strategjisë të kërkimit shkencor është përgjegjës për dokumentimin e studimeve shkencore, projektet kërkimore e veprimtari të tjera kërkimore shkencore të stafit akademik.</p> <p>Gjatë vizitës në institucion GVJ u informua se që në fillim të çdo viti akademik, hartohet një raport që pasqyron realizimin e projekteve kërkimore shkencore kombëtare e ndërkombëtare në të cilat ka marrë dhe merr pjesë personeli akademik i angazhuar në këtë program studimi. Rezultatet e këtij raporti bëhen të ditura nëpërmjet një <i>workshop</i>-i të posaçëm.</p> <p>Për aktivitetet kërkimore, që kanë produkt të qasshëm si botime, proceedings, foto, video, DVD, etj. realizohet arkivimi i këtij produkti, në mënyrë që ai të ketë qasje vazhdimisht prej të interesuarve.</p>
<p>Konkluzionet e vlerësimit:</p>	
<ol style="list-style-type: none"> 1. IAL ka politika të qarta lidhur me kërkimin shkencor, sanksionuar në dokumentet bazë të tij si Statuti i Universitetit. 2. Institucioni ka të hartuar një platformë të qartë e të realizueshme, atë të QËNDRUESHMËRISË (<i>Sustainability</i>), në të cilën mbështetet edhe aktiviteti shkencor i programit të studimit Msc në MMU. 3. Nëpërmjet aktiviteteve në <i>workshops</i>, simpoziume, konferenca e kongrese, institucioni i krijon mundësi personelit akademik të referojë rregullisht artikuj e materiale shkencore. 4. Nëpërmjet revistës “Forum A+P”, e cila është njohur nga MASH dhe ISSN <i>International Centre</i> (ISSN 22277994) si revistë shkencore dhe është pajisur me ISSN ndërkombëtare, IAL mundëson botimin e artikujve shkencorë të personelit të tij akademik dhe më gjerë. 5. Angazhimi në projekte konkrete i personelit akademik të programit të studimit në Msc në MMU, realizimi i tyre si dhe botimi përkthehet jo vetëm si kontribut për institucionin por edhe si kontribut për zhvillimin e shkencës dhe sektorëve të prodhimit e shërbimit. 6. Mbështetja e kualifikimeve të personelit akademik nëpërmjet trajnimeve të posaçme si MATRA përbën një përvojë dhe drejtim me interes për personelin e trajnuar. 7. Baza e të dhënave për studimet apo botimet nga njëra anë vlerësohet si konsolidim dhe zhvillim i arritjeve në fushën e kërkimit shkencor dhe nga ana tjetër edhe si një rezervat i preferuar për konkretizimin e njohurive të mësimdhënies. 8. Përfshirja e studentëve në aktivitetin shkencor vlerësohet jo vetëm si kontribut për rritjen e dimensionit të nxënies së tyre por edhe si krijim i një përvoje inkurajuese për jetën e tyre profesionale. 	

Pjesa përshkrimore

Terma reference: bashkëpunimi me institucionet e tjera në nivel lokal, kombëtar apo ndërkombëtar, mobiliteti i personelit akademik në secilin nga nivelet e sipërpërmendura, pjesëmarrja në programe kombëtare dhe ndërkombëtare, lidhjet me komunitetin e biznesit dhe me tregun e punës.

Për të gjykuar mbi bashkëpunimin kombëtar, ndërkombëtar dhe marrëdhëniet me publikun GVJ, bazuar në RVB, dokumentet plotësues të DVV dhe vizitës në institucion shqyrtoi bashkëpunimin me institucionet e tjera në nivel lokal, kombëtar dhe ndërkombëtar, mobilitetin e personelit akademik në secilin nga nivelet e sipërpërmendura, pjesëmarrjen në programe kombëtare dhe ndërkombëtare, lidhjet me komunitetin e biznesit dhe me tregun e punës.

Lidhur me dimensionin kombëtar sipas RVB-së *“Universiteti POLIS ka marrë pjesë në disa projekte kombëtare. Si pjesë e këtyre projekteve përmendim: Plane Territoriale, Politikat e Përgjithshme të Zhvillimit dhe Planeve Lokale dhe dokumente strategjike për NJQV të tilla si: Vora, Librazhdi, Shkodra, Burreli si edhe Zagoria, Dropulli, Hasi, Bajram Curri, Kruma (këta të fundit me fokus të veçantë mjedisor dhe peizazhi), etj*

GVJ e konsultoi këtë pjesëmarrje dhe konkludon që ajo është realizuar në kuadrin e angazhimit të bashkëpunimit në plan nacional.

Për bashkëpunimin në plan ndërkombëtar në RVB shkruhet: *“Universiteti POLIS është një institucion i karakterizuar nga një dimension i spikatur ndërkombëtar, gjë që konstatohet në programet e studimit, përbërjen e stafit akademik, studentët, por edhe në shkëmbimet intensive me partnerë të ndryshëm ndërkombëtarë, qoftë në kuadër të aktiviteteve të përbashkëta kërkimore e didaktike, ashtu dhe në shkëmbime të vazhdueshme dhe mobilitet të lartë mes stafit akademik dhe studentëve”*. Për ta verifikuar këtë pohim, GVJ shqyrtoi dokumentacionin e këtij bashkëpunimi nga ku rezulton që deri më tani janë mbyllur dy projekte TEMPUS: *Zhvillimi dhe Përshtatja e Programeve Profesionale mbi Eficiencën Energjike në Ballkanin Perëndimor/ DAPEEWB*”, me buxhet total 825,101 Euro, i cili rezulton të jetë i koordinuar nga Universiteti POLIS që ka menaxhuar konsorciumin prej 11 partnerësh nga Shqipëria, Kosova, Mali i Zi dhe shtete të BE-së. Gjithashtu, ka përfunduar dhe ka marrë vlerësim pozitiv nga BE edhe projekti tjetër TEMPUS *“Bashkëpunimi mes Shkencës dhe Shoqërisë për një Inovacion të qëndrueshëm/ CONSUS”* ku Universiteti POLIS është një ndër 13 partnerët dhe buxheti total i projektit është 1.092.185.38 Euro.

Një projekt tjetër ku U_Polis është partner, është projekti Erasmus + KA2 *“Mbështetja Strategjike Për Forcimin e Strukturave të Sigurimit të Cilësisë në Institucionet Private të Arsimit të Lartë në Shqipëri”* / QainAL.

Si partner, U_POLIS ka fituar edhe pjesëmarrjen në projektin në kuadër të Programit Erasmus+ *“Për Ngritjen e Kapaciteteve”*. Ky projekt është aprovuar nga Komisioni Evropian në vitin 2017 dhe ka filluar nga implementimi. Bëhet fjalë për projektin *“Zhvillimi dhe avancimi i të diplomuarve në Shqipëri/ GRADUA”*, projekt strukturor. Ehen ë këtë projekt Universiteti POLIS është në rolin e partnerit.

Në drejtim të rritjes së bashkëpunimit ndërkombëtar kontribuon edhe mobiliteti i personelit dhe studentëve. GVJ konstaton që gjatë 3 viteve të fundit (2015-2018) në kuadër të programeve të mobilitetit me BE, Erasmus+ KA1, KA2 dhe projekte të tjera, kanë lëvizur drejt universiteteve partnere (IHS Rotterdam, Holandë, U_Minho, Portugali, IPAG Paris, Francë, Riga Building College, Riga, Letoni, Polytechnic University of Bari, Italy, University of Molise, Itali) rreth **52 studentë**, nga të cilët 16 studentë të Programit PhD, dhe **104 staf akademik dhe administrativ**, ndërkohë që kanë ardhur në POLIS **83 staf akademik dhe administrative**.

Në kuadër të bashkëpunimit me jashtë, në U_POLIS janë organizuar edhe një sërë aktivitete, ku janë arritur edhe rezultatet përkatëse të cilat listohen në tabelat respektive të RVB-së dhe faqen zyrtare të Universitetit POLIS në Web. Lista e të gjitha institucioneve dhe organizatave bashkëpunuese të U_POLIS gjendet në tabelën 21, faqe 97-99 të RVB-së.

Komunikimin me publikun IAL e realizon nëpërmjet publikimeve të tij shkencore e publicistike, aktiviteteve me pjesëmarrje të gjerë si ekspozita, vizitave në institucion, prezantimet për rekrutim studentësh etj.

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
Standardi V. 3- Institucioni ka marrëdhënie bashkëpunimi me aktorë të biznesit vendas apo të huaj për kryerjen e praktikave të studentëve të tij.	
<p>Kriteri 1 Për kryerjen e praktikave të ndryshme të parashikuara për realizimin e programit të studimeve “Master Profesional”, institucioni dëshmon se ka marrëdhënie bashkëpunimi me ndërmarrje apo sipërmarrje nga fusha e tregtisë, industrisë apo e shërbimeve prodhuese;</p> <p>Kriteri 2 Për kryerjen e praktikave të ndryshme në programin e studimeve “Master i Shkencave” ose në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë, institucioni dëshmon se ka marrëdhënie bashkëpunimi me aktorë të ndryshëm nga sfera publike dhe ajo private që mundësojnë përfitimin e njohurive më të mira profesionale nga ana e studentit.</p>	<p>GVJ konstaton që U_POLIS ka ndërtuar marrëdhënie bashkëpunimi me organizma të ndryshëm publikë dhe privatë, që plotësojnë gamën e njohurive profesionale nga ana e studentit. Këtu përfshihen marrëveshjet me komunitetin e biznesit apo komunitete administrative të cilat kanë në fokus praktikat profesionale dhe ofertën e shërbimeve. Stafit akademik dhe studentë të programi MSc në MMU sigurojnë shërbime të tilla si vlerësime të ndikimit në mjedis, vlerësime strategjike mjedisore, strategji për menaxhimin e mbetjeve të ngurta, etj, për komuna dhe bashki në vend, si dhe për agjenci private dhe joqeveritare, etj. Çdo vit, studentët kryejnë praktika në projekte të aplikuara pranë Institutit Co-PLAN, Studios Metropolis, Labororit Altea. Nga gjithë ky aktivitet studentët përfitojnë njohuri më të mira profesionale.</p>
Standardi VII.1 - Institucioni garanton marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi mes personelit të tij.	
<p>Kriteri 1 Institucioni, për hartimin dhe mbikëqyrjen e programit, nxit bashkëpunimin ndërmjet personelit brenda institucionit nëpërmjet shkëmbimit të informacionit;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni, nëpërmjet ndarjes së detyrave mes personelit Brenda institucionit, marrjes së përgjegjësiive respektive dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre, garanton marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi.</p>	<p>GVJ konstaton që U_POLIS organizon kryerjen e aktiviteteve duke organizuar grupe mësimore e kërkimorë-shkencore. Vetë organizimi dhe funksionimi i grupeve kërkon krijim e shkëmbim informacioni. Rezultatet e arritura konfirmojnë funksionimin e bashkëpunimit dhe dobinë e shkëmbimit të informacionit..</p> <p>Prania e produkteve të punës në ekip konfirmon se në këtë institucion realizohet bashkëpunimi dhe ndërveprimi mes anëtarëve të stafit si në nivel departamenti, fakulteti ashtu dhe në nivel institucioni. Përvoja e fituar dhe cilësia e këtyre produkteve inkurajojnë nisma të përbashkëta për projekte kërkimore, publikime, pjesëmarrje në aktivitete shkencore, por dhe duke u kujdesur për një jetë të pasur sociale që kuron dhe marrëdhëniet e mira personale mes tyre</p>
Standardi VII.2 - Institucioni garanton marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe jashtë vendit dhe aktorët e biznesit vendas ose të huaj.	
<p>Kriteri 1 Institucioni për realizimin e objektivave të programeve të studimeve ka vendosur marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe jashtë vendit dhe aktorët e biznesit vendas ose të huaj;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, në varësi të programeve të studimeve që ofron;</p> <p>Kriteri 3 Institucioni organizon trajnime profesionale të mëtejshme në bashkërendim me punëdhënësit;</p> <p>Kriteri 4 Institucioni bën një raport analitik të përfitimeve nga marrëveshjet kontraktuale në funksion të realizimit të programeve të studimeve.</p>	<p>Në bazë të shqyrtimit të dokumentacionit dhe vizitës në institucion, GVJ konkludon që IAL ka një rrjet të konsoliduar partnerësh kombëtarë dhe ndërkombëtarë, të cilët kontribuojnë në përputhje me strategjinë e zhvillimit të institucionit. Bashkëpunimi me këta partnerë realizohet në objektiva afatgjata strategjike, ku U_POLIS ofron programe akademike të përbashkëta dhe projekte kërkimore të përbashkëta.</p> <p>Institucioni ka vendosur marrëdhënie bashkëpunimi edhe me punëdhënësit të cilët jo vetëm pranojnë dhe mbikëqyrin studentët gjatë praktikave por edhe shfrytëzojnë bazën laboratorikë të institucionit për analiza e përpunime në interes të aktivitetit të tyre. Kryesisht nëpërmjet <i>workshop</i>-eve dhe</p>

seminareve organizohen trajnime profesionale në bashkëpunim me punëdhënësit.

GVJ ju komunikua se për të gjitha bashkëpunimet IAL ka kontrata bashkëpunimi, për realizimin e të cilave hartohet një raport ku evidentohen dhe përfitimet në funksion të realizimit të programeve të studimeve.

Konkluzionet e vlerësimit:

1. Lista e partnerëve me të cilët bashkëpunon IAL si dhe lloji i bashkëpunimit me to, dëshmojnë që bashkëpunimi mundëson përfitimin e njohurive më të mira profesionale nga ana e studentëve.
2. Publikimi i produkteve të aktivitetit shkencor (artikuj, kumtesa, referate etj) shërben për njohjen dhe vlerësimin më të gjerë të cilësisë së aktivitetit, rrit mundësinë e përdorimit të këtyre arritjeve në aktivitetin e mëtejshëm, duke forcuar më tej shkëmbimin e informacionit mes personelit brenda institucionit.
3. Në takimin me personelin akademik, GVJ mësoi që Institucioni organizonte një *workshop* të veçantë për prezantimin e fushave me interes për kërkimin shkencor dhe mundësitë e aplikimit në projekte/programe që financojnë për fushat e interesit. Bazuar në rezultatet e këtij *workshop*-i hartohet një agjendë për angazhimin e personelit. Angazhimi në kuadër të kësaj agjende shmang dublimin e temave dhe garanton marrëdhënie të mira bashkëpunimi.
4. Universiteti POLIS ka vendosur marrëdhënie të konsoliduar partneriteti me partnerë që ndikojnë në realizimin e objektivave strategjike afatgjata të institucionit.

Rekomandime:

1. Në listën e partnerëve strategjikë, tek rubrika “Institucionet e Arsimit të lartë”, të përfshiheshin edhe Universiteti Politeknik i Tiranës dhe Universiteti Bujqësor.
2. Bashkëpunimi midis U_POLIS dhe institucioneve qeveritare, organizatave profesionale dhe komunitetit të biznesit të përfshinte dhe fushën e ekspertizës (oponencës) për problemet e menaxhimit të mjedisit urban.

I. ANALIZA PËRMBLEDHËSE PËR PLOTËSIMIN E REKOMANDIMEVE NGA AKREDITIMI I PARË

GVJ duke u bazuar në RVB, Dokumentacionin e vënë në dispozicion dhe vizitën pranë Universitetit POLIS, konstaton se rekomandimet e mëparshme janë plotësuar

II. ANALIZA PËRMBLEDHËSE E RVJ SIPAS METODËS SWOT (STRENGTHS-PIKAT E FORTA, WEAKNESSES- PIKAT E DOBËTA, OPPORTUNITIES-MUNDËSITË, THREATS-PENGESAT).

a. Pika të forta:

- 1) Lidhur me Programin e Studimeve Msc në MMU dhe organizimin e tij, GVJ konstaton që programi është strukturuar në mënyrë të tillë që t'ju japë studentëve dije që kërkohen nga tregu i punës, që mundësojnë kualifikimin e mëtjshëm në ciklin e tretë të studimeve, që inkurajojnë përfshirjen në punën kërkimore e shkencore dhe që guxojnë të përballojnë sfidat e konkurrencës.
- 2) Plani mësimor i programit ka identitet dhe është hartuar ashtu që të pranojë studentë me formimin bachelor, përkatësisht diplomë ekuivalente studimi të fituar në vende të tjera, nga shumë fusha profesionale, duke bërë të interesuar një numër të madh kandidatësh. Kjo veçori i siguron programit edhe qëndrueshmëri edhe jetëgjatësi.
- 3) Plani mësimor është i hapur ndaj risive bashkëkohore jo vetëm në nivel kombëtar por edhe atë ndërkombëtar. Praktika e konsoliduar tashmë e aktivizimit të pedagogëve të ftuar, kryesisht nga institucionet partnere, i jep planit mësimor të këtij programi dimension real ndërkombëtarizimi.
- 4) Plani mësimor ka koherencë në transmetimin e dijeve sa u përket metodave të mësimdhënjes, teknologjisë didaktike, bazës laboratorike, përdorimit të rezultateve të kërkimit shkencor dhe lidhjes me tregun e punës duke i rritur shumë shanset e punësimit.
- 5) Syllabuset e lëndëve/moduleve trupëzojnë njohuri teorike e praktike që zgjojnë kureshti e interes gjatë kohës së punës në auditor dhe dëshirë e vullnet në punën e pavarur, jashtë auditorit.
- 6) GVJ gjykon se cilësia e mësimdhënjes, shumësia dhe cilësia e aktivitetit kërkimor shkencor, plotëria dhe cilësia e infrastrukturës didaktike (posaçërisht asaj laboratorike) dhe standardi i lartë akomodues në ambientet e institucionit kontribuojnë në rritjen e notës mesatare në dalje kundrejt asaj në hyrje për këtë PS, duke inkurajuar kështu përpjekjet për rritjen e cilësisë në përvetësimin e dijeve.
- 7) Ekzistenca e një platforme të qartë e afatgjatë si platforma "SUSTAINABILITY", në të cilën mbështetet aktiviteti shkencor i programit të studimit Msc në MMU, krijon dhe forcon identitetin e aktivitetit dhe rrit vlerat e dobisë së tij si për mësimdhënjen ashtu edhe për marrëdhëniet me partnerët.
- 8) Përfshirja e gjerë e studentëve të këtij programi studimi në aktivitetin shkencor vlerësohet jo vetëm si kontribut për rritjen e dimensionit të nxënies së tyre por edhe si krijim i një përvojë inkurajuese për jetën e tyre profesionale.

b. Pika të dobëta:

- 1) Mesatarja relativisht e ulët e studentëve në hyrje ndikon në mosshfrytëzimin me efikasitetin e duhur të kapaciteteve mësimore e shkencore që ofron institucioni edhe për programin e studimit Msc në MMU.
- 2) Numri disi i vogël i partnerëve vendas dhe mënyra e bashkëpunimit me to, sidomos në rastet pa "shkëmbim kapacitetesh dhe njohurish teknike", zvogëlon shanset lidhur me konsolidimin e mëtjshëm dhe të shpejtë të profesionit të Menaxherit të Mjedisit Urban. Kjo vlerësojmë që ndikon edhe në cilësinë jo në nivelin e duhur të marketingut inteligjent (RVB, pikat e dobta)

c. Mundësitë:

- 1) Monitorim i vazhdueshëm i ndryshimeve përkatësisht përmirësimeve të planit mësimor të ndërmarra si nga institucionet e singjashëm brenda vendit ashtu edhe partnerët bashkëpunues e të singjashmit jashtë vendit, në mënyrë që programi i studimeve Msc në MMU të mbetet përherë koherent e konkurues

- 3) Duke parë realizimet në përmirësimin e notës mesatare në dalje kundrejt asaj në hyrje duhet të shtohen përpjekjet për të pranuar studentë me notë mesatare mbi 7. Kjo do ndikonte në rritjen e rendimentit të të nxënësve.
- 4) Do ndikoni pozitivisht në forcimin e kohezionit të planit mësimor përfshirja në të e lëndës/modulit "Menaxhimi dhe përdorimi i tokës" në vend të lëndës/modulit "Menaxhimi i tokës bujqësore" si dhe e lëndës/modulit "Bazat e projekteve mjedisore" për të fituar njohuri më të plota në menaxhimin e projekteve mjedisore
- 5) Formatimi i syllabuseve të lëndëve në përputhje me standardet e kërkuara nga VKM 41, datë 24.01.2018 dhe konsiderimi për shpërndarjen e ngarkesës mësimore të PAE/PAK të "Udhëzimit nr.29, datë 10.09.2018 të Ministrisë së Arsimit, Sportit e Rinisë".

d. Pengesat:

- 1) Rënja e kontigjentit në hyrje për shkak të tendencës në rritje të tarifave të studimit.
- 2) Rënja e interesit për profesionin për shkak të pozicionit akoma të pakonsoliduar të tij.
- 3) Oferta e konkurrencës për profesione që e përfshijnë atë të Menaxherit të Mjedisit Urban, siç është psh Eksperti i Mjedisit apo duke spekuluar me tarifën.
- 4) Ekzistenca dhe mundësia në rritje e tregut informal të punës.
- 5) Mosrespektimi i kërkesave dhe standardeve, posaçërisht atyre të BE-së, lidhur me përdorimin e mjedisit.

SUMMARY REPORT FOR THE STUDY PROGRAM ASSESSMENT

Summary analyze regarding the fulfilment of the previous recommendations from the first accreditation

EEG based on the IER, the provided documentations and the site visit, concludes that the previous recommendations are fulfilled.

EER SUMMARY ANALYZE BASED ON SWOT METHOD

a. Strength:

- 1) Regarding the study program Master of Science in Environmental Urban Management (MSc in EUM), the EEG concludes that the study program is structured in that way to give students the knowledge required from the market, enable for higher qualification in third study cycle, encourage for the scientific research works and even dare to face the challenges of competition.
- 2) The teaching plan programme has identity and has been drafted in way to accept the students with bachelor forming degree, respectively the equivalent diploma acquired in different countries, from different professional fields, making a large number of interested candidates. This peculiarity of the study program provides sustainability and long life.
- 3) The teaching plan programme is opened to the contemporary innovations not just in the national level but also in international level. The involvements of the foreign academic staff practice mainly from the partner institutions give to this study programme the international dimension.
- 4) The teaching plan programme, regarding to the teaching methods, didactic technology, laboratory base, using results from the scientific research has coherence in the transmission of knowledge, and connections with work market in way to increase chance for the employing.
- 5) The course/module syllabuses include theoretical and practical knowledge which are awaken curiosity and interesting during the works in the auditors, wish and volition in the independent work out of the auditor.
- 6) The EEG judges that the teaching quality, the quality and sufficient didactic infrastructure (especially the laboratory), the higher standard accommodation offered from the ambient institution, contribute to increasing the outcome of the study program, due to encouraging efforts to increase the quality of knowledge acquisition.
- 7) The existing sustainability platform, which was supported by the scientific activity of the study programme MSc in EUM, creates and strengthens the identity of the activity and increases the usefulness values for the teaching and also the relationship with the partners.

8) The extensive involvement of this study program students, in the scientific activity is evaluated not only as a contribution to the increasing of their knowledge dimension but also the creation of the encouraging experience of their professional life.

b. Weaknesses:

- 1) The relatively low average of the incoming students, causes lower usability and lack of efficient exploiting of teaching and scientific capacity which is offered by the institution on this study program in MSc EUM.
- 2) The low number of local partners and the collaboration way with them, notably in cases of without "capacity exchange and technical knowledge" increase chances for the further consolidation of the EUM professions. We judge that this effect has impact on the quality level of the intelligent marketing (from SER, Weakness point).

c. Opportunities:

- 1) Permanent monitoring of changing and improving of the teaching plan undertaken by the local internal institution and also of foreign cooperation partners, in way that the study program MSc on EUM to be permanent coherent and competitive.
- 2) Further expansion of the collaboration with local partners to create a bigger chance for the consolidation of Environmental Urban manager profession.
- 3) Comparing the improved outgoing grade values with the incoming grade values, it is necessary to increase the efforts to student enrolling with grade over 7. This will have effect on increasing the learning performance.
- 4) Inclusion of the course "Agriculture Land Management" instead of the "Environmental Base Design" will have a positive impact for the strengthening and cohesion of the teaching plan this because of gained fuller knowledge in environmental project management.
- 5) The format for course syllabus to be in compliance with the required standards form VKM 41, date 24.01.2018 and the teaching load distribution of (ratio EAS/PAS effective academic staff/partially academic staff) "Instruction no.29, date 10.09.2018 of Ministry of Education, Sport and Youth".

d. Threats:

- 1) Dropping of the enrolling contingent due to the rising tendency of study fee.
- 2) Because of the not consolidated profession, dropping of the Interest for the study in this field.
- 3) Competitive offer for professions involving that of the Environmental Urban Management, as it is environmental expert or speculating on the fees.
- 4) The existing and possibility of the increasing the informal work market.
- 5) The non respect of the required standards, especially to EU regarding to the environmental.

External Evaluated Group

Prof. ass. Dr. Florim GRAJÇEVCI

Prof. ass. Dr. Gafur Muka